


# VADEMEKUM MBI ÇËSHTJET LIGJORE TË PERSONAVE LGBTIQ+

Kuadri aktual ligjor në raport me qytetarët LGBTIQ+;  
Jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në raport me çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor; Roli i instrumenteve "soft-law" në avancimin e realizimit të të drejtave të njeriut për personat LGBTIQ+; Listë burimesh për t'u referuar nga sistemi i drejtësisë në raport me çështjet e orientimit seksual, identiteti gjinor dhe karakteristikave të seksit.





**Autore:** LLM Dea Nini  
**Kontributore:** Sanela Lilaj  
**Dizajni grafik:** Joan Kamberaj

Ky publikim është hartuar me financim nga UN Trust Fund to End Violence Against Women, megjithatë pikëpamjet e shprehura dhe përmbajtja e përfshirë nuk nënkuptojnë miratimin ose pranimin zyrtar nga Kombet e Bashkuara.

Pikëpamjet e përfshira në këtë material i përkasin autores dhe nuk përfaqësojnë ato të donatorëve.

**©Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI**

Shkurt 2024

# **Përmbajtja**

---

**Hyrje**

**Metodologjia e përzgjedhur**

**Kuadri aktual ligjor në raport me qytetarët LGBTIQ+**

**Kuadri ligjor shqiptar në raport me njohjen ligjore të çifteve të të njëjtit seks**

**Bashkëjetesa dhe Martesa brenda kornizës ligjore shqiptare nga perspektiva e bashkimeve të të njëjtit seks**

**Implikimet ligjore që sjell mungesa e njohjes ligjore për çiftet e të njëjtit seks dhe përpjekjet e deritanishme në këtë drejtim**

**E drejta për njohjen e identitetit gjinor – ndryshimi i emrit dhe shenjuesit të gjinisë në dokumentet zyrtare**

**Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

**Një Konsideratë mbi praktikën e GJEDNJ-së në një qasje evolutive ndaj vendimarrjeve në çështjet e njohjes së bashkimeve të të njëjtit seks**

**Përmbledhje e çështjeve kryesore lidhur me identitetin gjinor, orientimin seksual dhe aspekte të prindërimit**

**Rëndësia e Instrumenteve “Soft-Law” në avancimin e garantimit të të drejtave të njeriut për individët LGBTIQ+**

**Listë Rekomandimesh në lidhje me formimin profesional dhe punën e praktikuesve të ligjit dhe punonjësve të drejtësisë në raport me çështjet e individëve LGBTIQ+**

**Listë burimesh shtesë**

## Lista e Shkurtimeve

---

<b>AP</b>	Avokati i Popullit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CEDAW</b>	Komiteti për Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>CRC</b>	Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve
<b>DHKN</b>	Dhoma Kombëtare e Noterëve
<b>ECRI</b>	Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KF</b>	Kodi i Familjes
<b>KMD</b>	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>KPC</b>	Kodi i Procedurave Civile
<b>LGBTI+</b>	Lesbikë, Gej, Biseksual/e, Transgjinjor/e, Interseks
<b>LGJC</b>	Ligji për Gjendjen Civile
<b>LMD</b>	Legjislacioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>PKV</b>	Plani Kombëtar i Veprimit
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>UPR</b>	Rishikimi i Përgjithshëm Periodik
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## Hyrje

Mirësevini në këtë vademekum, i cili synon t'ju vijë në ndihmë në punën tuaj si punonjës të sistemit të drejtësisë në raport me çështjet që prekin qytetarët LGBTIQ+ në Shqipëri.

Një analizë e përmbledhur e situatës aktuale të kuadrit normativ shqiptar në raport me individët LGBTIQ+, do të trajtohet në kreun e parë të këtij vademekumi. Pavarësisht garancive kushtetuese dhe kornizës ligjore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, kuadri ligjor aktual shqiptar nuk ofron njohje ligjore për bashkimet e çifteve të të njëjtit seks, nuk mundëson ndryshimin e komponentit të gjinisë për personat transgjinorë dhe lë në situatë pasigurie juridike fëmijët e lindur nga prindër në bashkime të të njëjtit seks. Kjo situatë ligjore, duke u bashkuar me realitetet sociale me të cilat përballen qytetarët LGBTIQ+ në Shqipëri, legjitimon dhe përforcon pabarazitë, për të sjellë kështu shkeljen dhe garantimin jo proporcional të të drejtave të njeriut për individët LGBTIQ+ në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

Ky vademekum, në pjesën e tij të dytë, fokusohet në praktikën dinamike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në raport me çështjet e personave LGBTIQ+, duke synuar të ravijëzojë evolucionin e jurisprudencës së kësaj gjykate në interpretimin e garancive të Konventës mbi çështjet e orientimit seksual, identitetit dhe shprehjes gjinore. Nëpërmjet një përmbledhjeje të kujdesshme të kësaj praktike, synojmë të risjellim në vëmendje të punonjësve të sistemit të drejtësisë, standardet aktuale të mbrojtjes ligjore të individëve LGBTIQ+, si pjesë e pandashme e kuadrit ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në pjesën e tretë të tij, vademekumi eksploron konceptin dhe disa nga instrumentet kryesore "soft-law" si norma, parime juridike dhe rekomandime ndërkombëtare që nuk kanë forcë detyruese, por kanë potencialin të ndikojnë ndjeshëm në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të qytetarëve LGBTIQ+. Midis numrit të konsiderueshëm të këtyre instrumenteve, kemi përzgjedhur të fokusohemi në mënyrë më specifike te Parimet e Yogyakartaës dhe te Rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rek(2010)5. Pavarësisht natyrës së tyre jo-detyruese, këto instrumente kanë dëshmuar efektivitetin dhe rolin e tyre thelbësor në respektimin, mbrojtjen, plotësimin dhe avancimin e të drejtave të individëve LGBTIQ+ ndërkombëtarisht, si akte që ofrojnë udhëzime të qarta përballë mungesës së shpeshtë të dispozitave ligjore specifike me fuqi detyruese brenda kuadreve ligjore kombëtare respektive.

Së fundmi, një seksion i dedikuar i këtij vademekumi përqëndrohet në një listë rekomandimesh për të nxitur zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të sistemit të drejtësisë në raport me çështjet LGBTIQ+ si dhe identifikon një listë të gjerë burimesh që mund të ndihmojnë punën e profesionistëve të drejtësisë në të ardhmen.

Me besimin se ky vademekum do të shërbejë si një iniciativë sadopak ndihmuese në punën tuaj si punonjës të drejtësisë lidhur me njohuritë thelbësore për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të individëve LGBTIQ+ në Shqipëri, ju urojmë lexim të këndshëm!

## **Metodologjia e përzgjedhur:**

Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij vademekumi aplikon një qasje të shumanshme për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet ligjore që lidhen me të drejtat e individëve LGBTIQ+ në Shqipëri.

Metodologjia e aplikuar në pjesë të ndryshme të këtij punimi përfaqëson metoda specifike kërkimore për të realizuar objektivat e përmbajtjes së secilit seksion, si më poshtë vijon:

### **1. Analiza e Kornizës Aktuale Ligjore:**

-Metoda e Rishikimit dhe Interpretimit Ligjor: Metoda e aplikuar përfaqëson një ekzaminim analitik të kuadrit ligjor ekzistues në Shqipëri në lidhje me të drejtat e individëve LGBTIQ+, ku ekspertët hartues kanë realizuar një rishikim të plotë të akteve kryesore normative pjesë e rendit të brendshëm juridik, duke u përqendruar në garantitë kryesore kushtetuese dhe në angazhimin ndërkombëtar ndaj të drejtave të personave LGBTIQ+, si pjesë e pandashme e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me qëllim identifikimin e mundësive potenciale për të përmirësuar parashikimet ligjore në të ardhmen.

### **2. Eksplorimi i Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ):**

-Metoda e Kërkimit Ligjor Konceptual: Kjo metodë e aplikuar përfshin një eksplorim të thellë të vendimeve kyçe të GJEDNJ-së në lidhje me çështjet e orientimit seksual, identitetit dhe shprehjes gjinore brenda sistemit të Këshillit të Evropës. Ekspertët hartues janë përqendruar në një analizë konceptuale të jurisprudencës në zhvillim, duke theksuar ndikimin e saj në formësimin e standardeve të respektimit, mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të personave LGBTIQ+ në nivel ndërkombëtar dhe në potencialin që sjell njohja dhe aplikimi i këtyre standardeve në praktikën ligjore në Shqipëri.

Metoda e analizës strategjike të vendimeve gjyqësore mes:

1. Mbledhja cilësore e të dhënave: Metoda cilësore kërkimore është aplikuar në studimin e rasteve dhe analizën e vendimeve gjyqësore për të kuptuar evoluimin e proceseve të gjyqësisë strategjike me në fokus çështjet e orientimit seksual, identitetit dhe shprehjes gjinore. Aplikimi i kësaj metode nga ekspertët hartues përfshin shqyrtimin evolutiv dhe sistematik të vendimarrjeve, duke nisur nga ato më të hershme e deri në ato më të reja; identifikimin e strategjive të suksesshme dhe njohjen e sfidave me të cilat është përballur praktika ligjore ndër kohëra në raport me këto çështje.

2. Metoda e analizës tematike dhe kërkimi socio-ligjor: Kjo metodë është aplikuar nga ekspertët hartues për të kategorizuar vendimarrjen e Gjykatës dhe për të eksploruar standarde të caktuara, nxjerrë dhe interpretuar respektivisht për tema të ndara (psh. Ndryshimi i standardeve mes vendimarrjeve që përfshijnë nevojën për një formë të njohjes ligjore për bashkimet e të njëjtit seks në raport me vendimarrjet që fokusohen specifikisht tek institucioni i martesës), duke synuar ofrimin e njohurive mbi konceptimin dhe planifikimin e çështjeve të gjyqësisë strategjike specifikisht në kontekstin shqiptar.

### **3. Rishikimi i Instrumenteve "Soft-Law":**

Rishikimi i Literaturës dhe Analiza Doktrinare: Ekspertët hartues e kanë aplikuar këtë metodë për të analizuar konceptin e instrumenteve të "ligjit të butë", duke u fokusuar veçanërisht në Parimet e Yogyakarta të dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM/Rek(2010)5, përmes analizës së kujdesshme të përmbajtjes së këtyre akteve dhe kërkimeve shkencore në raport me to. Ky seksion synon të sqarojë ndikimin e mundshëm të këtyre instrumenteve në drejtim të kornizave dhe praktikave të përmirësuara ligjore në raport me çështjet e orientimit seksual, identitetit dhe shprehjes gjinore.

#### **4. Sinteza, përfundimet dhe rekomandimet:**

1. Metaanaliza: Aplikimi i kësaj metode nga ekspertët draftues mundëson integrimin e gjetjeve nga çdo seksion të këtij vademekumi për të kryer një analizë që identifikon temat kryesore, standardet, tendencat dhe sfidat e kuadrit ligjor për individët LGBTIQ+ në Shqipëri.

2. Reflektimi kritik: Kjo metodë e aplikuar nga ekspertët draftues mundëson nxjerrjen e përfundimeve të rëndësishme duke marrë parasysh kufizimet e kërkimit shkencor në hartimin e këtij materiali, për të ofruar më pas sugjerime rreth adresimit dhe avancimit të vazhdueshëm të çështjeve ligjore që prekin të drejtat e personave LGBTIQ+ brenda sistemit ligjor shqiptar.



## **Kuadri aktual ligjor në raport me qytetarët LGBTIQ+:**

Respektimi i dinjiteti njerëzor dhe garantimi i të drejtave e lirive themelore të njeriut pa asnjë lloj diskriminimi, përfaqëson një standard të vendosur nga Kushtetuta jonë. Që në preambulën e Kushtetutës, është parashikuar garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si edhe zotimi për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor. Konkretisht, neni 3 i Kushtetutës parashikon se : “... dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij... janë baza e këtij shteti që ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato.” Nga ana tjetër, neni 18 i Kushtetutës, saktësisht parashikon anti-diskriminimin dhe në paragrafin e dytë të tij e rendit gjininë si një ndër shkaqet për të cilat askush nuk mund të diskriminohet. Ndodhur para këtyre parashikimeve të rëndësishme kushtetuese, lind detyrimi që të aplikohet një standard barazie i padiskutueshëm në gëzimin e të drejtave themelore, pa diskriminim, me qëllim njohjen ligjore të personave me orientim të ndryshëm seksual, fëmijëve të lindur në familje LGBTIQ+ dhe personave me identitet gjinor të ndryshëm nga seksi i regjistruar në lindje.

Nëse analizojmë disa nga të drejtat LGBTIQ+ të lidhura me struktura sociale tradicionale të tilla si martesë, familja, identiteti, etj., duket se rrugëtimi drejt barazisë dhe mosdiskriminimit ndodhet përpara një sërë vështirësish, të cilat sjellin cenimin e në disa raste edhe mohimin e disa të drejtave themelore të njeriut për personat LGBTIQ+.

## **Kuadri ligjor shqiptar në raport me njohjen ligjore të çifteve të të njëjtit seks:**

Ky seksion do të trajtojë në formën e një analize kontekstin ligjor shqiptar në lidhje me njohjen e martesave mes çifteve të të njëjtit seks. Do të shqyrtohen në mënyrë specifike garancitë dhe kufizimet kushtetuese, si edhe dispozitat e parashikuara në Kodin e Familjes që kanë të bëjnë me bashkëjetesën dhe martesën. Po ashtu, synon të trajtojë pasojat ligjore e sociale për çiftet “*de facto*” të të njëjtit seks që përballen me ekzistencën e boshllëqeve ligjore, të cilat nuk lejojnë garantimin, përfitimin dhe gëzimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga institute të tilla si bashkëjetesa dhe martesë. Për më tepër, do të paraqitet një pasqyrë e përpjekjeve aktuale rreth adresimit të njohjes ligjore të bashkimeve të çifteve të të njëjtit seks, duke nxjerrë në pah edhe angazhimet politike e institucionale të marra përsipër nga shoqëria civile.

## **Bashkëjetesa dhe Martesa brenda kornizës ligjore shqiptare nga perspektiva e bashkimeve të të njëjtit seks:**

Në Shqipëri ekziston një mungesë e dukshme e legjislacionit që njeh martesën dhe bashkëjetesën mes çifteve të të njëjtit seks, pavarësisht parashikimeve shumë të qarta të garancive kushtetuese. Ky boshllëk ligjor shkakton sfida të mëdha për çiftet e të njëjtit seks, të cilëve u mohohet e drejta të krijojnë një bashkim të njohur ligjërisht, marrëveshje pronësie të

përbashkët dhe t'i transferojnë të drejtat e trashëgimisë njëri-tjetrit pavarësisht rrethanave të tyre faktike. Angazhimet e Shqipërisë për të ruajtur dinjitetin njerëzor e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut pa diskriminim janë të parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë. Preambula e Kushtetutës thekson *“garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe detyrimin për të mbrojtur dinjitetin dhe identitetin njerëzor”*.<sup>1</sup>

Në nenin 3 të Kushtetutës thuhet shprehimisht se *“dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e njeriut janë bazat e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato”*.<sup>2</sup> Po ashtu, neni 18, i njohur si dispozita kundër diskriminimit, përfshin *“individualitetin si një nga kriteret mbi të cilat askush nuk mund t'i nënshtrohet diskriminimit”*.<sup>3</sup> Për më tepër, siç parashikohet në nenin 53, e *“drejta për martesë dhe jetë familjare është e garantuar për të gjithë qytetarët”*<sup>4</sup> dhe këto të drejta gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Zbatimi i këtyre standardeve të barazisë është i domosdoshëm edhe në raport me individët LGBTIQ+, duke siguruar gëzimin e të drejtave themelore pa diskriminim, me qëllim garantimi efektiv dhe praktik të të drejtave të të gjithë individëve nisur nga premisa e thjeshtë e të qenurit qenie njerëzore.

Rregullimi i marrëdhënieve martesore dhe zgjidhja e tyre në legjisllacionin shqiptar realizohet mes parashikimeve ligjore, kryesisht nga Kodi i Familjes (KF).<sup>5</sup> KF-ja, i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2003, parashikon martesën<sup>6</sup> dhe bashkëjetesën<sup>7</sup> si mjete të formimit të jetës familjare. Megjithatë, këto të drejta mbeten të rezervuara ekskluzivisht për çiftet heteroseksuale.

Që nga viti 2003, zhvillimet legjislative në kuadër të KF-së kanë mbetur dukshëm minimale, në kontrast me ndryshimet më dinamike të dëshmuara në fusha të tjera të së drejtës shqiptare.

KF-ja, në trajtimin e bashkëjetesës dhe parakushteve për hyrje në një martesë ligjore, kryesisht i kufizon këto institucione familjare brenda kufijve të heteroseksualitetit dhe heteronormativitetit. Konkretisht, neni 7 i KF-së përcakton në mënyrë eksplicite martesën si *“një bashkim i njohur ligjërisht, ekskluzivisht midis një burri dhe një gruaje, zakonisht të paktën 18 vjeç”*.<sup>8</sup>

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Preambula.

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa I, neni 3.

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa II, Kreu I, neni 18.

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu IV, neni 53.

<sup>5</sup> Ligji nr. 9062/2003, Kodi i Familjes i Shqipërisë.

<sup>6</sup> Ligji nr. 9062/2003, Kodi i Familjes i Shqipërisë, Titulli I-IV.

<sup>7</sup> Ligji nr. 9062/2003, Kodi i Familjes i Shqipërisë, Titulli V.

<sup>8</sup> Ligji nr. 9062/2003, Kodi i Familjes së Shqipërisë, Titulli I, neni 7.

Pas një shqyrtimi të plotë të dispozitave të KF-së, evidentohet qartë se martesë përfaqëson formën parësore të njohur të bashkëjetesës ligjore në Shqipëri. Ndërsa nenet 163 dhe 164 të KF-së prezantojnë një formë alternative të bashkëjetesës, e përshkruar si “*bashkim fakti mes një burri dhe një gruaje që jetojnë në çift, me një jetë të përbashkët, të qëndrueshme dhe të vazhdueshme*”.<sup>9</sup> Është e rëndësishme të theksohet se aktualisht mungon një ligj specifik mes të cilit do të realizohet rregullimi i kësaj marrëdhënie juridike në mënyrë më të detajuar. Megjithatë, ajo i lejon çiftet heteroseksuale të krijojnë marrëveshje pranë një noteri, ku do të parashikojnë të drejtat dhe detyrimet mes tyre në lidhje me fëmijët e aktivet e blera bashkërisht.

Në një vend si Shqipëria, situata “*de facto*” e çifteve të të njëjtit seks është e ndërlikuar, ku së bashku me sukseset e dukshme ligji nuk rregullon dhe nuk garanton të drejta të caktuara, madje në disa raste, ua mohon këto të drejta në mënyrë specifike grupeve të caktuara në shoqëri. Pabarazia midis asaj që quhet “*de iure*” dhe “*de facto*”, ka sjellë miratimin dhe zbatimin e akteve juridike të paplota dhe me mungesa ligjore.<sup>10</sup> Kjo situatë ka nxjerr në pah një realitet ku faktikisht këto akte juridike nuk janë kuptimplota dhe mbeten të pazbatueshme në lidhje me çiftet e të njëjtit seks, të cilët si qytetarë të barabartë kërkojnë që t’u njihen ligjërisht të drejtat e tyre.

Duke marrë parasysh disa nga të drejtat e njeriut që lidhen me strukturat tradicionale shoqërore si p.sh familja, martesë apo identiteti, duket se rrugëtimi drejt barazisë dhe mosdiskriminimit bëhet i vështirë për disa anëtarë të shoqërisë. Kështu, kjo situatë sjell mohimin e një sërë të drejtash themelore të personave LGBTIQ+, mohim ky që lind, midis të tjerave, nga mos hartimi i drejtë i legjislacionit.

Fakti që kuadri aktual ligjor duket se nuk ofron asnjë zgjidhje për çiftet e të njëjtit seks, është një përfundim i nxjerrë e njëkohësisht i theksuar nga një seri analizash dhe raportesh të organizatave ndërkombëtare, si Raporti i Komisionit Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës për Shqipërinë,<sup>11</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë,<sup>12</sup> Raporti i Përpiluar për

---

<sup>9</sup> Ligji nr. 9062/2003, Kodi i Familjes së Shqipërisë, Titulli V, neni 163.

<sup>10</sup> Dea Nini, Arta Mandro, Rina Kika, Strategjia e Litigimit Strategjik (Aleanca LGBTI 2022), 8.

<sup>11</sup> Raporti i Komisionit Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës për Shqipërinë, Cikli i Monitorimit, Këshilli të Evropës (2 qershor 2020).

<sup>12</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, (19 tetor 2021).

Shqipërinë nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut,<sup>13</sup> dhe konkluzionet përmbyllëse të CEDAW.<sup>14</sup>

Duke pasur parasysh mungesën e dukshme të njohjes ligjore për bashkimet e të njëjtit seks në ligjin shqiptar, pavarësisht se janë të qarta garancitë kushtetuese lidhur me të drejtën për jetë familjare dhe martesë për të gjithë, shtuar këtu edhe mungesën e mbështetjes politike, ka një prirje të natyrshme për të kërkuar njohjen e këtyre të drejtave përmes sistemit juridik.

Kjo qasje përfshin përdorimin e garancive kushtetuese dhe parimeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përmes gjykatave vendase dhe potencialisht atyre ndërkombëtare, një strategji në përputhje me atë që quhet proces gjyqësor strategjik. Në këtë këndvështrim, lind një pyetje thelbësore: ***A mund të jetë sistemi gjyqësor shqiptar një rrugë efektive e zbatueshme për sigurimin e të drejtave të partneritetit për çiftet e të njëjtit seks, nëpërmjet proceseve gjyqësore strategjike?***

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se *“pushteti gjyqësor do të ofrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen nga ligj”*.<sup>15</sup> Kjo dispozitë nënvizon përgjegjësinë e gjyqësorit për të adresuar çështjet ligjore në mënyrë gjithëpërfshirëse, pavarësisht nga boshllëqet apo paqartësitë e mundshme në ligj.

Në dritën e këtyre parashikimeve ligjore bëhet e qartë se sistemi gjyqësor shqiptar parimisht njeh mundësitë për trajtimin e çështjes së njohjes ligjore të çifteve të të njëjtit seks. Kjo çështje është në kompetencë të KPC-së dhe ligjeve të tjera që rregullojnë marrëdhëniet civile dhe çështjet familjare. Duke shfrytëzuar bazën ligjore dhe garancitë kushtetuese, për të adresuar këto boshllëqe brenda kuadrit ligjor bëhet imperativ sigurimi i të drejtave e mbrojtjes së barabartë për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

---

<sup>13</sup> Raporti për Shqipërinë i përpiluar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, (2019) A/HRC/WG.6/33/ALB/2.

<sup>14</sup> Vërejtjet përmbyllëse të CEDAW 60, Komiteti në kuadër të Konventës për Eliminimin e të Gjithëve

Formave e Diskriminimit kundër Grave, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Konventën për Eliminimin e të Gjithëve Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) (2016).

<sup>15</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa IX, neni 135.

## **Implikimet ligjore që sjell mungesa e njohjes ligjore për çiftet e të njëjtit seks dhe përpjekjet e deritanishme në këtë drejtim**

Siç u përmend më parë, KF-ja pranon ekskluzivisht martesën dhe bashkëjetesën si të vetmet forma të njohura ligjrisht për të rriturit në marrëdhënie të qëndrueshme. Kushtetuta jonë, nga referimi i KF-së si ligji që rregullon çështjet familjare, përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga martesa. Ky kuadër kushtetues thekson rolin kryesor të gjyqësorit në mbështetjen e tij të parimet e shtetit ligjor. Në nenin 1 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), shprehimisht parashikohet se “gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështjet e paraqitura, për shkak të mungesës së ligjit, apo kur ky i fundit është i paplotë, kontradiktor ose i paqartë”.<sup>16</sup> Duke qenë se e drejta për martesë dhe bashkëjetesë mbetet e kufizuar për individë heteroseksualë në marrëdhënie të qëndrueshme, automatikisht kjo e drejtë ju mohohet çifteve të të njëjtit seks.

Kjo mungesë rregullimi sjell pasoja të mprehta ligjore në jetën e përditshme, në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve për çiftet e të njëjtit seks. Në mungesë të një bashkimi të njohur e të rregulluar ligjrisht, këta individë nuk mund të përfitojnë nga dispozitat e KF-së, të cilat përkufizojnë e rregullojnë martesën apo bashkëjetesën, konkretisht të drejtat dhe detyrimet e individëve në secilën prej këtyre formave ligjore. E njëjta situatë paraqitet edhe për çështjet e pronësisë dhe prindërimit. Këto dispozita rregullojnë të gjithë sferën e jetës familjare që rrjedh nga martesa ose bashkëjetesa si dy forma të vetme juridikisht të njohura nga legjislati shqiptar. Ato prekin fusha të rëndësishme, ku mund të përmendim: kërkesat për lidhjen e martesës, mënyra e lidhjes së martesës, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, regjimi pasuror, regjimet pasurore të veçanta, pasojat e zgjidhjes së martesës, bashkëjetesa, amësia dhe atësia, detyrimet e rritjes së fëmijëve, emërtimi dhe zbatimi i përgjegjësive prindërore.

Këto implikime madhore ligjore, të cilat rrjedhin drejtpërdrejt nga mungesa e çdo lloji forme të njohjes ligjore për çiftet e të njëjtit seks, nuk u sigurojnë këtyre çifteve apo familjeve që ato kanë krijuar një mbrojtje ligjore, diferencim ky që ndodh vetëm duke u bazuar tek orientimi i tyre seksual.

Ndër kohëra janë bërë përpjekje të shumta për të rishikuar KF-në, me qëllim ligjërimin e bashkimeve mes çifteve të të njëjtit seks dhe të “familjeve ylber”<sup>17</sup>. Këto përpjekje janë fokusuar

---

<sup>16</sup> Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, neni 1.

<sup>17</sup> Termi 'familje ylber' përfshin familjet ku prindërit e së njëjtës gjini po rrisin një fëmijë, ose familjet të udhëhequr nga prindërit LGBTI+. Këto njësi të ndryshme familjare, ashtu si çdo familje tjetër, shfaqin një gamë të gjerë strukturash

kryesisht në ndryshimet lidhur me nenet që i kushtohen institutit të bashkëjetesës, por fatkeqësisht nuk kanë pasur rezultat. Përpjekjet janë bërë edhe për legalizimin e martesave të njëjtit seks, por pa sukses.

Edhe pse Ministria e Mbrojtjes Sociale dhe Rinisë (tani Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) ka hartuar legjislacionin me propozimet për ndryshime të mundshme në këtë drejtim, Shqipëria nuk ka ndërmarrë ende asnjë veprim për të ndryshuar ligjin, ndryshim ky që do të njihte bashkëjetesën e individëve LGBTIQ+. Pavarësisht advokimit dhe lobimit të vazhdueshëm nga organizatat e shoqërisë civile LGBTIQ+, legjislatori ka mbetur i palëkundur në qëndrimin e tij.

Edhe pse që nga viti 2012, qeveria shqiptare ka treguar një farë përkushtimi ndaj realizimit të të drejtave LGBTIQ+, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një sërë Planesh Kombëtare Veprimi për Personat LGBTI (PKV), në përgjithësi këto PKV nuk janë zbatuar në mënyrë korrekte dhe si rezultat, nuk kanë arritur të përmbushin shumicën e objektivave të vendosura.<sup>18</sup> Në vitin 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin LGBTI në Shqipëri”<sup>19</sup>, e cila ndër të tjera nënvizon në terma të përgjithshëm nevojën për ndryshimet ligjore dhe zbatimin e CM Rec(2010)5<sup>20</sup> nga të gjitha institucionet shtetërore.

Një sondazh i opinionit publik i vitit 2023, i kryer në rajonin e Ballkanit, zbulon se 43 për qind e shqiptarëve besojnë ende se të qenit LGBTIQ+ është një çrregullim, me 46 për qind që kundërshtojnë daljen hapur dhe dukshmërinë e individëve LGBTIQ+.<sup>21</sup> Këto qëndrime, pjesërisht, i atribuohen përjashtimit historik të personave LGBTIQ+ nga diskursi shoqëror dhe ligjor, duke përforcuar perceptimin në sy të publikut se statusi LGBTIQ+ është jonormal në krahasim me shumicën heteroseksuale. Kur u pyetën për qëndrimin rreth njohjes ligjore të bashkimeve civile ose martesave për çiftet e të njëjtit seks, 90 për qind e të anketuarve shprehën një qëndrim negativ.<sup>22</sup> Nisur nga kjo klimë, është e qartë pse politika shqiptare

---

dhe kompozimesh. Ato mund të përfshijnë familje të të njëjtit seks me dy nëna ose dy baballarë, si dhe familje që përfaqësojnë diversitetin gjinor në rolet e tyre prindërore.

<sup>18</sup> Dea Nini, Zbatimi i SDG-ve në kontekstin e Shqipërisë: Një perspektivë LGBTI+ (Aleanca LGBTI 2020), 28.

<sup>19</sup> Rezoluta “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT në Shqipëri”, (2015).

<sup>20</sup> Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi masat për të luftuar diskriminimi për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, Komiteti i Ministrave (31 mars 2010) CM/Rec(2010)5.

<sup>21</sup> Amarildo Fecanji, Raport Analitik i Sondazhit të Opinionit Publik (ERA - Shoqata për të Drejtat e Barabarta LGBTI+ për Ballkani Perëndimor dhe Turqinë, 2023), 17.

<sup>22</sup> Po aty, 34.

përmbahet nga adresimi i çështjeve që lidhen me çiftet e të njëjtit seks dhe çështje të tjera LGBTIQ+.

Përpyekjet dhe zhvillimet e deritanishme në raport me njohjen ligjore të të drejtave të personave LGBTIQ+ në Shqipëri tregojnë se ka mospërputhje të dukshme ndërmjet realitetit social dhe dispozitave ligjore. Këto rregullime ose mungojnë ose janë të paplota, duke rezultuar joefektive në lidhje me sigurimin e gëzimit efektiv të të drejtave themelore të njeriut nga qytetarët LGBTIQ+.

Në vitin 2022, Aleanca LGBTI hartoi një Strategji të Litigimit Strategjik<sup>23</sup> që synon arritjen e njohjes ligjore për çiftet e të njëjtin seks dhe individët transgjnorë. Kjo Strategji përshkruan elementet thelbësore për planifikimin e këtyre iniciativave dhe parashikon hapa të rëndësishme për nxitjen e ndryshimeve shoqërore, pavarësisht nga mungesa mbizotëruese e vullnetit në axhendat politike.

## **E drejta për njohjen e identitetit gjnor – ndryshimi i emrit dhe shenjuesit të gjinisë në dokumentet zyrtare**

### **Problematika të lidhura me kuadrin ligjor**

Aktualisht, situata e personave transgjnorë dhe atyre me gjini jo-binare në Shqipëri mbetet e parregulluar nga këndvështrimi juridik dhe ai praktik. Mungesa e një ligji mbi njohjen e identitetit gjnor pamundëson ndryshimin e gjinisë në dokumentet zyrtare për personat transgjnorë dhe me gjini jo-binare, sikurse theksohet edhe në raportin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të sesionit të 64-t të CEDAW.<sup>24</sup>

Kriminalizimi i punës së seksit, e cila shihet shpesh si mundësia e vetme për të mbijetuar nga shumë persona të komunitetit transgjnor, duke u bërë bashkë me pamundësinë e ndryshimit të treguesit të gjinisë, i bën personat transgjnorë veçanërisht të rrezikuar ndaj arrestimeve dhe vuajtjes së dënimeve arbitrare në mjedise me të dënuar të tjerë të të njëjtit seks, duke shkelur kështu të drejtat e tyre për dinjtet dhe integritet fizik, njëkohësisht duke i ekspozuar ndaj diskriminimit dhe dhunës së sigurt për shkak të identitetit gjnor.

Ligji nr.10 129/11.5.2009 “Për Gjendjen Civile”<sup>25</sup>, i ndryshuar, e rendit gjininë si një nga përbërësit e gjendjes civile (neni 6/1) dhe për pasojë si pjesë e identitetit të çdo individi. Neni 8 i LGjC-së parashikon se disa përbërës të gjendjes civile, përfshi këtu gjininë, mund të hiqen, të

---

<sup>23</sup> Nini, Mandro, Kika (n 56).

<sup>24</sup> UNDP (2017) Being LGBTI in Eastern Europe: Albania Country Report.

<sup>25</sup> Ligji nr. 10129, datë 11. 05. 2009 “Për Gjendjen Civile”.

shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në LGjC, apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Edhe pse LGjC-ja e njeh përbërësin "gjini" si të ndryshueshëm, në stadin aktual ky ligj nuk parashikon asnjë rregullim specifik, konkret në lidhje me procedurën e aplikueshme në raste të tilla. Po ashtu, rregullime të tilla mbi gjininë dhe "njohjen e saj" mungojnë në tërësi në kontekstin ligjor shqiptar.

Siç përcakton edhe neni 42 i LGjC-së gjinia është pjesë e përmbajtjes së aktit të lindjes. Ajo vërtetohet me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose me një procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.<sup>26</sup> Në mungesë të këtij dokumentacioni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të *provohet edhe nëpërmjet gjykatës*. Në rastin tonë, mungesa nuk e ka përfshirë elementin e ndryshimit të shenjuesit të gjinisë.

Nga parashtrimet e mësipërme kuptojmë se e dhëna në aktin e lindjes është "e ndryshueshme". Neni 44 i LGjC-së parashikon mundësinë e ndryshimit të të dhënës së aktit të lindjes: *"Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj"*. Pra, sipas LGjC-së, gjinia është përbërës i ndryshueshëm, por në këtë ligj nuk janë përcaktuar se cilat do të jenë hapat konkretë që duhet ndjekur për procedurën e ndryshimit të gjinisë dhe nuk ka parashikime ligjore të cilat do të rregullonin ndryshimin e gjinisë për shkaqe të lidhura me njohjen e identitetit gjinor. Nëse do të bënim një krahasim, në përmbajtjen e ligjit në fjalë, ka rregullime të detajuara për ndryshimin e emrit. Megjithatë, edhe për emrin si një përbërës i ndryshueshëm i gjendjes civile, nuk parashikohet mundësia e ndryshimit për shkak të ndryshimit të gjinisë.<sup>27</sup>

LGjC-ja bën disa klasifikime të përbërësve të gjendjes civile në: a) *përbërës të prezumuar* ose që rrjedhin nga veprimet e vetë personit; b) *përbërës që rrjedhin nga ngjarjet natyrore*. Kështu, gjinia renditet ndër përbërësit që rrjedhin nga ngjarje natyrore dhe si e tillë vërtetohet nga personat dhe organet që u njihet ky tagër.<sup>28</sup> LGjC-ja përkufizon në termat e referencës, kategorinë *"përbërës të prezumuar"*, duke nënvizuar se të tillë janë përbërësit e gjendjes civile, të cilët vlerësohen të mirëqenë deri në çastin që vërtetohet ndryshe. Përbërësit e përfshirë në *"të prezumuar"* janë *numerus clausus (listë shteruese)*. Këtu renditet amësia, atësia dhe familja. Gjinia nuk hyn në këtë kategori dhe për pasojë paraqitet në dy statuse që thuhet nuk konvergojnë me njëri tjetrin:

- a. Përbërës i ndryshueshëm
- b. Përbërës jo i prezumuar

---

<sup>26</sup> Shih neni 38, Ligji nr. 10129, datë 11. 05. 2009 "Për Gjendjen Civile": Dokumentet bazë të lindjes.

<sup>27</sup> Shih nenet 57 dhe 57/1, 57/2, 57/3, 57/4, 57/5, 57/6, 57/7, 57/8, 57/9 dhe 57/10, Ligji nr. 10129, datë 11. 05. 2009 "Për Gjendjen Civile".

<sup>28</sup> Shih neni 9, Ligji nr. 10129, datë 11. 05. 2009 "Për Gjendjen Civile".



Kështu, nëse përbërësi i gjendjes civile është rezultat i ngjarjes natyrore si fakt juridik që vërtetohet nga personat dhe organet e përcaktuara në ligj (neni 9/LGjC), ky fakt mund të kundërshtohet dhe për rrjedhojë të ndryshojë sipas mënyrave të parashikuara në ligj. Marrim për ilustrim rastin e amësisë, ku evidentojmë faktin se ekziston instituti i kundërshtimit të amësisë sipas dispozitave të Kodit të Familjes, të cilat parashikojnë rrugën gjyqësore. Neni 30 parashikon se, *“korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara bëhen vetëm me vendim gjyqësor të formës së prerë”*. Kopja e vendimit gjyqësor i bashkëlidhet dokumentit dhe çdo dokument i lëshuar në bazë të tij përmban elementet e përcaktuara në vendimin gjyqësor.

Si përfundim, ligji shqiptar “Për Gjendjen Civile”, si akti kryesor që parashikon aspektet e lidhura me njohjen ligjore të gjinisë, nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe e përmbajtjes së normës rregullatore, na krijon mundësinë të realizojmë *“njohjen e identitetit gjinor”*, duke mundësuar ndryshimin e gjinisë pasqyruar në dokumentin bazë të lindjes dhe për rrjedhojë në gjithë dokumentacionin e lëshuar nga Gjendja Civile përmes një ligji të ri të veçantë ose duke bërë ndërhyrje në ligjin bazë. Në mungesë të secilës prej këtyre iniciativave, rruga gjyqësore mbetet e vetmja zgjidhje aktuale për personat transgjinore dhe me gjini jo-binare në vendin tonë.

Gjatë ciklit të tretë të Rishikimit të Përgjithshëm Periodik, Shqipëria u tërhoq nga rregullimi ligjor i çështjes së njohjes së identitetit gjinor për personat transgjinorë, për të paktën 5 vitet e ardhshme.<sup>29</sup>

Edhe në raportin e OHCHR, “Diskriminimi mbi Bazat e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinor në Evropë”<sup>30</sup>, Shqipëria renditet si një nga shtetet ku mungojnë parashikimet për trajtimet specifike që performohen mbi personat transgjinorë dhe ku kostot e rehabilitimit pas ndërhyrjeve të tilla janë tejet problematike.

Në të njëjtën linjë, rekomandimet e fundit të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), theksojnë nevojën urgjente të njohjes ligjore të identitetit gjinor, përmes një procedure shtetërore transparente, të aksesueshme dhe të shpejtë.

---

<sup>29</sup>Shih: <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/upralun-contributions-s33>

<sup>30</sup> Komisioneri për të Drejtat e Njeriut - “Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Evropë” - Botimi i dytë: seksioni 5.2.

## Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

### Një Konsideratë mbi praktikën e GJEDNJ-së në një qasje evolutive ndaj vendimarrjeve në çështjet e njohjes së bashkimeve të të njëjtit seks

Ky sesion i këtij punimi synon të paraqesë evolucionin e standardeve për mbrojtjen dhe njohjen ligjore të bashkimeve ligjore të çiftëve të të njëjtit seks, duke marrë në analizë jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në kontekstin e Shqipërisë, GJEDNJ-ja shihet nga ekspertët dhe organizatat e shoqërisë civile si formësuesja më efektive e standardeve për të realizuar ndryshime thelbësore shoqërore, ku midis këtyre qëllimeve është edhe njohja e bashkimeve ligjore të çiftëve të të njëjtit seks përmes proceseve gjyqësore strategjike, pas shterimit të mjeteve juridike vendase.<sup>31</sup>

Shqipëria, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës dhe nënshkrues i KEDNJ-së, inkorporon Konventën në rendin juridik kombëtar, duke legjitimuar referencën ndaj praktikave të GJEDNJ-së në proceset gjyqësore kombëtare.<sup>32</sup> Ky seksion i punimit synon të shërbejë si një pikë referimi kryesore, për të përforcuar aspektet teknike të procesit gjyqësor strategjik, me qëllim njohjen ligjore të bashkimeve për çiftet e të njëjtit seks në Shqipëri, në nivel kombëtar dhe potencialisht, përpara GJEDNJ-së.

Sipas Grigolo, jurisprudenca e GJEDNJ-së ka kontribuar në krijimin e një subjekti juridik dikotomik, me fokus te heteroseksualiteti si normë dhe homoseksualiteti si “përjashtim”.<sup>33</sup> Ky diferencim brenda jurisprudencës së GJEDNJ-së e ka vendosur subjektin juridik homoseksual brenda një hapësire juridike private të tolerancës, e negociuar vazhdimisht në raport me heteroseksualin si normë universale. Vendosja e heteroseksualitetit si një standard moral dhe i sjelljes, i rrënjosur në familjen tradicionale formuar mbi baza biologjike, e ka përkufizuar homoseksualitetin si një devijim, të etiketuar me kalimin e kohës si “negativ”, “kriminal” dhe “patologjik”.<sup>34</sup> Duke ndërtuar një subjekt juridik homoseksual,<sup>35</sup> GJEDNJ-ja operon brenda një sistemi të ndërtuar kryesisht rreth një supozimi të heteroseksualitetit si vlerë universale. Siç theksohet më tej nga Grigolo, në jurisprudencën e GJEDNJ-së, që subjekti ligjor homoseksual të jetë ligjërish i njohur dhe të gëzojë mbrojtjen dhe garancitë e Konventës, është paraqitur

---

<sup>31</sup> Po aty, 3.

<sup>32</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa II, Kreu I, neni 17.

<sup>33</sup> Michele Grigolo, “Seksualitetet dhe GJEDNJ-ja: Prezantimi i Subjektit Ligjor Seksual Universal” (2003) 14, *Journal of International Law* 1023, 1.

<sup>34</sup> Michel Foucault, “Historia e seksualitetit”, Vëllimi i parë. Një hyrje (1981), 108.

<sup>35</sup> Po aty 5.

vazhdimisht si homologu i qëndrueshëm i subjektit heteroseksual brenda një logjike binare mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor, një perceptim që ka evoluar progresivisht pasi 'orientimi seksual' u kthye në një karakteristikë të mbrojtur nga diskriminimi.<sup>36</sup>

Pavarësisht standardeve pozitive të vendosura nga GJEDNJ-ja në lidhje me njohjen ligjore të të drejtave të personave LGBTIQ+, gjuha dhe qasja e përdorur ndonjëherë kanë përforcuar marginalizimin në praktikën gjyqësore. Për shembull, në Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>37</sup>, edhe pse kishte një domosdoshmëri për njohjen e të drejtave të këtyre individëve, Gjykata ende pranoi ekzistencën e një *“domosdoshmërie legjitime në një shoqëri demokratike për njëfarë shkalle kontrolli mbi sjelljen homoseksuale”*.<sup>38</sup>

Në Simpson kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>39</sup>, Komisioni përsëriti se diskriminimi që bazohet në ngjashmërinë e gjinive të partnerëve *“mund të arsyetohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme”*. Nga ana tjetër, është fakt i njohur se GJEDNJ-ja ka luajtur një rol kryesor në formësimin e drejtave të individëve LGBTIQ+.<sup>40</sup> Përmes përpjekjeve strategjike gjyqësore në raste specifike janë krijuar dhe njohur të drejta të rëndësishme për partnerët në marrëdhënie të të njëjtit seks dhe individët transgjinorë.

KEDNJ-ja e lidh kryesisht konceptin e jetës familjare me dy nene kyçe: nenin 8 dhe nenin 12. Në nenin 8, "jeta familjare" interpretohet si një hapësirë e mbrojtur në mënyrë ideale nga ndërhyrja e shtetit ku individët mund të organizojnë në mënyrë autonome private dhe, potencialisht, jetën familjare.<sup>41</sup> Anasjelltas, neni 12 e lidh familjen ngushtësisht me *“martesën midis një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën e martesës”*.<sup>42</sup> Rrjedhimisht, Gjykata e ka interpretuar kryesisht martesën nën ombrellën e nenit 12, pra si një e drejtë e rezervuar për çiftet e seksit të kundërt dhe i ka trajtuar shumicën e pretendimeve të çifteve të të njëjtit seks

---

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikim nr. 7525/76 (GJEDNJ, 22 tetor 1981).

<sup>38</sup> Po aty paragrafi 61.

<sup>39</sup> Simpson kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikim nr. 11716/85 (GJEDNJ, 1986) paragraf 67.

<sup>40</sup> Scherpe (n 1) 5.

<sup>41</sup> Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e ndryshuar) (KEDNJ) neni 8.

<sup>42</sup> Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e ndryshuar) (KEDNJ) neni 12.

brenda kontekstit të nenit 8 të Konventës. Kjo qasje është pritur shpesh me hezitim për t'i lidhur këto pretendime me nenin 14, i cili trajton mbrojtjen kundër diskriminimit, një aspekt që meriton diskutim të mëtejshëm.

Në çështjen Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar,<sup>43</sup> duke shënuar një largim nga praktika gjyqësore e mëparshme, Gjykata u shpreh se individët transeksualë pas kryerjes së operacionit kanë të drejtë të martohen me një person me seks të kundërt sipas parashikimeve të Konventës. Veçanërisht, Gjykata përcaktoi, në kontekstin e nenit 12 se “paaftësia e një çifti për të ngjizur një fëmijë nuk mund të barazohet me heqjen e të drejtës së tyre për të gëzuar garancitë e parashikuara në pjesën e parë të kësaj dispozite”,<sup>44</sup> duke theksuar të drejtën për t'u martuar. Për më tepër, Gjykata vërejti se në nenin 9 të Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore, ekuivalente me nenin 12 në Konventë, referencat për burrat dhe gratë ishin eliminuar, duke nënkuptuar një qasje më gjithëpërfshirëse.

Karner kundër Austrisë shënon një tjetër zhvillim pozitiv, pasi Gjykata njohu një shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8, për shkak të refuzimit të Gjykatës së Lartë së Austrisë për të trajtuar një partner në një marrëdhënie të të njëjtit seks, në formë të barabartë me partnerët e pamartuar të seksit të kundërt në përkufizimin e 'partnerit shoqëruar'.<sup>45</sup> Gjykata konstatoi se qeveria nuk kishte paraqitur asnjë arsye të vlefshme, e cila do të arsyetonte diskriminimin ndaj marrëdhënieve të të njëjtit seks dhe theksoi se një diskriminim i tillë nuk ishte i nevojshëm për të mbrojtur familjen tradicionale.<sup>46</sup>

Schalk dhe Kopf kundër Austrisë përfaqëson një moment historik dhe të rëndësishëm në jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me njohjen e bashkimeve të të njëjtit seks.<sup>47</sup> Kjo çështje e avancoi qëndrimin e Gjykatës në tri pika kryesore. Së pari, u sqarua se të drejtat që lindin nga lidhja e martesës sipas nenit 12 nuk janë të rezervuara në thelb për çiftet e seksit të kundërt “*në të gjitha rrethanat*”.<sup>48</sup> Së dyti, u pranua se çiftet e të njëjtit seks mund të krijojnë jetë familjare.<sup>49</sup>

---

<sup>43</sup> Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi nr. 28957/95 (GJEDNJ, 11 korrik 2002).

<sup>44</sup> Po aty, paragraf 98.

<sup>45</sup> Karner kundër Austrisë, Aplikimi nr. 40016/98 (GJEDNJ, 24 korrik 2003) paragrafi 70.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> Loveday Hodson, “Një martesë me ndonjë emër tjetër?” Schalk dhe Kopf kundër Austrisë” (2011) 11. Rishikimi i ligjit për të drejtat e njeriut 170, 1.

<sup>48</sup> Schalk dhe Kopf kundër Austrisë, Aplikimi nr. 30141/04 (GJEDNJ, 24 qershor 2010) paragrafi 105.

<sup>49</sup> Po aty, paragrafi 96.

Së treti, u theksua se Gjykata ishte në prag të kërimit prej shteteve anëtare që të ofrojnë një formë njohjeje ligjore për marrëdhëniet e të njëjtit seks.<sup>50</sup> Megjithatë, qasja e Gjykatës në këtë aktgjykim u duk disi një formë tentative, pasi nuk arriti të sigurojë që të drejtat e rëndësishme në lidhje me jetën familjare t'u siguroheshin efektivisht dhe në formë kuptimplotë të gjitha çiftëve të të njëjtit seks. Megjithatë, ky vendim hodhi bazat për një qëndrim më të rreptë të Gjykatës në çështjet që preknin marrëdhëniet e të njëjtit seks në jurisprudencën e mëvonshme.

Në çështjen Vallianatos kundër Greqisë<sup>51</sup>, Gjykata theksoi rëndësinë e madhe që ka njohja e partneritetit civil për çiftet e të njëjtit seks. Ajo nënvizoi se një akt i tillë kishte “një vlerë jetike” për këto çifte, pavarësisht nga pasojat ligjore që mund të sillte si rezultat kjo njohje.

Çështja “Oliari”<sup>52</sup> shënoi një kthesë të rëndësishme në jurisprudencën e GJEDNJ-së.<sup>53</sup> Ndërsa pohoi se nuk ekziston një e drejtë absolute për martesë për çiftet e të njëjtit seks sipas nenit 12 të Konventës, një qëndrim në përputhje me vendimarrjen në Schalk kundër Austrisë, Oliari prezantoi një perspektivë të re ku duhej vlerësuar një shkelje e mundshme e nenit 8. Në këtë çështje Gjykata vendosi se Italia, sipas Konventës, është e detyruar të sigurojë njohjen ligjore të çiftëve të të njëjtit seks në formën e një njohjeje në regjistrat civil ose në formën e një partneriteti të regjistruar në institucionet ligjore kompetente. Kjo vendimarrje e Gjykatës ishte në kontrast me vendimarrjen në çështjen Schalk, ku ajo konstatoi se Austria, e cila nuk kishte njohur marrëdhëniet e të njëjtit seks midis viteve 2004 dhe 2010, nuk ishte në shkelje të detyrimeve të saj konventore. Ky ndryshim ishte i dukshëm sepse Schalk u gjykua në vitin 2010, kur vetëm nëntëmbëdhjetë nga dyzet e shtatë anëtarë të Këshillit të Evropës njihnin një formë të marrëdhënieve mes çiftëve të njëjtit seks,<sup>54</sup> ndërsa në kohën e shqyrtimit të çështjes Oliari, ky numër ishte rritur në njëzet e katër.<sup>55</sup> Gjykata pranoi se çiftet e të njëjtit seks janë plotësisht të afta të formojnë marrëdhënie të qëndrueshme e të përkushtuara, njëjloj si çiftet heteroseksuale, dhe si pasojë shtetet detyrohen të garantojnë një formë njohjeje dhe mbrojtjeje ligjore. Kjo vendimarrje imponoi një detyrim pozitiv për shtetet anëtare në kuadër të nenit 8, ku Gjykata vërejti një mospërputhje midis ligjit italian dhe realitetit social, duke vënë në dukje se ankuesit

---

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë, Aplikimi nr 29381/09, 32684/09 (GJEDNJ, 7 nëntor 2013).

<sup>52</sup> Oliari dhe të tjerët kundër Italisë, Aplikimi nr. 18766/11, 36030/11 (GJEDNJ, 2015).

<sup>53</sup> Nazim Ziyadov, “Nga drejtësia në padrejtësi: Ulja e pragut të konsensusit evropian në ‘Oliari dhe të tjerët’ kundrejt Italisë” (2019) 26 Indiana Journal of Global Legal Studies 631, 4.

<sup>54</sup> Po aty 6.

<sup>55</sup> Po aty.

mund ta jetonin hapur jetën e tyre, pa u përballur me kundërshtime shoqërore. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi në shkelje qeverinë italiane në lidhje me nenin 8. Pas evidentimit të kësaj shkeljeje, ajo vlerësoi se shqyrtimi i shkeljes së pretenduar të nenit 14 ishte e panevojshme. Siç vërehet nga Shahid, Gjykata ka përdorur vazhdimisht doktrinën e konsensusit evropian, duke arsyetuar në një sërë rastesh, duke përfshirë Oliari dhe të tjerë,<sup>56</sup> Hämäläinen<sup>57</sup> e Chapin dhe Charpentier.<sup>58 59</sup>

**Vendimarrja e GJEDNJ-së në raport me konsideratat e pretendimeve të çifteve të të njëjtit seks për martesë në rastet që përfshijnë raportin me çështje të ndjeshme morale, etike dhe fetare:**

Siç vërehet nga shumë autorë, ndër to Shehid<sup>60</sup> dhe O`Hara,<sup>61</sup> kjo qasje paraqet mangësi të dukshme pasi mund të sjellë një trajtim të pabarabartë të pakicave nga shumica në shtete të ndryshme anëtare. Siç vërehet më tej nga Scherpe, kjo praktikë e ndjekur nga GJEDNJ-ja do të thotë se Gjykata nuk i heton thellë arsyet e vendimit të një shteti në lidhje me martesat e çifteve të të njëjtit seks, për t'i lënë hapësirë shteteve të veprojnë mbi baza diskriminuese, duke ngritur shqetësime rreth nevojës për më shumë mbrojtje dhe masa më të rrepta kundër një diskriminimi të tillë.<sup>62</sup>

GJEDNJ-ja ka identifikuar tri kategori kryesore të pasojave ligjore që lidhen me skemat ligjore të njohjes për çiftet e të njëjtit seks. Së pari, “pasojat materiale”, të cilat përfshijnë çështje si taksat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, pensionet, të drejtat e trashëgimisë dhe masat ndihmëse. Së dyti, pasojat “prindërore”, duke përfshirë të drejtën për të adoptuar dhe

---

<sup>56</sup> Oliari dhe të tjerët kundër Italisë, Aplikimi nr. 18766/11, 36030/11 (GJEDNJ, 2015).

<sup>57</sup> Hämäläinen kundër Finlandës, Aplikimi nr. 37359/09 (GJEDNJ, 2014).

<sup>58</sup> Chapin dhe Charpentier kundër Francës Aplikacioni nr. 40183/07 (GJEDNJ, 2009).

<sup>59</sup> Masuma Shahid, “E drejta për martesë e çifteve të të njëjtit seks: Vlerësimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” Konsensus- Analiza e bazuar në gjykimet e fundit në lidhje me të drejtat e barabarta në martesë” (2017) 10 Rishikimi i Ligjit Erasmus 184, 2.

<sup>60</sup> Po aty 3.

<sup>61</sup> Claerwen O'Hara, “Konsensusi, Diferenca dhe Seksualiteti: ‘Que(e)Rying the European Court of Human Rights’”.

<sup>62</sup> Scherpe (n 1) 3.

fekondimi artificial. Së treti, “pasojat e tjera”, si përdorimi i mbiemrit të partnerit, vendbanimi, lejet, shtetësia dhe të drejtat e trashëgimisë.<sup>63</sup>

Ndërsa në shumicën e shteteve anëtare kuadri ligjor lidhur me njohjen e çifteve të të njëjtit seks duket se i trajton ato në mënyrë të barabartë për sa i përket pasojave “materiale”, ka dallime të rëndësishme në lidhje me pasojat “prindërore”. GJEDNJ-ja ka vendosur se çiftet e të njëjtit seks kanë nevojë të ngjashme për njohje ligjore dhe mbrojtje të marrëdhënieve të tyre krahasuar me çiftet e seksit të kundërt. Prandaj, refuzimi për t'i dhënë akses në martesë përbën një trajtim të diferencuar bazuar në orientimin e tyre seksual.<sup>64</sup> Dallime të tilla kërkojnë një arsyetim veçanërisht serioz.

Është e qartë se GJEDNJ-ja është përballur dhe ende përballet me sfidën e balancimit të mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe ruajtjes së besueshmërisë të autoriteti i saj, veçanërisht në raport me Shtetet Anëtare që mund të mos jenë entuziaste për promovimin e të drejtave LGBTIQ+. Vende të ndryshme mund të miratojnë mekanizma të ndryshëm për njohjen e çifteve të të njëjtit seks, nga shtrirja e ligjeve tradicionale të martesës, në krijimin e kornizave ligjore alternative. Megjithatë, këto alternativa mund të institucionalizojnë diskriminimin. Nëse një Shtet Anëtar ofron përfitime të barabarta përmes martesës tradicionale dhe bashkimeve civile ose partneriteteve në varësi të statusit heteroseksual ose homoseksual, atëherë do të ndodhemi para ekzistencës së dy institucioneve paralele. Nëse këto institucione ofrojnë përfitime identike, arsyetimi se duhet siguruar ruajtja e tyre shndërrohet në një element që mund të rezultojë diskriminues. Siç vërehet më tej nga O`Hara, mbështetja e madhe e GJEDNJ-së në doktrinën e konsensusit evropian, pa një bazë të qartë standarde, përbën një kërcënim serioz për pavarësinë e gjyqësorit.<sup>65</sup> Arsyetimi ligjor ndaj zhvillimeve të paparashikueshme në Shtetet Anëtare çënon pavarësinë e drejtësisë. Janë propozuar disa zgjidhje për të adresuar këtë çështje. GJEDNJ-ja mund të adoptojë një qasje evolutive, duke aplikuar analizën e bazuar në konsensus në mënyra të ndryshme dhe duke u fokusuar te fakti se shtetet duhet të eksplorojnë zbatimin e nenit 14 në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, mes përdorimit të një interpretimi më kreativ dhe gjithëpërfshirës të nenit 3.<sup>66</sup>

---

<sup>63</sup> Po aty 4.

<sup>64</sup> Shahid (n 105) 5.

<sup>65</sup> O`Hara (n 107) 2.

<sup>66</sup> Po aty 4.

Në rastin e rëndësishëm Fedotova<sup>67</sup>, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së duhet të trajtonte nëse KEDNJ vendos një detyrim të përgjithshëm pozitiv për shtetet që ato të ofrojnë një formë njohjeje ligjore për çiftet e të njëjtit seks, qoftë mes njohjes së martesës ose një formë tjetër ekuivalente. Në një vendimarrje me shumicë prej katërbëdhjetë votash pro dhe tre kundër, Gjykata konstatoi se Rusia kishte shkelur nenin 8 të KEDNJ-së duke mos justifikuar mungesën e çdo forme të njohjes ligjore për çiftet e të njëjtit seks me arsyetimin se kërkohej të mbrohej interesi publik dhe familja tradicionale, duke marrë parasysh pikëpamjet negative të shumicës së popullsisë për bashkimet e të njëjtit seks. Njëkohësisht, rrëzoi edhe pretendimin tjetër të shtetit rus se synohej të mbroheshin të miturit nga promovimi i homoseksualitetit. Gjykata i hodhi poshtë këto arsyeime, duke pohuar se ato pasqyronin një mosmiratim moral të marrëdhënieve të të njëjtit seks, duke deklaruar se nuk mund të miratonte politika që synonin të përjetësonin pabarazitë nga një shumicë heteroseksuale kundër një pakice homoseksuale. Po ashtu, Gjykata theksoi se traditat, stereotipet dhe qëndrimet mbizotëruese shoqërore nuk mund të shërbejnë si justifikim, aq më tepër arsye për një diskriminim të këtij lloji dhe kësaj mase. Gjykata theksoi shprehimisht se sigurimi i njohjes dhe mbrojtjes ligjore për çiftet e qëndrueshme dhe të përkushtuara të të njëjtit seks nuk i dëmtonte familjet që i përmbahen normave tradicionale dhe nuk rrezikon integritetin e tyre në të ardhmen. GJEDNJ-ja identifikoi një detyrim pozitiv të përgjithshëm për Shtetet Anëtare, të cilat duhet të ofronin mbrojtje ligjore për çiftet e të njëjtit seks, duke ofruar të paktën një formë të njohjes ligjore të bashkimeve të tyre që gjeneronte të drejta dhe detyrime të njëjta me martesën. Ky detyrim pozitiv bazohej në një “tendencë të vazhdueshme”, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, drejt njohjes ligjore për çiftet e të njëjtit seks. Gjykata zbatoi nenin 8, jo vetëm në kuptimin tradicional të tij, por duke përfshirë të drejtën për të zhvilluar identitetin social.<sup>68</sup> Kjo vendimarrje thekson se orientimi seksual tanimë ka marrë dimensione private dhe publike, duke pohuar se çiftet e të njëjtit seks duhet të kenë lirinë për të jetuar të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë marrëdhëniet e tyre. Nocioni se njohja juridike është thelbësore në identitetin social të çifteve të të njëjtit seks ishte pranuar më parë nga Gjykata edhe në çështjet Vallianatos<sup>69</sup> dhe Oliari<sup>70</sup>. Megjithatë, vendimi i

---

<sup>67</sup> Fedotova dhe të tjerët kundër Ruisë, Aplikimi nr. 40792/10, 30538/14, 43439/14 (GJEDNJ, 17 janar 2023).

<sup>68</sup> Fedele (n 114) 5. Giulio Fedele, “GJEDNJ, moment historik apo mundësi e humbur? Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së në Fedotova kundër Ruisë mbi Njohjen Ligjore të Çifteve të të njëjtit seks”, 3.

<sup>69</sup> Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë (n 96).

<sup>70</sup> Oliari dhe të tjerët kundër Italisë (n 98).



marrë për çështjen Fedotova shënoi një kthesë në jurisprudencë, pasi Gjykata e përktheu këtë ide në një garanci ligjore të mbrojtur nga neni 8 i KEDNJ-së.<sup>71</sup>

Një tjetër përfundim i rëndësishëm që mund të nxirret nga rasti Fedotova lidhet me mënyrën se si Gjykata përdori konceptin e konsensusit shoqëror. Gjykata e filloi analizën e saj duke interpretuar nenin 8, ku theksoi se tashmë duhej siguruar një njohje dhe mbrojtje ligjore universale për çiftet e të njëjtit seks. Doktrina e konsensusit u analizua më pas për të forcuar këtë interpretim, por nuk ishte mjeti kryesor i përdorur në vendimarrje. Interpretimi i Gjykatës në lidhje me nenin 8 udhëhiqej nga qëllimi për të mbrojtur në mënyrë efektive jetën private dhe familjare të individëve në marrëdhënie të të njëjtit seks, në përputhje me vlerat e një shoqërie demokratike, duke përfshirë pluralizmin, tolerancën, mendjegjerësinë, parimet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe vlerat e Konventës. Në këtë rast, konsensusi u përdor për të përforcuar këtë interpretim të nxjerrë nga një analizë kontekstuale dhe funksionale e nenit 8 dhe jo si bazë e vetme për krijimin e interpretimeve të reja.

Edhe në këtë çështje GJEDNJ-ja refuzoi të merrte në konsideratë pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 14. Ky qëndrim i mbajtur në vazhdimësi nga Gjykata rrezikon të thellojë një qasje heteronormative në vendimarrje.<sup>72</sup> Për rrjedhojë, kjo qasje rrezikon të interpretohet mbi presupozimin se Gjykata nuk i sheh realisht dhe efektivisht si të barabarta çiftet e të njëjtit seks. Kjo qasje analitike përputhet me këndvështrimin e mendimit kundërshtues të gjyqtarit Wojtyczek në çështjen Fedotova.<sup>73</sup>

Edhe në çështjen Buhuceanu, Gjykata mund të kishte mbajtur një qëndrim më proaktiv, duke u mbështetur më pak në doktrinën e konsensusit<sup>74</sup>. Në vendimarrjen Fedotova, Gjykata pranoi se çiftet e të njëjtit seks kanë të drejtë të formojnë identitetin e tyre privat dhe shoqëror brenda kuptimit të nenit 8, duke u dhënë atyre autonomi në mënyrën se si vendosin të shfaqen dhe jetojnë në shoqëri. Ky arsyetim mungonte në vendimin Buhuceanu pavarësisht vendimarrjes finale që pranonte pretendimet e kërkuesve. Gjithashtu, Gjykata vijoi të mos pranojë të shqyrtojë pretendimet në lidhje me nenin 14<sup>75</sup>, çka vijon të përfaqësojë një mosgatishmëri për t'u

---

<sup>71</sup> Fedotova dhe të tjerët kundër Ruisë (n 113) paragrafët 200-201.

<sup>72</sup> O'Hara (n 107) 3.

<sup>73</sup> Po aty, paragraf 50.

<sup>74</sup> Buhuceanu dhe të tjerët kundër Rumanisë, Aplikimi nr. 20081/19 dhe 20 të tjerë (GJEDNJ, 23 maj 2023).

<sup>75</sup> Po aty, paragraf 50.

angazhuar efektisht në adresimin e dëshmime të qarta të diskriminimit bazuar në orientimin seksual në raport me ruajtjen e një koherence dhe stabiliteti në statuskuonë e vet.

## **PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE KRYESORE LIDHUR ME IDENTITETIN GJINOR, ORIENTIMIN SEKSUAL DHE ASPEKTE TË PRINDËRIMIT**

*Duke mbajtur parasysh rëndësinë e Konventës, evoluimin e vazhdueshëm të jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe kontributin e këtyre instrumenteve në avancimin e njohjes ligjore dhe sigurimit të mbrojtjes efektive të individëve dhe komuniteteve LGBTIQ+ në Evropë, kemi kënaqësinë të ndajmë me lexuesit një përmbledhje të jurisprudencës kryesore që përfshin çështjet e OSIGJKS. Përmes kësaj përmbledhjeje synojmë të ravijëzojmë evoluimin e qëndrimeve të GJEDNJ-së ndaj çështjeve LGBTIQ+ ndër vite, si dhe të sjellim ekstrakte të vendimmarrjes në çështjet kryesore ku ravijëzohen parime dhe qëndrime me vlerë, njohja e të cilave është me rëndësi për publikun, profesionistët e drejtësisë dhe institucioneve të pavarura në kuadër të litigimit strategjik për njohjen ligjore të komuniteteve shqiptare LGBTIQ+.*

### **Çështje të identitetit gjinor:**

- Evoluimi i jurisprudencës nga çështja “Rees” në çështjen “Goodwin”

### **Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar (17 tetor 1986)**

Në këtë çështje, një transeksual që kishte kryer tranzicionin prej seksit femër në mashkull u ankua se ligji i Mbretërisë së Bashkuar nuk i krijonte mundësinë e pasjes së një statusi ligjor që korrespondonte me gjendjen e tij faktike pas tranzicionit (gjinia aktuale nuk përkonte me shenjuesin e gjinisë në dokumentet zyrtare).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Gjykata u shpreh, se ndryshimet e kërkuara nga aplikanti kërkonin modifikimin rrënjësor të sistemit për mbajtjen e regjistrit të lindjeve, i cili do të kishte pasoja të rëndësishme administrative dhe do të vendoste detyrime të reja për pjesën tjetër të popullsisë. Për më tepër, Gjykata i kushtoi rëndësi faktit që Mbretëria e Bashkuar kishte përballuar kostot e trajtimit mjekësor të kërkuarit.

Megjithatë, Gjykata ishte e ndërgjegjshme “për seriozitetin e problemeve që prekin transeksualët dhe shqetësimet e tyre” dhe rekomandoi “mbajtjen nën shqyrtim të nevojës për masat e duhura, duke pasur parasysh veçanërisht zhvillimet shkencore dhe sociale” (§ 47 e vendimit).

Gjykata u shpreh se në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 12 (e drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje) të Konventës të pretenduar nga ankuesi, pasi *“koncepti tradicional i martesës bazohej në bashkimin midis personave të seksit të kundërt biologjik”*. Shtetet kishin një hapësirë veprimi në rregullimin ligjor të së drejtës për t'u martuar.

### **Cossey kundër Mbretërisë së Bashkuar (27 shtator 1990)**

Edhe në këtë çështje që mund ta konsiderojmë ndër më të hershmet, Gjykata arriti në përfundime të ngjashme si në çështjen *“Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar”*, duke mos gjetur fakte të reja ose rrethana të veçanta që do ta shtynin të tërhiqej nga vendimi i mëparshëm.

Gjykata u shpreh, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës dhe përsëriti se *“kirurgjia e ndryshimit të gjinisë nuk rezulton në përvetësimin e të gjitha karakteristikave biologjike të seksit tjetër”* (§ 40 e vendimit). Gjithashtu, Gjykata vendosi në dukje se, *“kryerja e një shënimi në regjistrin e lindjes nuk do të ishte një zgjidhje e përshtatshme dhe afatgjatë për personat transeksualë”*.

Gjykata u shpreh se në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 12 (e drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje), pasi lidhja me konceptin tradicional të martesës siguronte *“arsye të mjaftueshme për ruajtjen e kritereve biologjike për përcaktimin e seksit të një personi, për qëllime martesë”*. Gjykata shprehet se u takonte shteteve kombëtare të rregullonin ushtrimin e së drejtës për t'u martuar përmes ligjit kombëtar.

### **B. kundër Francës (kërkesa nr. 13343/87) (25 mars 1992)**

Ky rast përfaqëson rastin e parë ku shfaqet evoluim i praktikës së Gjykatës në raport me ankesat e sjella nga individët transeksualë për njohjen e gjendjes së tyre faktike.

Një grua transeksuale (kishte kryer tranzicion nga seksi mashkull në femër) u ankua mbi refuzimin e autoriteteve franceze për të ndryshuar shenjuesin e gjinisë në regjistrin e gjendjes civile në përputhje me dëshirën dhe gjendjen e saj faktike.

Gjykata vendosi se në këtë rast kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke marrë parasysh faktorët që dallojnë çështjen e *“B. nga Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar”* dhe *“Cossey kundër Mbretërisë së Bashkuar”*, veçanërisht ndryshimet midis sistemit të Mbretërisë së Bashkuar dhe sistemit të statusit civil francez. Ndërkohë, në Mbretërinë e Bashkuar kishte pengesa të konsiderueshme që pengonin ndryshimin e certifikatave të lindjes, në Francë synohej përditësimi i këtyre akteve gjatë gjithë jetës së personit në fjalë. Gjykata vuri në dukje se në Francë shumë dokumente zyrtare shfaqnin *“një mospërputhje midis seksit të përcaktuar në dokumentet ligjore dhe gjinisë faktike të individëve transeksualë”* (§ 59 e vendimit). Kjo mospërputhje dallohej edhe në dokumentet e sigurimeve shoqërore dhe në fletëpagesat për llogari të këtyre individëve, prandaj Gjykata u shpreh se *“refuzimi për të ndryshuar shenjuesin e gjinisë në regjistrin e gjendjes civile në lidhje e kishte vendosur kërkuesen në një situatë të përditshme që nuk ishte në përputhje me respektimin e jetës së private”*.

### **X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 21830/93) (22 prill 1997)**

Kërkuesi i parë, X, ishte një burrë transeksual (seksi biologjik ishte femër) që jetonte në një lidhje të qëndrueshme dhe permanente me aplikanten e dytë, Y, një grua. Aplikanti i tretë, Z, lindi nga aplikantja Y, njëherazi partnerja e kërkuesit X, si rezultat i inseminimit artificial me dhurues. Kërkuesit u ankuan se mungesa e njohjes ligjore të marrëdhënies midis X dhe Z përbënte shkelje të nenit 8 të Konventës.

Në këtë çështje, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, por pranoi ekzistencën e jetës familjare midis një transeksuali dhe fëmijës së partnerit të tij, duke u shprehur se, *“X ka vepruar si ‘babai’ i Z në çdo aspekt që nga lindja”*. Në këto rrethana, Gjykata vlerësoi se lidhjet *“de facto”* familjare i lidhin të tre kërkuesit sëbashku. (§ 37 e vendimit).

### **Sheffield dhe Horsham kundër Mbretërisë së Bashkuar (30 korrik 1998)**

Në këtë rast, Gjykata nuk u bind se duhej të zhvendosej nga gjykimi i “Rees” dhe “Cossey” (shih më lart, faqe 1): transeksualizmi vazhdon të ngrejë çështje komplekse shkencore, ligjore, morale dhe sociale në lidhje mbi të cilat nuk ka një qasje të përbashkët midis Shteteve Kontraktuese” (§ 58 i vendimit).

Gjykata u shpreh se nuk kishte shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 12 (e drejta për t'u martuar dhe krijuar familje) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Megjithatë, u ripohua *“se kjo fushë duhet të mbahet nën një rishikim të përhershëm nga Shtetet Kontraktuese” (§ 60 i vendimit), në kontekstin e pranimin social në rritje të fenomenit dhe njohjes së problemeve me të cilat personat transeksual përballen pas operacionit”*.

### **Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar (11 korrik 2002) (Dhoma e Madhe)**

Kërkuesja u ankua për mungesën e njohjes ligjore të gjinisë së saj të ndryshuar dhe në veçanti për trajtimin e saj sa i përkiste punësimit, skemës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pamundësisë për t'u martuar.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, pasi vitet e fundit vihej re një tendence e qartë dhe e vazhdueshme ndërkombëtare drejt rritjes së pranimin social të transeksualëve dhe drejt njohjes ligjore të identitetit të ri gjinor pas operacionit. *“Duke qenë se nuk ka faktorë të rëndësishëm të interesit publik që të prevalojnë ndaj interesit individual të kërkueses për njohje ligjore të gjinisë së saj faktike, Gjykata doli në përfundimin se, “nocioni i ruajtjes së ekuilibrit të drejtë anonte në mënyrë vendimtare në favor të kërkueses” (§ 93 i vendimit).*

Gjykata u shpreh gjithashtu se kishte pasur shkelje të nenit 12 (e drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje) të Konventës. Gjykata *“nuk u bind se kushtet e nenit 12 lidhur me martesën nuk duhet t'i referoheshin më përcaktimit të gjinisë mbi kriteret thjesht biologjike” (§ 100).* Gjykata

vendosi se i takonte hapësirës së vlerësimit të çdo shteti përcaktimi i kushteve dhe kritereve të martesave transeksuale, por *“nuk gjen asnjë justifikim për ndalimin e gëzimit të së drejtës së individëve transeksualë për t’u martuar në asnjë rrethanë”*. (§ 103).

Kjo çështje mbart një rëndësi të veçantë, pasi përfaqëson një pikë evoluimi në praktikën e Gjykatës sa u përket të drejtës së personave transeksualë për njohje ligjore në përputhje me gjendjen faktike dhe për t’u lidhur në martesë. Një arsytim i ngjashëm u përdor edhe në çështjen I. kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 25680/94), ku Gjykata konstatoi sërish shkelje të nenit 8 dhe shkelje të nenit 12 të Konventës. Pas vendimit të Dhomës së Madhe në rastin e Christine Goodwin, Mbretëria e Bashkuar prezantoi një sistem kombëtar përmes të cilit transeksualët mund të aplikonin për një certifikatë njohjeje gjinore në mënyrë të aksesueshme dhe pa vonesa.

### **Parry kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 42971/05) & R. dhe F. kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 35748/05) (28 nëntor 2006) (vendime mbi pranueshmërinë)**

Aplikantët ishin përkatësisht të martuar dhe kishin fëmijë. Në secilin rast, ata i ishin nënshtruar një operacioni të ndryshimit të seksit dhe pas operacionit kishin vijuar jetën në çift me bashkëshortet respektive. Pas prezantimit të Aktit të Njohjes Gjinore në vitin 2004, aplikantët që i ishin nënshtruar operacionit të ndryshimit të seksit bënë një aplikim për lëshimin e një Certificate të Njohjes Gjinore, për të cilën vendosej si kusht përfundimi i martesës së tyre aktuale. Aplikantët u ankuan veçanërisht në bazë të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 12 (e drejta për t’u martuar) të Konventës.

Gjykata i shpalli të dyja kërkesat të papranueshme (qartësisht të pabazuara). Kërkuesve ju kërkua të përfundonin martesat e tyre pasi martesat e brenda së njëjtës gjini nuk lejoheshin sipas ligjit anglez. Gjykata u shpreh se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte arritur të mundësonte njohjen ligjore të gjinisë faktike dhe bashkë me detyrimin për të përfunduar martesat, aplikantët mund të vijonin marrëdhëniet e tyre përmes partneriteteve civile që passillnin të drejta dhe detyrime ligjore mjaft të ngjashme me martesën. Gjykata vuri në dukje se, kur u prezantua sistemi kombëtar i njohjes gjinore pas gjykimit të Christine Goodwin, ligjvënësi ishte i vetëdijshëm për faktin se kishte një numër të vogël transeksualësh në martesë ekzistuese, por qëllimisht nuk parashikoi që këto martesë mund të vazhdonin në rast se një partner përdorte procedurën e njohjes gjinore.

### **Vendimet e fundit të Gjykatës**

#### **Van Kück kundër Gjermanisë (12 qershor 2003)**

Kërkuesja u ankua për padrejtësinë e pretenduar të procedurave gjyqësore gjermane në lidhje me kërkesën e saj për rimbursimin e procedurës së ndryshimit të gjinisë, kundrejt një kompanie private të sigurimit shëndetësor. Aplikantja konsideronte se mes vendimeve të dhëna, gjykatat kombëtare kishin shkelur të drejtën e saj për respektimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të jetës private.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6/1 (e drejta për një gjykim të drejtë) të Konventës, pasi gjykatat gjermane nuk kishin kërkuar sqarime të mëtejshme nga një ekspert mjekësor gjatë procesit. Gjykata u shpreh se procesi në tërësi nuk kishte përmbushur kërkesat që e bëjnë një proces të drejtë.

Gjykata u shpreh gjithashtu, se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Meqenëse identiteti gjinor ishte një nga aspektet më intime të jetës private të një personi, ishte joproportionale t'i kërkohej aplikantit të provonte nevojën mjekësore të trajtimit përpara gjykatës kombëtare. Vendimi thekson se nuk ishte ruajtur asnjë ekuilibër i drejtë midis interesave të kompanisë private së sigurimit nga njëra anë dhe interesave të individit nga ana tjetër.

### **Grant kundër Mbretërisë së Bashkuar (23 maj 2006)**

Kërkuesi ishte një burrë transeksual 68 vjeçar, që kishte kryer operacionin e ndërrimit të seksit. Ai u ankua për mungesën e njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë dhe refuzimin nga ana tjetër për t'i paguar një pension në moshën e zbatueshme për gratë e tjera (60 vjeç).

Gjykata u shpreh se në këtë rast kishte shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Ajo vërejti se kërkuesi kishte qenë në një situatë identike me atë të Christine Goodwin. Pas gjykimit të Christine Goodwin, nuk kishte më asnjë justifikim për mosnjohjen e ndryshimit të gjinisë së transeksualëve pas operacionit. Kërkuesi në atë kohë nuk kishte pasur asnjë mundësi për të përfitur nga një njohje e tillë dhe rrjedhimisht mund të pretendonte se ishte viktimë e mungesës së njohjes ligjore që nga momenti pas gjykimit të Christine Goodwin, kur autoritetet kishin refuzuar të plotësonin kërkesën e tij, pra nga 5 shtatori 2002. Kjo mungesë njohjeje shkelte të drejtën e aplikantit për respektimin e jetës së tij private.

### **L. kundër Lituanisë (nr. 27527/03) (11 shtator 2007)**

Ky rast kishte të bënte me pamundësinë e një personi transeksual për t'iu nënshtruar operacionit të ndryshimit të seksit dhe ndryshimit të shenjuesit të gjinisë në dokumentet zyrtare.

Gjykata u shpreh se në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës. Megjithatë kërkuesi kishte vuajtur nga shqetësimi dhe zhgënjimi, rrethanat nuk ishin të një shkalle aq intensive, që përfshinin kushte të jashtëzakonshme apo kërcënuese për jetën, sa të përfshiheshin në fokusin e këtij neni.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Ligji lituanez njihje të drejtën e transeksualëve për të ndryshuar jo vetëm gjininë, por edhe statusin e tyre civil, megjithatë nuk ekzistonte një ligj që rregullonte operacionin e plotë të ndryshimit të seksit. Ky boshllëk legjislativ e kishte lënë aplikantin në një situatë pasigurie shqetësuese në lidhje me jetën e tij private dhe njohjen e identitetit të tij të vërtetë. Kufizimet financiare në sistemin e shëndetit publik mund të justifikonin disa vonesa fillestare në zbatimin e të drejtave të transeksualëve sipas Kodit Civil vendas, por asesi një vonesë mbi katër vjeçare. Duke pasur parasysh numrin e kufizuar të personave të përfshirë,

barra buxhetore nuk do të kishte qenë aq e rëndë, prandaj shteti kishte dështuar në arritjen e një ekuilibri të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave individuale të kërkuarit.

### **Schlumpf kundër Zvicrës (8 janar 2009)**

Ky rast lidhet me refuzimin e kompanisë siguroese ndaj kërkuarës për të paguar kostot e operacionit të saj të ndryshimit të seksit me arsyetimin se ajo nuk kishte respektuar periudhën dy vjeçare të pritjes përpara operacionit, si kusht për pagesën e kostove të operacioneve të ngjashme.

Gjykata u shpreh se në këtë rast kishte shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Periudha e pritjes 2-vjeçare u konsiderua nga Gjykata si zbatim tejet mekanik që nuk merrte parasysh moshën 67 vjeçare të aplikantes, vendimi i së cilës për t'iu nënshtruar një operacioni të tillë kishte të ngjarë të ndikohej nga kjo vonesë, në dëm të lirisë së saj për të vendosur vetë në lidhje me identitetin gjinor.

### **P.V. kundër Spanjës (nr. 35159/09) (30 nëntor 2010)**

Ky rast ka të bëjë me një grua transeksuale, e cila përpara ndryshimit të seksit, ishte bërë prind i një djalit të lindur nga bashkëshortja në vitin 1998. Martesa përfundoi në vitin 2002 dhe kërkuarja u ankua për kufizimet që i ishin vendosur nga gjykata kombëtare në marrëveshjet e kontaktit me djalin me arsyetimin se paqëndrueshmëria e saj emocionale pas ndryshimit të seksit sillte riskun e shqetësimit të fëmijës, në atë kohë 6 vjeç.

Gjykata u shpreh se në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. U ravijëzua se kufizimi i kontaktit nuk kishte ardhur nga diskriminimi për shkak të identitetit gjinor të aplikantes, pasi baza vendimtare për kufizimin e vendosur nga gjykatat spanjolle, duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e përkohshme emocionale të kërkuarës, kishte qenë mirëqenia e fëmijës. Si pasojë ishte vendosur një marrëveshje graduale, e cila do ta lejonte fëmijën të mësohej gradualisht me ndryshimin e gjinisë së babait të tij.

### **P. kundër Portugalisë (nr. 56027/09) (6 shtator 2011) (vendim i hequr)**

Me arritjen e moshës madhore, aplikantja, e lindur biologjikisht mashkull, iu nënshtrua një trajtimi të ndryshimit të gjinisë, që u pasndoq nga operacioni. Ajo u ankua për mungesën e njohjes ligjore të situatës së saj, së bashku me mungesën e pretenduar të bazës ligjore për këtë çështje.

Gjykata e hoqi kërkesën nga lista e çështjeve të saj (sipas nenit 37 të Konventës). Çështja ishte zgjidhur duke qenë se kërkesa për njohje ligjore në gjykatat vendase kishte rezultuar e suksesshme në vijim.

### **Cassar kundër Maltës (9 korrik 2013) (vendim i hequr)**

Kërkuesja u ankua për faktin se ligji maltez nuk i njihte transeksualët si persona të seksit të ri të fituar në asnjë raport juridik, duke përfshirë lidhjen e martesës. Ajo u ankua se nuk iu dha një mjet juridik efektiv (neni 13 i Konventës) në lidhje me shkeljen e të drejtave të saj dhe për rrjedhojë se pretendoi shkeljen e nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 12 (e drejta për t'u martuar) të Konventës.

Gjykata, duke vënë në dukje se ishte arritur një marrëveshje jashtëgjyqësore ndërmjet Qeverisë dhe kërkueses, e hoqi kërkesën nga lista e çështjeve (sipas nenit 37 të Konventës).

### **Hämäläinen kundër Finlandës (16 korrik 2014) (Dhoma e Madhe)**

Aplikantja e lindur me seksin mashkull u martua me një grua në vitin 1996. Çifti pati një fëmijë në vitin 2002. Në shtator 2009, ajo iu nënshtrua një operacioni për ndryshimin e seksit nga mashkull në femër. Edhe pse e ndryshoi emrin e saj në qershor 2006, aplikantja nuk mundi të ndryshonte numrin identifikues që do të përfaqësonte gjininë e saj femërore në dokumentet zyrtare. Ky ndryshim do të ishte i mundur vetëm nëse bashkëshortja e saj pranonte që martesa të shndërrohej në një partneritet civil (gjë që çifti e refuzoi) ose nëse çifti divorcohej. Kërkesa e saj për t'u regjistruar si femër në zyrën lokale të gjendjes civile u refuzua. Kërkuesja u ankua mbi bazën se njohjen e plotë ligjore e gjinisë së saj të re ishte e mundur vetëm duke e kthyer martesën aktuale në një partneritet civil.

Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës dhe se kërkesa për konvertimin e martesës në partneritet civil nuk ishte jo proporcionale si parakusht për njohjen ligjore të një gjinie të fituar, pasi ky opsion i kishte të gjitha mundësitë reale dhe efektive për të ofruar mbrojtje ligjore për çiftet e të njëjtit seks në mënyrë pothuajse identike martesën. Ndryshimet e vogla midis këtyre dy koncepteve ligjore nuk ishin të asaj natyre dhe intensiteti sa ta bënë sistemin aktual finlandez të mangët nga pikëpamja e detyrimit pozitiv të shtetit, sipas nenit 8 të Konventës. Për më tepër, një konvertim i tillë nuk sillte ndonjë implikim për jetën familjare të aplikantes, pasi nuk do të ndikonte në atësinë e vajzës së saj ose përgjegjësinë për kujdesin, kujdestarinë ose mirëqenien e fëmijës. Gjykata vlerësoi më tej, se nuk u ngrit asnjë çështje e veçantë sipas nenit 12 (e drejta për t'u martuar) të Konventës dhe konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) lidhur me nenet 8 dhe 12 të Konventës.

### **Y.Y. kundër Turqisë (nr.14793/08) (10 mars 2015)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin nga autoritetet turke për të dhënë autorizim për operacionin e ndryshimit të gjinisë me arsyetimin, se personi transeksual që kërkonte autorizimin nuk kishte humbur në mënyrë të përhershme aftësinë për të lindur fëmijë. Kërkuesi, i cili ishte regjistruar në kohën e aplikimit me seksin femër u ankua në veçanti për shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës private. Aplikanti kishte parashtruar se mospërputhja midis perceptimit të tij për veten si burrë dhe gjendjes së tij fizike ishte vërtetuar nga raportet mjekësore dhe u ankua



për refuzimin nga autoritetet vendase për t'i dhënë fund kësaj mospërputhjeje me arsyetimin se ai ishte në gjendje të sillte në jetë fëmijë. Përfundimisht, në maj 2013, gjykatat turke miratuan kërkesën dhe autorizuan operacionin.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se, duke i mohuar kërkuarit për shumë vite mundësinë për t'iu nënshtruar një operacioni të tillë, shteti turk kishte shkelur të drejtën e tij për respektimin e jetës private. Gjykata përsëriti se krijimi i mundësisë që transeksualët të gëzojnë plotësisht të drejtën e zhvillimit personal dhe integritetit fizik e moral nuk mund të konsiderohet si një çështje e diskutueshme. Edhe nëse supozojmë se mohimi i kërkesës fillestare të kërkuarit për akses në një operacion ishte bazuar në pika relevante, në asnjë rast ato nuk janë të mjaftueshme për të mohuar aksesin e dikujt në operacione të këtij lloji. Ndërhyrja (refuzimi i dhënies së autorizimit për operacionin) e kryer kundrejt të drejtës së kërkuarit për respektimin e jetës private nuk mund të konsiderohet “e nevojshme” në një shoqëri demokratike.

#### **D.Ç. kundër Turqisë (nr. 10684/13) (7 shkurt 2017) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Kërkuarja ishte një grua transeksuale, ndryshimi i gjinisë të së cilës nuk ishte kryer ende. Ajo u ankua për refuzimin e autoriteteve të Ministrisë së Drejtësisë për të përballuar koston e ndryshimit të gjinisë së saj, pavarësisht provave mjekësore, të cilat sipas saj tregonin qartë, se ajo kishte nevojë urgjente për trajtim.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme, si pasojë e mosshterimit të mjeteve juridike të brendshme, në përputhje me nenin 35/1 dhe 4 (kriteret e pranueshmërisë) të Konventës.

#### **A.P (nr. 79885/12), Garçon dhe Nicot kundër Francës (6 prill 2017)**

Ky rast kishte të bënte me tri persona transgjimorë të kombësisë franceze, të cilët dëshironin të ndryshonin shenjuesit e gjinisë dhe emrat e tyre në certifikatat e lindjes. Aplikantët nuk ishin lejuar nga gjykatat franceze për ta kryer këtë ndryshim. Kërkuarit parashtruan ndër të tjera, se autoritetet kishin shkelur të drejtën e tyre për respektimin e jetës private, duke e kushtëzuar njohjen e identitetit gjimor me kryerjen e operacionit të ndryshimit të seksit, i cili përfshinte një probabilitet të lartë steriliteti.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës në lidhje me kërkuarin e dytë dhe të tretë, për shkak të detyrimit për të vërtetuar natyrën e pakthyeshme të ndryshimit në pamjen e tyre. Më tej, ajo u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me aplikantin e parë, për shkak të detyrimit për t'iu nënshtruar një kontrolli mjekësor. Gjykata vendosi në veçanti, se kushtëzimi i njohjes së identitetit seksual të personave transgjimorë me kryerjen e një operacioni ose trajtimi sterilizues, të cilit ata nuk dëshironin t'iu nënshtroheshin, vendoste si kusht për ushtrimin e plotë të së drejtës për respektimin e jetës private të dikujt heqjen dorë nga ushtrimi i plotë i së drejtës për respektimin e integritetit fizik.

### **S.V. kundër Italisë (nr. 55216/08) (11 tetor 2018)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve italiane ndaj kërkesës së një gruaje transgjimore me pamje femërore për të ndryshuar emrin e saj të mëparshëm në dokumentet zyrtare, me arsyetimin se ajo nuk i ishte nënshtruar ende një operacioni të ndryshimit të seksit dhe se nuk ishte dhënë asnjë vendim gjyqësor përfundimtar që konfirmonte ndryshimin e gjinisë. Në maj 2001, Gjykata e Rrethit të Romës autorizoi ankuesen t'i nënshtrohej një operacioni për ndryshim seksi, megjithatë sipas legjislacionit në fuqi në atë kohë, ankuesja nuk ishte në gjendje të ndryshonte emrin e saj, derisa gjykata konfirmoi se operacioni ishte kryer dhe dha një vendim përfundimtar mbi identitetin e saj gjinor, në tetor 2003.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës. U konstatua në veçanti, se pamundësia e kërkueses për ndryshim të emrit përgjatë një periudhe afro dy vjeçare me arsyetimin se procesi i tranzicionit gjinor nuk ishte përfunduar me anë të operacionit të ndryshimit të seksit, përbënte një dështim të shtetit në përmbushje të detyrimit pozitiv për të siguruar të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private.

Sipas mendimit të Gjykatës, natyra e ngurtë e procedurës gjyqësore për njohjen e identitetit gjinor të personave transgjimorë, siç ishte në fuqi në atë kohë, e kishte lënë kërkuesen, pamja fizike dhe identiteti social i së cilës kishte qenë prej kohësh femër, për një periudhë të paarsyeshme kohore, në një pozicion dhe gjendje pasigurie, që mund të shkaktojë ndjesi cënueshmërie, poshtërimi dhe ankthi.

Gjykata vuri në dukje më tej se legjislacioni Italian ishte ndryshuar në vitin 2011, duke eliminuar nevojën e një vendimi të dytë të gjykatës kombëtare për të konfirmuar ndryshimin e gjinisë së personave që i ishin nënshtruar operacionit. Nga ky moment, ndryshimi i të dhënave të gjendjes civile të personave transgjimorë mund të urdhërohet nga gjyqtari kombëtar në vendimin që autorizon operacionin.

### **Y.T. kundër Bullgarisë (nr. 41701/16) (9 korrik 2020)**

Ky rast kishte të bënte me një burrë transeksual, i cili kishte ndërmarrë hapa për të ndryshuar pamjen e tij fizike. Kërkesa e aplikantit për ndryshim gjinie (nga grua në burrë) ishte refuzuar nga gjykatat bullgare. Kërkuesi pretendoi se ishte ndërgjegjësuar mbi identitetin e tij gjinor mashkullor gjatë adoleshencës dhe se kishte jetuar në shoqëri si burrë. Ai u ankua për refuzimin nga gjykatat bullgare për të ndryshuar shenjuesin e gjininë dhe emrin e tij në regjistrat e gjendjes civile.

Gjykata vendosi se në këtë rast kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës, duke konstatuar se refuzimi i autoriteteve bullgare për t'i dhënë njohje ligjore kërkuetit, pa dhënë arsye specifike dhe të mjaftueshme, përbënte një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e kërkuetit për respektimin e jetës së tij private. Gjykata vuri në dukje në veçanti, se autoritetet gjyqësore kishin vërtetuar se kërkuesi kishte filluar një proces tranzicioni gjinor, duke ndryshuar pamjen e tij fizike dhe se identiteti i tij social dhe familjar kishte qenë tashmë ai i një mashkulli për një kohë të gjatë. Megjithatë, gjykatat vendase kishin konsideruar se interesi publik kërkonte që ndryshimi ligjor i seksit të mos lejohej, pa specifikuar natyrën e saktë të këtij interesi publik dhe nuk e kishin balancuar këtë interes me të drejtën

individuale të kërkuarit për njohjen ligjore të identitetit të tij gjinor. Gjykata e identifikoi këtë si ngurtësi në arsyetimin e gjykatave vendase, të cilat e kishin vendosur kërkuarin për një periudhë të paarsyeshme dhe të vazhdueshme, në një pozitë shqetësuese dhe të pasigurt, për shkak të së cilës ai mund të përjetonte ndjenja vulnerabiliteti, poshtërimi dhe ankthi.

### **Rana kundër Hungarisë (16 korrik 2020) (Vendimi i Komisionit)**

Aplikanti ishte një burrë transgjinnor nga Irani që kishte përfituar azil në Hungari. Ai u ankua për refuzimin e autoriteteve hungareze për të ndryshuar emrin e tij dhe shenjuesin e seksit nga "femër" në "mashkull" në dokumentet e identifikimit të personit.

Gjykata vendosi, se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës, duke konstatuar se nuk ishte vendosur një ekuilibër i drejtë midis interesit publik dhe të drejtës së ankuesit për respektimin e jetës së tij private, për shkak të refuzimi për t'i dhënë aplikantit akses në procedurën ligjore të njohjes së gjinisë. U vu në dukje në veçanti, se sistemi i brendshëm për njohjen e gjinisë e kishte përjashtuar aplikantin thjesht sepse ai nuk kishte një certifikatë lindjeje nga Hungaria, duke qenë se mënyra e njohjes ligjore të ndryshimit të emrit dhe gjinisë lidhej me ndryshimet në regjistrin e lindjeve.

### **X. dhe Y. kundër Rumanisë (nr. 2145/16 dhe 20607/16) (19 janar 2021)**

Ky rast kishte të bënte me situatën e dy personave transgjinnorë, kërkesat e të cilëve për njohjen e identitetit të tyre gjinor dhe për kryerjen e korrigjimeve përkatëse administrative u refuzuan me arsyetimin, se personat që bënin kërkesa të tilla duhet të siguronin prova se ata i ishin nënshtruar një operacioni për ndryshimin e seksit.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës, duke konstatuar se refuzimi i autoriteteve vendase për të njohur ligjërisht ndryshimin e gjinisë së kërkuarve në mungesë të operacionit, ishte një ndërhyrje e pajustificuar në të drejtën e tyre për respektimin e jetës private.

Gjykata vuri në dukje në veçanti, se gjykatat kombëtare i kishin paraqitur kërkuarve, të cilët nuk dëshironin t'i nënshtroheshin një operacioni të ndryshimit të seksit, një dilemë të pamundur: ose duhet t'i nënshtroheshin operacionit dhe të hiqnin dorë nga ushtrimi i plotë i së drejtës së tyre për respektim të integritetit fizik, ose duhej të hiqnin dorë nga njohja e identitetit të tyre gjinor, i cili gjithashtu përfshihet në sferën e respektit për jetën private. Sipas mendimit të Gjykatës, ky trajtim prish ekuilibrin e drejtë që duhet të arrihet nga shtetet në konsideratën midis interesit të përgjithshëm dhe interesave individuale të personave në fjalë.

### **A.M. dhe të tjerët kundër Rosisë (nr. 47220/19) (6 korrik 2021)**

Kjo çështje kishte të bënte me një vendim gjykatë për të kufizuar të drejtat prindërore të kërkuarës, një grua transgjinnore që i ishte nënshtruar operacionit të ndryshimit të seksit dhe që

e privonte atë nga kontakti me fëmijët e saj për shkak të tranzicionit gjinor dhe efektit të pretenduar negativ që mund të kishte në shëndetin psikologjik të fëmijëve të saj ky ndryshim.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se gjykatat ruse nuk kishin bërë një vlerësim të balancuar dhe të arsyeshëm të çështjes dhe se kufizimi i të drejtave prindërore të kërkueses në lidhje me kontaktin me fëmijët e saj nuk ishin “të nevojshme në një shoqëri demokratike”. Gjykata vuri në dukje në veçanti, se gjykatat vendase nuk kishin marrë parasysh situatën specifike familjare të kërkueses në arsyetimin e tyre. U theksua për më tepër, se një vendim që privon plotësisht një prind nga kontakti me fëmijët e tij duhet të merret vetëm në situatat më ekstreme. Ky nuk ishte rasti në çështjen në fjalë duke pasur parasysh mungesën e dëmtimit të dukshëm ndaj fëmijëve të kërkueses. Gjykata gjithashtu u shpreh, se kishte pasur një shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës lidhur me nenin 8 në lidhje me kërkuesen, duke konstatuar se vendimi për të kufizuar kontaktin me fëmijët e saj ishte diskriminim, pasi identiteti gjinor i aplikantes kishte luajtur një rol të rëndësishëm dhe kishte qenë faktori vendimtar në vendimet e gjykatave vendase.

### **Y kundër Polonisë (nr. 74131/14) (17 shkurt 20221)**

Ky rast kishte të bënte me aplikimet e një burri transgjinor për të hequr nga certifikata e lindjes referencat mbi seksin femër të caktuar në lindje ose për të lëshuar një certifikatë të përditësuar lindjeje. Kërkuesi u ankua gjithashtu, se ai ishte diskriminuar në raport me fëmijët e birësuar, të cilëve u jepeshin certifikata të reja lindjeje.

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se autoritetet polake kishin vepruar brenda hapësirës së tyre të vlerësimit (“margjina e vlerësimit”), duke arritur një ekuilibër midis interesave përkatëse në rastin aktual. Gjykata vuri në dukje, në veçanti, se ekstrakti i certifikatës së lindjes dhe dokumentet e identifikimit të aplikantit tregonin vetëm gjininë e tij të ricaktuar dhe se certifikata e lindjes me formë të gjatë nuk ishte e aksesueshme për publikun. Për më tepër, kërkuesi nuk kishte demonstruar ndonjë pasojë negative si rezultat i refuzimeve nga autoritetet polake.

Gjykata gjithashtu u shpreh, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, duke konstatuar se situata e aplikantit dhe ajo e fëmijëve të birësuar nuk ishin mjaftueshëm të ngjashme për të argumentuar se ai kishte pësuar diskriminim.

### **Çështje në lidhje me orientimin seksual**

### **E drejta e jetës/Ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues (neni 2 dhe neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut)**

## **Ankesat lidhur me keqtrajtimin nga Policia ose nga individë private**

### **Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë (12maj 2015)**

Ky rast kishte të bënte me një demonstratë paqësore të organizuar nga një organizatë joqeveritare (OJQ) në Tbilisi, në maj 2012 për të shënuar Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, e cila u ndërpre me dhunë nga kundër-demonstruesit, të cilët ishin më të shumtë në numër krahasuar me marshuesit. 13 kërkuesit që kishin marrë pjesë në marshim u ankuan veçanërisht se autoritetet gjeorgjiane nuk kishin arritur t'i mbronin ata nga sulmet e dhunshme të kundër-demonstruesve dhe nuk kishin kryer një hetim efektiv lidhur me incidentin, duke përcaktuar në veçanti, motivin diskriminues që qëndronte pas këtyre sulmeve.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Së pari, duke marrë parasysh të dhënat e ndryshme zyrtare të sjella kryesisht nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës mbi situatën e individëve lezbike, homoseksualë, biseksualë dhe transgjidorë në Gjeorgji, Gjykata vërejti se qëndrimet negative kundër anëtarëve të komunitetit LGBT ishin të përhapura gjerësisht në disa segmente të shoqërisë gjeorgjiane. Në këtë linjë, motivi diskriminues i sulmeve kundrejt 13 pjesëmarrësve të marshimit në maj 2012 ishte veçanërisht i qartë.

Më tej, Gjykata konstatoi se kundër-demonstruesit që ishin më të shumtë në numër, kërcënuan seriozisht dhe përdorën dhunë fizike ndaj 13 kërkuesve, të cilët duhet të kenë qenë të frikësuar, duhet të kenë përjetuar ankth e pasiguri, çka nuk ishte në përputhje me respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor. Për më tepër, autoritetet vendase, të cilat kishin ode duhet të kishin pasur dijeni mbi rreziqet që rrethonin demonstratën, kishin si rrjedhim detyrimin për të ofruar mbrojtjen e duhur. Së fundmi, duke vendosur në dukje se ligji penal gjeorgjian parashikonte që diskriminimi mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor duhet të trajtohej si një rrethanë rënduese në kryerjen e një veprë penale, Gjykata konstatoi se kishte qenë thelbësore që autoritetet të kryenin hetimin të plotë dhe efektiv në atë kontekst specifik, gjë që nuk kishin arritur ta bënin. Rrjedhimisht, autoritetet vendase kishin dështuar në kryerjen e hetimit të duhur lidhur me pretendimet e 13 kërkuesve për keqtrajtim, prandaj u gjetën në shkelje.

### **M.C. dhe C.A. kundër Rumanisë (aplikimi nr. 12060/12) (12 prill 2016)**

Në qershor 2006, aplikantët morën pjesë në marshin vjetor të komunitetit LGBT në Bukuresht. Gjatë rrugës për në shtëpi, kur ishin në metro, ata u sulmuan nga një grup që përbëhej nga gjashtë të rinj dhe një grua e rritur. Sulmuesit i goditën aplikantët me grushte dhe shkelma dhe u bërtitën duke përdorur gjuhë homofobike. Kërkuesit u ankuan se hetimi për sulmin ndaj tyre kishte qenë i pamjaftueshëm. Ata pretenduan në veçanti, se autoritetet nuk kishin marrë parasysh faktin se veprat kundër tyre kishin qenë të motivuara nga urrejtja kundër komunitetit LGBT.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, duke konstatuar se hetimet mbi pretendimet e kërkuësve për keqtrajtim kishin qenë joefektive, pasi kishin zgjatur shumë, shfaqnin mangësi serioze dhe nuk merrnin parasysh motivet e mundshme diskriminuese.

### **Aghdgomelashvili dhe Japaridze kundër Gjeorgjisë (8 tetor 2020)**

Ky rast kishte të bënte me një mësymje të policisë në zyrën e një organizate LGBT në Tbilisi. Aplikantët, të cilët punonin në organizatë, u ankuan se policia i kishte fyer dhe kërcënuar, duke i detyruar forcërisht t'u nënshtroheshin kontrolleve poshtëruese. Ata parashtruan se i ishin nënshtuar abuzimit fizik dhe mendor me ngjyrimet e qarta homofobike dhe/ose transfobike, të cilat për më tepër ishin anashkaluar gjatë hetimit joefektiv që pasoi ngjarjen.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit), duke konstatuar se Shteti kishte qenë përgjegjës për abuzimin policor homofobik/transfobik që u ishte shkaktuar kërkuësve dhe për mungesën e një hetimi efektiv ndaj sjelljes së papërshtatshme të oficerëve. Shqetësues për Gjykatën ishte fakti që as policia dhe as qeveria gjeorgjiane nuk kishin dhënë arsye për kontrollet që përfshinin zhveshje të kërkuësve, duke konkluduar se qëllimi i tyre i vetëm kishte qenë të vendoste në siklet dhe të ndëshkonte kërkuësit për lidhjet e tyre me komunitetin LGBT.

### **Sabalić kundër Kroacisë (14 janar 2021)**

Kërkuësja, e cila ishte sulmuar në një lokal nga një burrë, të cilit i kishte treguar për orientimin e saj homoseksual, u ankua veçanërisht për mungesën e një reagimi të duhur procedural të autoriteteve vendase ndaj aktit të dhunës që vinte nga një palë private, motivuar nga orientimi i saj seksual.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. U konstatua në veçanti, se procedurat për kundërvajtje penale ndaj agresorit nuk kishin trajtuar elementin e kriminit të urrejtjes si vepër penale dhe kishin rezultuar në vendosjen e një gjobe qesharake. Këto mangësi sillnin një defekt thelbësor në procedurë. Gjykata rekomandoi që autoritetet vendase të përfundonin ose anulonin procedurat për kundërvajtje dhe të rishqyrtonin çështjen.

### **Grupi Mbështetës i iniciativave të grave dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë (16 dhjetor 2021)<sup>76</sup>**

Aplikantët në këtë rast ishin 35 shtetas gjeorgjianë dhe dy organizata joqeveritare të krijuara për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e personave LGBT në Gjeorgji. Rasti kishte të bënte me një sulm ndaj demonstruesve LGBT më 17 maj 2013, në qendër të Tbilisit.

---

<sup>76</sup> Ky vendim do të formën e prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44/2 (gjykimet përfundimtare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës për shkak të dështimit të autoriteteve për të mbrojtur demonstruesit paqësorë nga homofobia dhe agresioni transfobik gjatë ditës së marshimit dhe për shkak të mungesës së një hetimi të përshtatshëm nga autoritetet vendase. Gjykata vendosi në dukje, se autoritetet vendase nuk kishin marrë masa për të mbrojtur demonstruesit LGBT nga turma e agresorëve, pavarësisht se ishin të vetëdijshme për rreziqet që lidheshin me marshimin.

Gjykata nuk mund të përjashtonte mundësinë që shkalla e paprecedentë e dhunës të ishte ndikuar nga dështimi i autoriteteve vendase për të kryer një hetim në kohë dhe objektiv lidhur me sulmet ndaj komunitetit LGBT. Gjykata gjithashtu u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 11 (liria e organizimit) të Konventës në lidhje me nenin 14 në këtë çështje, duke konstatuar se autoritetet nuk e kishin vënë kurrë si prioritet marrjen e masave efektive për të mbrojtur aplikantët. Autoritetet vendase nuk kishin vlerësuar burimet e nevojshme në fazën e planifikimit të ngjarjes dhe e kishin kufizuar rolin e tyre në hartimin e një plani shpërndarjeje.

## **Kushtet e mbajtjes në burgim**

### **Stasi kundër Francës (20 tetor 2011)**

Ankuesi u ankua se kishte qenë viktimë e keqtrajtimit nga të burgosur të tjerë gjatë burgimit, veçanërisht për shkak të homoseksualitetit të tij dhe pretendoi se autoritetet vendase nuk kishin marrë masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e tij gjatë vuajtjes së dënimit në institucion.

Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës. Ajo konstatoi se nisur nga rrethanat e çështjes dhe duke marrë parasysh faktet që u parashtruan, autoritetet kishin marrë të gjitha masat që mund të prej tyre në mënyrë të arsyeshme, për të mbrojtur kërkuesin nga dëmtimi fizik.

### **X. kundër Turqisë (nr. 24626/09) (9 tetor 2012)**

Ky rast kishte të bënte me një të burgosur homoseksual, i cili pasi u ankua për akte që e frikësonin dhe bullizim nga të burgosurit e tjerë, u vendos në izolim për mbi 8 muaj.

Gjykata vlerësoi se këto kushte burgimi i kishin shkaktuar kërkuesit vuajtje mendore dhe fizike, së bashku me ndjenjën se ai kishte humbur dinjitetin, duke u konsideruar "trajtim çnjerëzor dhe degradues" në shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës. Gjykata më tej konstatoi se kishte shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, pasi arsyeja kryesore për izolimin e kërkuesit nuk ishte mbrojtja e kërkuesit, por orientimi i tij seksual.

## **Rreziku që lind nga kthimi në vendin e origjinës**

### **I.I.N. kundër Holandës (nr. 2035/04) (9 dhjetor 2004) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Ky rast kishte të bënte me rrezikun e supozuar me të cilin mund të përballej aplikanti, një burrë homoseksual, në rast se do të kthehej në vendin e tij të origjinës që ishte Irani, nga autoritetet holandeze në kundërshtim me detyrimet pozitive të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme dhe të pabazuar, pasi konstatoi se kërkuesi nuk kishte vërtetuar se kishte arsye thelbësore për të besuar se nëse ai do të kthehej në vendin e origjinës, do të ekspozohej ndaj një rreziku real, për shkak të homoseksualitetit të tij.

### **A.S.B. kundër Holandës (nr. 4854/12) (10 korrik 2012) (vendim i hequr)**

Aplikanti u ankua se nëse dëbohej në Xhamajka nga autoritetet holandeze, ai do të përballej me një rrezik real dhe specifik për shkak të homoseksualitetit të tij, çka përbënte trajtim në kundërshtim me detyrimet pozitive të vendosur nga neni 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) i Konventës.

Gjykata vendosi të hiqte kërkesën nga lista e çështjeve, duke sjellë në vëmendje se kërkuesit i ishte dhënë azil në Holandë dhe për rrjedhojë nuk kishte më asnjë rrezik lidhur me dëbimin e tij në Xhamajka.

### **M.K.N. kundër Suedisë (nr. 72413/10) (27 qershor 2013)**

Kërkuesi u ankua se nuk duhet të kthehej në Mosuli (Irak) sepse po persekutohej për shkak të besimeve të tij të krishtera. Ai më tej pretendoi se nëse kthehej në Irak do të rrezikohej edhe nga persekutimi për shkak të marrëdhënies së tij homoseksuale, pasi Muxhahedinët kishin vrarë partnerin e tij.

Gjykata u shpreh se zbatimi i urdhërit të dëbimit kundër kërkuesit nuk do të shkaktonte shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës nga shteti suedez. Gjykata arsyetoi se nëse kthehej në Irak, aplikanti nuk do të ishte në rrezik real, pasi situata e përgjithshme në vend po përmirësohej ngadalë. Megjithëse kishte prova që tregonin se përkatësia e aplikantit në një pakicë të cenueshme do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku real të trajtimit çnjerëzor ose degradues nëse dëbohej, Gjykata vendosi se kërkuesi mund të vendosej në rajone të tjera të Irakut, siç ishte Kurdistanin në veri. Së fundmi, Gjykata vlerësoi se pretendimi i kërkuesit në lidhje me marrëdhënien e tij homoseksuale nuk ishte i besueshëm.

### **M.E kundër Suedisë (nr. 71398/12) (8 Prill 2015) (Dhoma e Madhe)**



Aplikuesi, një azil-kërkues, parashtrroi veçanërisht se nëse do të detyrohej nga autoritetet suedeze të kthehej në Libi, do të ishte në rrezik real të persekutimit dhe keqtrajtimit, kryesisht për shkak të homoseksualitetit të tij, por edhe për shkak të problemeve të mëparshme me autoritetet ushtarake libiane pas arrestimit të tij për kontrabandë ilegale armësh.

Gjykata vuri në dukje se kërkuesit i ishte dhënë një leje qëndrimi nga Bordi i Migracionit Suedez më 17 dhjetor 2014, i cili shfuqizonte urdhrin e dëbimit kundër tij. Bordi konstatoi se situata e sigurisë në Libi ishte përkeqësuar që nga vera e vitit 2014 dhe se aplikanti nëse dëbohej në vendin e tij do të rrezikohet nga persekutimi, pasi ai jetonte hapur si homoseksual, prandaj kishte nevojë për mbrojtje në Suedi.

Megjithëse nuk u arrit në marrëveshje miqësore ndërmjet palëve, Gjykata konsideroi se shkelja e mundshme e nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës ishte shmangur dhe se çështja ishte zgjidhur në nivel kombëtar, prandaj Gjykata e hoqi kërkesën nga lista e çështjeve.

#### **A.E kundër Finlandës (nr. 30953/11) (22 shtator 2015)**

Ky rast lidhet me rrezikun e supozuar të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 (ndalimi i tortures, trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës, me të cilin do të përballej A. E, një burrë homoseksual, në rast të kthimit të tij në Iran nga autoritetet finlandeze.

Gjykata e hoqi kërkesën nga lista e çështjeve të saj, duke vendosur në dukje se kërkuesit i ishte ofruar një leje qëndrimi e vazhdueshme në Finlandë, e cila ishte e vlefshme për një periudhë një-vjeçare, me mundësi rinovimi dhe se si rrjedhim ai nuk rrezikonte nga një dëbim i urdhëruar.

#### **A.N. kundër Francës (nr. 12956/15) (19 prill 2016) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Ky rast kishte të bënte me rrezikun e supozuar të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 (ndalimi i tortures, trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës, me të cilin mund të përballej aplikanti, një burrë homoseksual, në rast të kthimit të tij në Senegal nga autoritetet franceze.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme dhe haptazi të pabazuar në fakte të provueshme. U konstatua se kërkuesi nuk kishte vërtetuar se ai rrezikonte të përballej me një rrezik real për shkak të homoseksualitetit të tij në rast se do të kthehej në Senegal.

#### **I.K. kundër Zvicrës (nr. 21417/17) (19 dhjetor 2017) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Kërkuesi, një Sierra Leonean, pretendonte se ishte homoseksual dhe deklaronte veçanërisht, se kishte frikë se do t'i nënshtrohej një trajtimi çnjerëzor dhe degradues nëse do të kthehej në Sierra Leone nga autoritetet zvicerane.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme, si haptazi të pabazuar. Gjykata vuri në dukje se orientimi seksual ishte një aspekt themelor i identitetit të një individi dhe për pasojë individëve që parashtronin një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare bazuar në orientimin e tyre seksual nuk mund t'u kërkohej ta fshihnin këtë aspekt të vetes.

Megjithatë, në rastin konkret, duke vënë në dukje mungesën e besueshmërisë në pretendimet e ankuesit, Gjykata vlerësoi se nuk kishte arsye thelbësore për të besuar se ai do të ekspozohej ndaj një rreziku real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës, në rast të kthimit të tij në Sierra Leone.

### **B dhe C kundër Zvicrës (nr. 889/19 dhe 43987/16) (17 nëntor 2020)**

Aplikantët, përkatësisht një shtetas gambian dhe një shtetas zviceran, jetuan në Zvicër së bashku deri në vdekjen e aplikantit të dytë, në fund të vitit 2019. Aplikanti i parë kishte qëndruar në Zvicër që nga viti 2008. Kërkesa e tij për azil u refuzua, pasi autoritetet zvicerane i konsideruan deklaratat e tij mbi keqtrajtimet e mëparshme si jo të besueshme. Ai rrezikonte të kthehej në Gambia pas refuzimit të kërkesës së partnerit të tij për bashkim familjar dhe deklaroi se rrezikohej nga keqtrajtimi nëse kthehej.

Gjykata vendosi se do të kishte shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës, nëse aplikanti i parë do të dëbohej në Gambia në bazë të vendimeve të autoriteteve vendase mbi çështjen e tij.

Ndërsa konsideronte se kriminalizimi i akteve homoseksuale nuk ishte i mjaftueshëm për të sjellë që kthimi i mundshëm të ishte në kundërshtim me Konventën, Gjykata konstatoi, se autoritetet zvicerane kishin dështuar të vlerësonin në mënyrë adekuate rrezikun e keqtrajtimit për aplikuesin e parë si person homoseksual në Gambia dhe disponueshmërinë e mbrojtjes shtetërore kundër keqtrajtimit nga aktorët jo-shtetërorë. Gjykata, gjithashtu vuri në dukje, se disa autoritete të pavarura lokale kishin vërejtur se autoritetet e Gambias nuk ishin të gatshme të ofronin mbrojtje për personat LGBTIQ+.

### **E drejta për liri dhe siguri (neni 5 i Konventës)**

#### **O.M. kundër Hungarisë (nr. 9912/15) (5 Korrik 2016)**

Ky rast kishte të bënte me ndalimin e kërkuarit për një periudhë 58 ditore, pas kërkesës së tij për azil në Hungari, ku ai deklaroi se ishte detyruar të largohej nga Irani, vendi i tij i origjinës, për shkak të homoseksualitetit të tij. Në tetor 2014 O. M ju njoh statusi i refugjatit. Aplikanti u ankua në veçanti se ndalimi i tij kishte qenë arbitrar dhe i pajustificuar.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 5/1 (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës në periudhën mes 25 qershorit dhe 22 gushtit 2014. U konstatua në veçanti, se vendimet e autoriteteve hungareze nuk përmbanin asnjë reflektim të hollësishëm mbi rrethanat individuale

të kërkuesit, të cilat meritonin vëmendje të veçantë, pasi ai ishte anëtar i një grupi vulnerabël për shkak të përkatësisë në një pakicë seksuale në Iran.

### **Berkman kundër Ruisë (trajtuar edhe në vijim, nën seksionin "Liria e tubimit dhe organizimit (neni 11 i Konventës)") (1 Dhjetor 2020)**

Ky rast kishte të bënte me një takim publik LGBTI (lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinjorë dhe interseks) në Shën Petersburg, ku autoritetet vendase dështuan të mbronin pjesëmarrësit nga kundër-demonstruesit agresivë. Kërkuesja u ankua në veçanti se arrestimi i saj dhe ndalimi i mëvonshëm kishte qenë arbitrar dhe i paligjshëm.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5/1 (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës, sepse arrestimi i kërkueses gjatë takimit kishte qenë i paligjshëm. U konstatua veçanërisht se arrestimit në fjalë i mungonin arsyet dhe baza ligjore. Veçanërisht, sipas procesverbalit të arrestimit, kërkuesja ishte dërguar në komisariat me qëllim të përgatitjes së kallëzimit për kundërvajtje administrative. Një masë e tillë lejohej sipas ligjit të brendshëm nëse nuk ishte e mundur të plotësohej kallëzimi aty për aty. Autoritetet ruse nuk arritën të provonin, se në rastin e kërkueses hartimi i një kallëzimi të tillë në vendin e protestës kishte qenë i pamundur. Për më tepër, autoritetet vendase nuk e kishin vlerësuar në mënyrë të plotë domosdoshmërinë e transferimit të saj në komisariat.

### **E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës (neni 8 i Konventës)**

#### **Çështje të birësimit**

### **Fretté kundër Francës (26 shkurt 2002)**

Kërkuesi, një burrë homoseksual, u ankua se vendimi për rrëzimin e kërkesës së tij për autorizim të birësimit të një fëmije, përbënte ndërhyrje arbitrare në jetën e tij private dhe familjare sepse bazohej ekskluzivisht në paragjykime të pafavorshme ndaj orientimit të tij seksual. Ai më tej u ankua se nuk ishte thirrur në seancën dëgjimore për rastin e tij të mbajtur nga Conseil d'État.

Gjykata u shpreh se në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës. Ajo konstatoi se autoritetet kombëtare kishin të drejtë legjitime dhe të arsyeshme të konsideronin se e drejta e aplikantit për të qenë në gjendje të birësonte ishte e kufizuar nga interesat e fëmijëve të kualifikuar për birësim, pavarësisht nga aspiratat legjitime të kërkuesit dhe pa vendosur në pyetje zgjedhjet personale. Gjykata vendosi më tej se kishte pasur një shkelje të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt ligjor) të Konventës, pasi kërkuesit i ishte mohuar një shqyrtim i drejtë i çështjes së tij sidomos gjatë paraqitjes së prapësimeve.

### **E.B. kundër Francës (nr. 43546/02) (22 janar 2008) (Dhoma e Madhe)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin e dhënies së miratimit për qëllime birësimi, për shkak të stilit të jetesës së aplikantes, e cila ishte lesbike dhe jetonte me një grua tjetër. Kërkuësja pretendoi se në çdo fazë të aplikimit të saj për autorizim për të birësuar një fëmijë ajo kishte pësuar trajtim të diferencuar dhe diskriminues që ishte bazuar në orientimin e saj seksual dhe për pasojë ndërhynte në të drejtën e saj për respektimin e jetës private.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Gjykata vërejti në veçanti, se homoseksualiteti i kërkuëses kishte qenë një faktor përcaktues në refuzimin e kërkesës së saj, ndërkohë që ligji francez i lejonte personat beqarë të birësonin fëmijë, duke hapur kështu mundësinë e birësimit nga një prind homoseksual i vetëm.

### **Gas dhe Dubois kundër Francës (15 mars 2012)**

Aplikantet ishin dy gra që bashkëjetonin së bashku. Çështja kishte të bënte me refuzimin e kërkesës së aplikantes së parë për të birësuar fëmijën e aplikantes së dytë dhe kërkuëset pretendonin cenimin e së drejtës së tyre për jetë private dhe familjare, në mënyrë diskriminuese nga autoritetet franceze.

Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Gjykata konsideroi në veçanti, se situata ligjore e aplikanteve nuk ishte e krahasueshme me atë të çifteve të martuara sa i përket birësimit nga prindi i dytë. Gjykata vlerësoi se nuk kishte asnjë provë mbi ndryshimin në trajtimin e rastit të aplikanteve bazuar në orientimin e tyre seksual, pasi edhe çifteve të seksit të kundërt që kishin hyrë në një partneritet civil (jo martesë) u ndalohej të birësonin fëmijën e partnerit të tyre.

Në përgjigje të parashtrimit të kërkuëseve se ky ndalim mund të shmangej mes martesës nga çiftet e seksit të kundërt, ndërkohë që çiftet e të njëjtit seks nuk u njihej kjo e drejtë, Gjykata përsëriti gjetjet e saj në lidhje me aksesin në martesë për çiftet e të njëjtit seks (gjykimi Schalk dhe Kopf kundër Austrisë).

### **X dhe të tjerët kundër Austrisë (nr. 19010/07) (19 shkurt 2013) (Dhoma e Madhe)**

Ky rast kishte të bënte me ankesën e dy grave që jetojnë në një marrëdhënie të qëndrueshme homoseksuale lidhur me refuzimin e gjykatave austriake për t'i dhënë njërës prej partnereve të drejtën për të adoptuar djalin e partneres tjetër, pa shpëtur lidhjet ligjore të nënës me fëmijën (adoptim nga prindi i dytë). Kërkuëset parashtruan se nuk kishte asnjë kufizim për lejimin e birësimit të fëmijës së një partneri nga partneri tjetër për çiftet heteroseksuale të martuara ose jo, ndërkohë që ndalohej në çdo rast birësimi i fëmijës së njërit partner nga partneri tjetër për çiftet homoseksuale.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, për shkak të diferencimit në trajtimin e kërkueseve në krahasim me çiftet e sekseve të ndryshme, në lidhje me birësimin e fëmijës së njërit partner nga partneri tjetër. Më tej, Gjykata u shpreh se nuk ishte paraqitur asnjë arsye bindëse për të treguar se një ndryshim i tillë në trajtim ishte i nevojshëm për mbrojtjen e familjes ose për mbrojtjen e interesave të fëmijës.

Në të njëjtën kohë, Gjykata nënvizoi se Konventa nuk i detyronte shtetet të shtrinin të drejtën e birësimit nga prindi i dytë për çiftet e pamartuara. Për më tepër, çështja duhej të dallohej nga çështja Gas dhe Dubois kundër Francës, në të cilën Gjykata kishte konstatuar se nuk kishte dallime në trajtim të bazuar në orientimin seksual midis një çifti të pamartuar të sekseve të ndryshme dhe një çiftë të të njëjtit seks, pasi sipas ligjit francez, birësimi nga prindi i dytë nuk ishte i hapur për asnjë çift të pamartuar, qofshin ata homoseksualë apo heteroseksualë.

## **Certifikatat e lindjes**

### **Boeckel dhe Gessner-Boeckel kundër Gjermanisë (7 maj 2013) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Aplikantet, dy gra në një partneritet civil të regjistruar, u ankuan mbi refuzimin e regjistrimit të njëres prej tyre si prind në certifikatën e lindjes së fëmijës së partnerit tjetër, të lindur gjatë partneritetit të tyre. Ato e mbështetën aplikimin në nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme si haptazi të pabazuar, pasi vendosi në dukje se aplikantet nuk ishin në një situatë të ngjashme me çiftet e martuara, të cilave u rezervohej automatikisht e drejta për regjistrim si prind në certifikatat e lindjes së fëmijëve të lindur nga martesë.

## **Aplikime në pritje**

### **R.F. dhe të tjerët kundër Gjermanisë (nr. 46808/16)**

Aplikimi iu komunikua qeverisë gjermane më 13 janar 2017.

Kërkuesja e dytë dhe e tretë në këtë çështje kishin një partneritet civil të të njëjtit seks, të regjistruar. Aplikantja e dytë kishte dhuruar një qelizë vezë e cila u inseminua me materialin gjenetik të një dhuruesi anonim sperme. Embrioni më pas u transferua në mitrën e aplikantes së tretë, e cila lindi aplikantin e parë.

Kërkuesit u ankuan lidhur me refuzimin e autoriteteve vendase për të regjistruar aplikanten e dytë, si prind të dytë të fëmijës.

### **S.ë dhe të tjerët kundër Austrisë (nr. 1928/19)**

Aplikimi iu komunikua Qeverisë Austriake më 12 shkurt 2019.

Aplikuesja e parë dhe e tretë në këtë çështje janë një çift i të njëjtit seks që jetojnë në një partneritet të regjistruar. Aplikantja e dytë është vajza biologjike e aplikantes së parë dhe është birësuar nga aplikantja e tretë. Kërkesa lidhet me refuzimin a autoriteteve austriake për të lëshuar një certifikatë lindjeje që tregon aplikanten e parë dhe të tretë si nënat e aplikantes së dytë.

### **A.D.K. dhe të tjerët kundër Polonisë (nr. 30806/15)**

Aplikimi iu komunikua Qeverisë Polake më 26 shkurt 2019.

Ky rast ka të bëjë me refuzimin e autoriteteve vendase për të përfshirë në regjistrin e gjendjes civile fëmijën e lindur në një familje të të njëjtit seks.

### **Bashkimet civile**

#### **Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë (7 nëntor 2013) (Dhoma e Madhe)**

Ky rast kishte të bënte me “bashkimet civile” në Greqi, të prezantuara me një ligj të vitit 2008, të titulluar “Reformat në lidhje me familjen, fëmijët dhe shoqërinë”, i cili parashikonte një formë zyrtare partneriteti, duke legjitimuar personat e interesuar të regjistrin marrëdhënien e tyre brenda të njëjtit seks, mes një kuadri ligjor më fleksibël se ai i parashikuar nga martesat.

Aplikantët, tetë shtetas grekë (disa prej tyre jetonin së bashku në çift, ndërsa të tjerët ishin në një lidhje, por nuk jetonin së bashku) dhe një organizatë, u ankuan se ligji në fjalë parashikonte bashkime civile vetëm për çiftet e seksit të ndryshëm, duke përjashtuar në këtë mënyrë çiftet e të njëjtit seks nga objekti i tij në mënyrë diskriminuese.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Ajo vuri në dukje në veçanti se, nga 19 shtetet palë në Konventë që autorizuan një formë partneriteti të regjistruar përveç martesës, Lituania dhe Greqia ishin të vetmet që e rezervuan atë ekskluzivisht për çiftet e sekseve të ndryshme. Gjykata konstatoi se shteti grek nuk kishte treguar se ky ndalim ishte i nevojshëm dhe në ndjekje të qëllimeve legjitime të përmendura nga ligji vendas.

#### **Oliari dhe të tjerët kundër Italisë (21 korrik 2015)**

Ky rast kishte të bënte me ankesën e tre çifteve homoseksuale, të cilat sipas legjislacionit italian nuk kishin mundësi të martoheshin apo të hynin në asnjë lloj bashkimi civil të njohur ligjërisht mes tyre.

Gjykata u shpreh se në këtë rast kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Gjykata konsideroi se mbrojtja ligjore e disponueshme për

çiftet e të njëjtit seks në Itali dështonte të siguronte nevojat thelbësore të një çifti në një marrëdhënie të qëndrueshme e të përkushtuar.

Gjykata theksoi se në këtë rast, një bashkim civil ose një partneritet i regjistruar do të ishte mënyra më e përshtatshme për çiftet e të njëjtit seks, të cilët dëshirojnë që lidhja e tyre të njihet ligjërisht. Gjykata vendosi në dukje në veçanti, se kishte një prirje midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës drejt njohjes ligjore të çifteve të të njëjtit seks, ku 24 nga 47 shtete anëtare kishin adoptuar ligje që mundësonin njohje ligjore për këto bashkime. Për më tepër, sipas sondazheve të fundit lidhur me opinionin publik, shumica e popullsisë italiane mbështeste njohjen ligjore të çifteve homoseksuale.

### **Hörmann dhe Moser kundër Austrisë & Dietz dhe Suttasom kundër Austrisë (30 mars 2017) (vendim i fshirë)**

Kërkuesit, dy çifte të të njëjtit seks, të cilët jetonin në marrëdhënie të qëndrueshme prej disa vitesh, u ankuan veçanërisht se ishin diskriminuar për shkak të orientimit të tyre seksual, sepse në Austri partneritetet e regjistruara lidheshin pranë Autoriteteve Administrative të Qarkut, ndërsa martesat civile pranë Zyrës për Çështje të Statusit Personal.

Gjykata vuri në dukje në veçanti, se pas ndryshimeve legjislative, që nga 1 prilli 2017, aplikantët do të kishin mundësinë të lidhnin një partneritet të regjistruar përpara Zyrës për Çështjet e Statusit Personal. Mes këtij parashikimi u konsiderua se çështja ishte zgjidhur në nivel kombëtar dhe gjykata vendosi ta hiqte kërkesat nga lista e saj.

### **Ratzenböck dhe Seydl kundër Austrisë (26 tetor 2017)**

Ky rast kishte të bënte me ankesën e një çifti heteroseksual lidhur me refuzimin e aksesit të tyre në një partneritet të regjistruar, pasi rregullimi ligjor në bazë të të cilit lidheshin këto partneritete, legjitimonte vetëm çiftet e të njëjtit seks. Aplikantët pretendonin se ata ishin diskriminuar bazuar në seksin dhe orientimin e tyre seksual.

Gjykata u shpreh se nuk kishte shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. U theksua në veçanti, se nuk kishte dallime thelbësore midis martesës dhe partneritetit të regjistruar në Austri. Në këtë rast aplikantëve u garantohej qasja në martesë, e cila plotësonte tërësisht nevojat kryesore të tyre për njohje ligjore.

### **Orlandi dhe të tjerët kundër Italisë (14 dhjetor 2017)**

Ky rast kishte të bënte me një ankesë të gjashtë çifteve të të njëjtit seks me pretendimin se nuk kishin mundur të regjistronin në Itali martesat e tyre të lidhura jashtë vendit dhe as nuk u ofrohej ndonjë mundësi tjetër për njohje ligjore të bashkimeve të tyre faktike.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se shteti Italian kishte dështuar të arrinte një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese kombëtare dhe individuale dhe për pasojë kishte shkelur të drejtat e çifteve për njohje ligjore. Gjykata vendosi në dukje në veçanti, se shtetet kishin diskrecion të gjerë nëse do të lejonin apo jo regjistrimin e martesave të të njëjtit seks dhe se në këtë rast shkelja nuk kishte ndodhur si pasojë e mos regjistrimit të martesave të lidhura jashtë vendit, por për shkak se ligji italian nuk kishte ofruar asnjë mbrojtje apo njohje ligjore për këto çifte.

### **Aplikime në pritje**

#### **Fedotova dhe të tjerët kundër Ruisë (nr. 40792/10 dhe dy kërkesa të tjera) (13 korrik 2021) (Aktgjykimi i Dhomës) – rast i referuar në Dhomën e Madhe në Nëntor 2021**

Kjo çështje ka të bëjë me ankesën e tre çifteve të të njëjtit seks që sipas legjislacionit rus nuk kishin mundësi të martoheshin ose të hynin në ndonjë lloj bashkimi tjetër të njohur dhe të mbrojtur ligjërisht.

Në vendimin e datës 13 korrik 2021, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se mohimi i aksesit në njohjen ligjore të statusit të tyre faktik për çiftet e të njëjtit seks, shkonte përtej hapësirës së vlerësimit që gëzonin autoritetet ruse. Gjykata vuri në dukje në veçanti, se Rusia kishte detyrimin të siguronte respektimin e jetës private dhe familjare të kërkuësve, duke ofruar një kuadër ligjor që lejon njohjen dhe mbrojtjen e marrëdhënieve të të njëjtit seks, sipas ligjit të brendshëm.

Më 22 nëntor 2021, Kolegji i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën e Qeverisë Ruse dhe çështja iu referua Dhomës së Madhe.

#### **Formela kundër Polonisë (nr. 58828/12)**

#### **Szypuła kundër Polonisë (nr. 78030/14) dhe Urbanik dhe Alonso Rodriguez kundër Polonisë (nr. 23669/16)**

#### **Grochulski kundër Polonisë (nr. 131/15)**

#### **Przybyszewska kundër Polonisë (nr. 11454/17) dhe nëntë kërkesa të tjera**

#### **Starska kundër Polonisë (nr. 18822/18)**

#### **Meszkes kundër Polonisë (nr. 11560/19)**

#### **Handzlik-Rosuł dhe Rosuł kundër Polonisë (nr. 45301/19)**



Këto kërkesa kanë të bëjnë me ankesat e paraqitura nga çifte të të njëjtit seks, pasi ligji polak nuk i lejon të marthohen ose të hyjnë në ndonjë lloj tjetër bashkimi civil të njohur ligjërisht.

### **Grochulski kundër Polonisë (nr. 131/15)**

Aplikimi iu komunikua Qeverisë Polake më 20 qershor 2020.

Kërkuesi në këtë rast ankohet për pamundësinë e përkohshme të regjistrimit të vetes dhe partnerit të tij të të njëjtit seks në një skemë sigurimi privat të jetës, për çifte.

### **Vizitat bashkëshortore në paraburgim**

#### **Duță kundër Rumanisë 14 maj 2020 (vendim i hequr)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin ndaj kërkesës së një të burgosuri homoseksual për vizita bashkëshortore gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në institucion.

Duke marrë parasysh marrëveshjen miqësore të arritur ndërmjet kërkuesit dhe Qeverisë Rumune, Gjykata vendosi të hiqte kërkesën nga lista e çështjeve.

### **Kundërrindikimet për dhurimin e gjakut, përjashtimi nga dhënia e gjakut**

#### **Tosto kundër Italisë, Crescimone kundër Italisë dhe Faranda kundër Italisë (15 tetor 2002) (vendim i fshirë)**

Secilit prej aplikantëve, pasi kishin shprehur dëshirën për të dhuruar gjak, i ishte dhënë një formular ku renditeshin rastet në të cilat një person përjashtohej nga dhënia e gjakut, për shkak të rrezikut të kalimit të sëmundjeve infektive si HIV-i ose Hepatiti, në përputhje me një dekret të Ministrisë së Shëndetësisë të vitit 1991. Të qenit në një marrëdhënie homoseksuale renditej në formular si një nga arsyet e përjashtimit të përhershëm. Aplikantët u ankuan për shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës për shkak të përjashtimit të përhershëm të tyre nga dhurimi i gjakut, bazuar ekskluzivisht në orientimin e tyre seksual.

Gjykata vendosi në dukje se pas zëvendësimit të dekretit ministror të vitit 1991 me dekretin e 26 janarit 2001, kërkuesit mund të dhuronin gjak. Që nga hyrja në fuqi e rregullave të reja, autoritetet italiane kishin eliminuar pengesën ligjore ndaj kërkuesve. Në këtë linjë, Gjykata vlerësoi se nuk ishte më e justifikuar të vijonte shqyrtimin e çështjes.

### **Aplikim në pritje**

#### **Drelon kundër Francës (nr. 3153/16 dhe nr. 27758/18)**

Aplikimi iu komunikua Qeverisë Franceze më 27 janar 2021.

Kërkesa lidhej me regjistrimin e aplikantit si homoseksual nga Agjencia Franceze e Gjakut (Établissement français du sang) si dhe me kundërrindikacionet për dhurimin e gjakut të parashikuara nga ligji vendas për burrat që kanë pasur marrëdhënie seksuale me burra të tjerë gjatë një periudhe të caktuar përpara donacionit.

## **Refuzimi për punësim**

### **Aplikim në pritje**

#### **Oleynik kundër Ruisë (nr. 4086/18)**

Aplikimi iu komunikua Qeverisë Ruse më 5 shkurt 2020.

Ky rast ka të bëjë me një burrë homoseksual, të cilit iu mohua punësimi nga një kompani private. Kërkuesi pretendon se mohimi i punësimit ishte i një natyre diskriminuese dhe se gjykatat vendase nuk iu përgjigjën argumenteve të tij në këtë drejtim.

## **Lirimi nga shërbimi ushtarak**

### **Lustig-Prean dhe Beckett kundër Mbretërisë së Bashkuar & Smith dhe Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar (27 shtator 1999)**

### **Perkins dhe R. kundër Mbretërisë së Bashkuar & Beck, Copp dhe Bazeley kundër Mbretërisë së Bashkuar (22 tetor 2002)**

Aplikantët ishin të gjithë personel i forcave të armatosura britanike, të cilët ishin shkarkuar nga shërbimi për shkak të homoseksualitetit të tyre. Aplikantët pretenduan në veçanti, se hetimet për seksualitetin e tyre dhe shkarkimi si rezultat i ndalimit absolut të homoseksualëve në forcat e armatosura, kishin shkelur të drejtat e tyre sipas nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës.

Në të gjitha këto raste, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës. U konstatua se masat e marra ndaj kërkuesve përbënin ndërhyrje të rënda në jetën e tyre private dhe nuk mund të justifikoheshin mes “arsyeve bindëse dhe me peshë”.

Në çështjet Smith dhe Grady & Beck, Copp dhe Bazeley, Gjykata gjithashtu u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të Konventës, pasi ankuesit nuk kishin akses në asnjë mjet të brendshëm juridik efektiv në lidhje me shkeljen e të drejtës së tyre për respektimin e jetës private.

## **Rrëzimi i padive për shpifje**

### **Sousa Goucha kundër Portugalisë (22 mars 2016)**

Ky rast kishte të bënte me vendimet e gjykatave portugeze, të cilat injoruan një çështje shpifjeje që kërkuesi, një nga drejtuesit më të njohur televiziv në Portugali, kishte ngritur kundër një kompanie televizive, pas një shakaje të bërë gjatë transmetimit të një shfaqjeje humoristike në fund të vitit 2009. Kërkuesi pretendoi se shakaja, e cila e kishte përfshirë atë në një listë të drejtueseve më të mira femra të televizionit, dëmtoi reputacionin e tij, pasi kishte krijuar konfuzion mes gjinisë së tij dhe orientimit seksual. Në prill 2012, gjykatat portugeze e rrëzuan padinë e kërkuesit për shpifje si të pabazuar. Ankuesi pohoi në veçanti, se vendimet kishin qenë diskriminuese, pasi ishin bazuar në homoseksualitetin e tij.

Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit që i jepej shtetit, ajo konstatoi se gjykatat portugeze kishin vendosur një ekuilibër të drejtë midis lirisë së shprehjes së shfaqjes televizive (neni 10 i Konventës) dhe të drejtës së kërkuesit për të respektuar reputacionin e tij (Neni 8). Gjykata gjithashtu u shpreh, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në lidhje me nenin 8 të saj, pasi nuk kishte prova të mjaftueshme për të besuar se orientimi seksual i kërkuesit kishte pasur ndonjë ndikim në vendimet e gjykatave vendase.

## **Riprodhimi i asistuar nga mjekët**

### **Charron dhe Merle-Montet kundër Francës (16 janar 2018) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Kërkueset u ankuan se kërkesa e tyre për riprodhim të asistuar mjekësor ishte refuzuar, me arsyetimin se ligji francez nuk e autorizonte një procedurë të tillë mjekësore për çiftet e të njëjtit seks.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike të brendshme. Gjykata vendosi në dukje, se vendimi i Spitalit për refuzimin e kërkesës së aplikanteve për akses në riprodhimin e asistuar mjekësor ishte një vendim administrativ individual që mund të apelohej në gjykatat kombëtare administrative. Duke qenë se kërkueset nuk e kishin përdorur këtë mjet juridik dhe duke rikujtuar rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, Gjykata e shpalli ankesën të papranueshme.

## **Pretendimet mbi komente ose publikimet me përmbajtje fyese**

### **Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë (14 janar 2020)**

Kërkuesit, dy të rinj që ishin në një lidhje të të njëjtit seks me njëri tjetrin, pretenduan se ishin diskriminuar për shkak të orientimit seksual, përmes refuzimit të autoriteteve vendase për të nisur një hetim paraprak mbi komentet me përmbajtje urretjeje në profilin e njërit prej tyre në

rrjetin social Facebook. Njëri prej kërkuesve kishte postuar një fotografi të tyre duke u puthur në profilin e tij në Facebook, çka shkaktoi qindra komente urrejtjeje në internet. Disa komente u drejtoheshin personave LGBTIQ+ në përgjithësi, ndërsa të tjerat i kërcënonin personalisht aplikantët. Kërkuesit parashtruan se ata ishin diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe se refuzimi i autoriteteve vendase për të hetuar komentet i kishte lënë ata në pamundësi për zgjidhje ligjore dhe në një situatë të pasigurt.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës, duke konstatuar se kërkuesit kishin pësuar diskriminim për shkak të orientimit të tyre seksual dhe se Qeveria Lituanë nuk kishte dhënë asnjë justifikim që tregonte se ndryshimi në trajtim kishte qenë në përputhje me standardet e Konventës. Gjykata vuri në dukje në veçanti, se orientimi seksual i aplikantëve kishte luajtur rol në mënyrën se si ata ishin trajtuar nga autoritetet vendase, të cilat kishin shprehur mjaft qartë mosmiratimin e tyre ndaj demonstrimit publik të homoseksualitetit të kërkuesve, duke refuzuar të fillonin një hetim paragjyqësor.

Një qëndrim i tillë diskriminues nga autoritetet vendase, i vendoste kërkuesit në një pozitë të pambrojtur ndaj kërcënimeve për sulm në dëm të integritetit të tyre fizik dhe mendor. Gjykata gjithashtu u shpreh, se kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të Konventës, sepse kërkuesve u ishte mohuar përdorimi i mjetit juridik të brendshëm për ankesat e tyre.

### **Shoqata AÇEPT dhe të tjerët kundër Rumanisë (1 qershor 2021)**

Ky rast kishte të bënte me ndërprerjen e shfaqjes së një filmi për të drejtat LGBT (lesbikëve, gejvë, biseksualëve dhe transgjinjorëve) nga një grup që bërtiste me fjalor abuziv e homofobik dhe me dështimin e pretenduar të autoriteteve vendase për të mbrojtur aplikantët që vinin nga një organizatë për të drejtat LGBT dhe për të kryer një hetim efektiv pasues mbi ankesën e tyre.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) ndaj kërkuesve individualë, duke konstatuar se autoritetet rumune të nxitura nga homofobia, kishin dështuar të përmbushin detyrimin e tyre pozitiv për të hetuar në mënyrë efektive abuzimet verbale të drejtuara ndaj kërkuesve individualë. Duke vepruar në këtë mënyrë autoritetet kishin treguar njëanshmërinë e tyre ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT.

Gjykata gjithashtu u shpreh, se kishte pasur një shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 11 (liria e tubimit dhe organizimit) të Konventës në rastin konkret, duke konstatuar se autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë paraprake për të siguruar që organizimi në fjalë (i cili ishte organizuar nga shoqata aplikante me pjesëmarrjen e aplikantëve individualë) të mund të zhvillohej në mënyrë paqësore.

## **Aplikim në pritje për t`u shqyrtuar**

Minasyan dhe të tjerët kundër Armenisë (nr. 59180/15)

Aplikimi iu komunikua Qeverisë Armene më 21 shkurt 2018.

Aplikantët, aktivistë të të drejtave të homoseksualëve në Armeni, u ankuan për artikujt e botuar në faqen e internetit të një gazete kombëtare që supozohet se fyen ata dhe komunitetin LGBT.

## **Përgjegjësia prindërore, kujdestaria e fëmijëve dhe vizitat**

### **Salgueiro da Silva Mouta kundër Portugalisë (21 dhjetor 1999)**

Kërkuesi, një homoseksual që jetonte me një burrë tjetër, u pengua nga ish bashkëshortja që të vizitonte vajzën e tij, në kundërshtim me një marrëveshje të arritur në kohën e divorcit të tyre. Aplikanti u ankua për një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe familjare, siç garantohet nga neni 8 i Konventës dhe për diskriminim në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Kërkuesi parashtrroi se ishte detyruar nga gjykata kombëtare e apelit të fshihte homoseksualitetin kur të takonte vajzën e tij.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Vendimi i gjykatave portugeze ishte bazuar kryesisht në faktin se kërkuesi ishte një homoseksual dhe se “fëmija duhet të jetonte në një familje tradicionale portugeze”. Ky diferencim në trajtim nga autoritetet vendase nuk ishte i pranueshëm sipas Konventës.

## **Leja prindërore**

### **Hallier dhe të tjerët kundër Francës (12 dhjetor 2017) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Kërkueset, dy gra që kishin jetuar si çift për shumë vite dhe ishin në një partneritet civil, u ankuan për refuzimin a autoriteteve franceze ndaj kërkesës së aplikantes së dytë për të marrë lejen e atësisë me rastin e lindjes së fëmijës së partneres së saj.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme si haptazi të pabazuar, duke vënë në dukje në veçanti se institucioni i lejes së atësisë ndiqte një qëllim legjitim, që të lejonte baballarët të luanin një rol më të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve të tyre, duke u përfshirë në një fazë të hershme dhe promovonte një shpërndarje më të barabartë të detyrave shtëpiake midis burrave dhe grave.

Së fundi, Gjykata vuri në dukje se pas ndryshimeve të paraqitura nga një ligj i 17 dhjetorit 2012, partneri/ja i/e nënës kishte të drejtën e lejes së kujdestarit, nën të njëjtat kushte si leja e atësisë, nëse ai ose ajo nuk ishte prindi biologjik i fëmijës.

## **Leja e qëndrimit**

### **Pajiq kundër Kroacisë (23 shkurt 2016)**

Rasti kishte të bënte me ankesën e një shtetaseje të Bosnje-Hercegovinës, e cila ishte në një marrëdhënie të qëndrueshme të të njëjtit seks me një grua që jetonte në Kroaci. Ankuesja pretendonte se ishte e diskriminuar për shkak të orientimit të saj seksual sa herë aplikonte për leje qëndrimi në Kroaci.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. U konstatua se kërkuesja dhe çiftet e të njëjtit seks prekeshin nga një diferencim në trajtim krahasuar me çiftet e seksit të ndryshëm, në bazë të ligjit për të huajt, i cili në rastet e çifteve të sekseve të ndryshme ofronte mundësinë e aplikimit për një leje qëndrimi për bashkim familjar. Qeveria kroate nuk kishte provuar se diferencimi në trajtim ishte i nevojshëm për të arritur një qëllim legjitim dhe as nuk e kishte justifikuar këtë trajtim me ndonjë arsye tjetër bindëse.

### **Taddeucci dhe McCall kundër Italisë (30 qershor 2016)**

Ky rast kishte të bënte me pamundësinë e kërkuesve, një çift homoseksual (njëri prej tyre ishte italian dhe tjetri shtetas i Zelandës së Re), për të jetuar së bashku në Itali për shkak të refuzimit të autoriteteve italiane për t'i dhënë aplikantit të dytë një leje qëndrimi për arsye familjare. Refuzimi ndodhi sepse legjislacioni kombëtar i imigracionit nuk i lejonte partnerët e pamartuar të merrnin lejen e qëndrimit përmes një anëtarë të familjes. Aplikantët pretenduan në veçanti, se ky refuzim përbënte diskriminim bazuar në orientimin e tyre seksual.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se refuzimi për t'u dhënë lejen e qëndrimit aplikantëve për arsye familjare ishte një diskriminim i pajustificuar. Gjykata konstatoi në veçanti, se situata e kërkuesve, një çift homoseksual, nuk mund të konsiderohej e krahasueshme me atë të një çifti heteroseksual të pamartuar pasi çiftet homoseksuale në kohën objekt ankese nuk mund të martoheshin dhe as të përfitonin nga ndonjë formë tjetër e njohjes ligjore. Interpretimi kufizues i nocionit të jetës familjare dhe anëtarëve të familjes përbënte një pengesë të pakapërcyeshme për dhënien e lejes së qëndrimit për çiftet homoseksuale. Ky interpretim kufizues nuk merrte parasysh situatën personale të aplikantëve dhe në veçanti pamundësinë e tyre për të përfituar nga një formë njohjeje ligjore të marrëdhënies së tyre në Itali. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se duke vendosur të trajtonte çiftet homoseksuale në të njëjtën mënyrë si çiftet heteroseksuale të palidhura në martesë, Italia kishte shkelur të drejtën e kërkuesve për të mos iu nënshtruar diskriminimit bazuar në orientimin seksual sipas të drejtave të tyre në bazë të nenit 8 të Konventës.

## **Kontrolli dhe sekuestroja në ambientet e një organizate**

### **LAMBDA İstanbul LGBTI – Shoqata e Solidaritetit kundër Turqisë (19 janar 2021) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Kjo çështje kishte të bënte me një kontroll dhe sekuestrimin e dokumenteve në ambientet e organizatës kërkuese.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme si haptazi të pabazuar. U konstatua se kontrolli dhe sekuestroja e vendosur kishin qenë në proporcion të arsyeshëm me qëllimin legjitim të ndjekur, për parandalimin e një krimi. Gjykata u shpreh se ndaj kërkuesit nuk kishte nisur asnjë procedim penal si rezultat i kontrollit dhe të gjitha dokumentet e sekuestruara i ishin kthyer. Për më tepër, në dritën e dokumenteve në dosje dhe informacionit të dhënë nga palët, organizata ankuese nuk kishte vërtetuar në asnjë moment shkallën në të cilën ky kontroll kishte ndikuar apo penguar aktivitetet e saj.

## **Mbrojtja sociale**

### **Mata Estevez kundër Spanjës (10 maj 2001) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Kërkuesi u ankua për diferencimin në trajtim në lidhje me të drejtën për një pension familjar midis partnerëve homoseksualë në lidhje *de facto* dhe çifteve heteroseksuale të martuara apo të pamartuara, të cilët kishin të drejtë për një pension familjar. Kërkuesi parashtrroi se një diferencim i tillë në trajtim përbënte diskriminim të pajustificuar që cenonte të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme si haptazi të pabazuar, duke konstatuar se legjislacioni spanjoll në lidhje me të drejtën për pensionin e të mbijetuarve ndiqte një qëllim legjitim (mbrojtja e familjes bazuar në lidhjet e martesës) dhe se ndryshimi në trajtim konsiderohet të jetë brenda kufijve të gjykimit të shtetit.

### **P.B. dhe J.S. kundër Austrisë (nr. 18984/02) (22 korrik 2010)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin për të përfshirë në sigurimet shëndetësore partnerin homoseksual të një personi të siguruar. Përpara një ndryshimi legjislativ në korrik 2007, ligji austriak parashikonte që vetëm një i afërm i ngushtë i personit të siguruar ose një bashkëjetues i seksit të kundërt kualifikohej si person në ngarkim.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës sa i përket periudhës para korrikut 2007. Si rezultat i amendamentit legjislativ të korrikut 2007, ligji specifik kombëtar ishte tashmë neutral sa i përkiste orientimit seksual të bashkëjetuesve, çka sipas Gjykatës, i kishte dhënë fund shkeljes.

### **Manenc kundër Francës (21 shtator 2010) (vendim për pranueshmërinë)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin e pensionit për të mbijetuarin e një partneriteti civil midis dy personave të të njëjtit seks, me arsyetimin se nuk ishte plotësuar kërkesa për martesë të ligjshme. Kërkuesi pretendoi se kjo kërkesë ishte diskriminuese, veçanërisht ndaj personave që kishin lidhur një marrëveshje partneriteti civil dhe veçanërisht ndaj çifteve të të njëjtit seks.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme, si haptazi të pabazuar. Ajo vuri në dukje në veçanti, se pensioni i të mbijetuarit i ishte refuzuar kërkuesit vetëm me arsyetimin se ai kishte qenë në një partneritet civil. Për rrjedhojë, legjislacioni francez mbi përfitimet e të mbijetuarve ndiqte një qëllim legjitim lidhur me mbrojtjen e familjes bazuar në lidhjet e martesës. Kufizimi i fushës së veprimit të legjislacionit për çiftet e martuara, me përjashtimin e partnerëve në një partneritet civil, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, përbënte një çështje që qëndronte brenda hapësirave të vlerësimit që u jep shteteve kombëtare Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Aldeguer Tomás kundër Spanjës (14 qershor 2016)**

Ky rast kishte të bënte me ankesën e kërkuesit se ishte diskriminuar për shkak të orientimit të tij seksual, përmes mohimit të një pensioni familjar pas vdekjes së partnerit të tij, me të cilin ai kishte jetuar në një lidhje të qëndrueshme e bashkëjetesë de facto. Kërkuesi nuk kishte mundur të martohej me partnerin e tij sipas ligjit në fuqi gjatë jetës së këtij të fundit. Tri vite pas vdekjes së partnerit të kërkuesit, hyri në fuqi ligji që legalizon martesat e të njëjtit seks në Spanjë.

Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës dhe nenin 1 (mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës, duke konstatuar se nuk kishte pasur diskriminim në rastin e ankuesit. Në veçanti, situata e kërkuesit pas hyrjes në fuqi të ligjit për legalizimin e martesave të të njëjtit seks në Spanjë në 2005, nuk ishte shumë e ngjashme me atë të një partneri të mbijetuar të një çifti heteroseksual që bashkëjetonte, i cili nuk kishte qenë në gjendje të martohej me partnerin e tij/saj më parë. Për më tepër, shtetet në kohën përkatëse kishin një hapësirë të caktuar vlerësimi ("margin of appreciation") sa i përket kohës së prezantimit të ndryshimeve legjislative në fushën e njohjes ligjore të çifteve të të njëjtit seks dhe statusit të saktë që u atribuohet.

### **Trashëgimi i një qiraje**

#### **Karner kundër Austrisë (24 korrik 2003)**

Kërkuesi pretendoi në veçanti, se vendimi i Gjykatës së Lartë Austriake për të mos njohur të drejtën e tij për të trashëguar një qira pas vdekjes së partnerit ishte diskriminim për shkak të orientimit të tij seksual. Qeveria kishte kërkuar që aplikimi të hiqej nga lista e çështjeve, në përputhje me nenin 37 të Konventës, meqenëse aplikanti kishte vdekur gjatë procesit dhe nuk kishte asnjë trashëgimtar që dëshironte të ndiqte kërkesën.



Në rrethanat e veçanta të çështjes, Gjykata konstatoi se respektimi i të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe në Protokollet e saj, kërkonte vazhdimin e shqyrtimit të çështjes dhe hodhi poshtë pretendimin e Qeverisë për heqjen e aplikimit nga lista e çështjeve. Gjykata vendosi më tej, se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se Qeveria austriake nuk kishte ofruar argumente bindëse dhe me peshë për të justifikuar interpretimin e ngushtë të seksionit 14(3) të Aktit të Qirasë, i cili pengonte aplikimin e dispozitës për partnerin e mbijetuar në një çift të të njëjtit seks.

### **Kozak kundër Polonisë (2 mars 2010)**

Pas vdekjes së partnerit të tij të të njëjtit seks, kërkuesi nisi një proces ligjor kundër bashkisë duke pretenduar se kishte të drejtë të trashëgonte qiranë e banesës shtetërore që ishte në emër të partnerit të tij. Në rrëzimin e pretendimit, gjykatat polake konstatuan se kërkuesi ishte larguar nga banesa dhe kishte ndaluar së paguari qiranë përpara vdekjes së partnerit të tij dhe se, në çdo rast, një marrëdhënie martesore de facto, e cila ishte parakusht për trashëgiminë e qirasë së një apartamenti shtetëror, mund të ekzistonte vetëm ndërmjet personave të seksit të kundërt.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Pavarësisht nga rëndësia e qëllimit legjitim të ndjekur në rastin e kërkuesit, përkatësisht ai i mbrojtjes së familjeve tradicionale, në zgjedhjen e mjeteve për të mbrojtur këtë qëllim, shteti duhet të merrte parasysh zhvillimet dhe ndryshimet në shoqëri, duke përfshirë faktin se nuk kishte vetëm një mënyrë apo zgjedhje të drejtë në sferën e vendimarrjes e të jetuarit të jetës familjare dhe private. Duke pasur parasysh kufirin e ngushtë të vlerësimit të shtetit në rastet e diferencimit në trajtim në bazë të orientimit seksual, një përjashtim i përgjithshëm nga trashëgimia në qira për personat që jetojnë në një marrëdhënie homoseksuale, nuk mund të konsiderohet i pranueshëm.

### **Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 i Konventës)**

#### **Ladele dhe McFarlane kundër Mbretërisë së Bashkuar (15 janar 2013)**

Aplikantët, respektivisht një punonjës regjistruar i lindjeve, vdekjeve dhe martesave dhe një këshillues, i cili ofronte një shërbim konfidencial të terapisë seksuale, praktikues të fesë së krishterë, pretendonin se ligji vendas kishte dështuar në mënyrë adekuate për të mbrojtur të drejtën e tyre për të shfaqur besimin fetar. Kërkuesit u ankuan se ishin pushuar nga puna për shkak se kishin refuzuar të kryenin disa nga detyrat e tyre, pasi konsideronin se në këto raste do të mbështesnin homoseksualitetin, një praktikë që ishte e papajtueshme me besimet e tyre fetare.

Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 9 (liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë) të marrë individualisht, por edhe në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Gjykata u shpreh në veçanti se nuk mund të pretendohet nga kërkuesit se gjykatat kombëtare nuk kishin arritur një ekuilibër të drejtë me lënien në fuqi të vendimeve të punëdhënësve për të

ngritur procedime disiplinore. Në secilin rast, punëdhënësit po ndiqnin një politikë të mosdiskriminimit ndaj përdoruesve të shërbimeve, ku përfshihej e drejta për të mos u diskriminuar për shkak të orientimit seksual.

### **Liria e shprehjes (neni 10 i Konventës)**

#### **Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë (9 shkurt 2012)**

Çështja kishte të bënte me dënimin e kërkuesve të vitit 2005 për shpërndarjen në një shkollë të mesme të lartë të rreth 100 fletëpalosjesh të konsideruara nga gjykatat si ofenduese për komunitetin LGBTIQ+. Kërkuesit pretenduan në veçanti, se Gjykata e Lartë suedeze mes vendimit të saj kishte shkelur të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes.

Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës, pasi ndërhyrja në ushtrimin e të drejtës së kërkuesve për lirinë e shprehjes ishte konsideruar në mënyrë të arsyeshme nga autoritetet suedeze si e nevojshme në një shoqëri demokratike, për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të pjesës tjetër të shoqërisë. Gjykata konstatoi në veçanti, se deklaratat në fjalë kishin përmbajtje paragjyquese edhe pse nuk përbënin një thirrje të drejtpërdrejtë për akte urretjeje dhe se diskriminimi i bazuar në orientimin seksual ishte po aq serioz sa diskriminimi i bazuar në racë, origjinë ose ngjyrë.

#### **Mladina D.D. Lubjana kundër Sllovenisë (17 prill 2014)**

Ky rast kishte të bënte me ankesën e një botuesi se ishte detyruar nga gjykatat kombëtare t'i paguante dëmshpërblim një parlamentar për fyerjen ndaj tij në një artikull sa i përket debatit parlamentar mbi njohjen ligjore të marrëdhënieve të të njëjtit seks. Artikulli u botua në revistën e botuesit në qershor 2005.

Kërkuesi u ankua se gjykatat kombëtare nuk kishin marrë parasysh faktin që stili i ekzagjeruar dhe satirik i artikullit ishte ofendues ndaj parlamentarit.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës. Ajo vuri në dukje se kufijtë e kritikës publike së pranueshme për një politikan në krahasim me një individ privat ishin më të gjera, veçanërisht kur ai vetë kishte bërë deklaratat publike të diskutueshme. Si konteksti në të cilin ishte shkruar artikulli i botuesit (një debat intensiv politik) ashtu edhe stili i përdorur (përputhja me komentet dhe sjelljet provokuese të vetë parlamentarit) nuk ishin marrë parasysh mjaftueshëm nga gjykatat kombëtare. Artikulli nuk ishte një sulm personal i paarsyeshëm ndaj parlamentarit, por një kundërpërgjigje ndaj vërejtjeve publike të vetë parlamentarëve dhe në veçanti sjelljes që mund të konsiderohet fyese ndaj homoseksualëve dhe promovim i stereotipeve negative. Gjykata u shpreh se gjykatat kombëtare nuk kishin mundur të arrinin një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese të mbrojtjes së reputacionit ose të drejtave të deputetit dhe të drejtës së botuesit për lirinë e shprehjes.

### **Kaos GI kundër Turqisë (22 nëntor 2016)**

Ky rast kishte të bënte me sekuestrimin e të gjitha kopjeve të një numri të një reviste të botuar nga një shoqatë kërkimore kulturore dhe solidariteti për personat LGBTIQ+ në Turqi. Shoqata kërkuese u ankua në veçanti për sekuestrimin në fjalë dhe procedimin penal të ngritur ndaj presidentit të shoqatës dhe kryeredaktorit të revistës.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se baza e mbrojtjes së moralit publik në të cilën mbështeteshin autoritetet kombëtare kishte qenë e pamjaftueshme për të justifikuar urdhrin e sekuestrimit dhe konfiskimit të të gjitha kopjeve të numrit të revistës në fjalë për më shumë se pesë vjet.

### **Bayev dhe të tjerët kundër Rusisë (20 qershor 2017)**

Çështja kishte të bënte me një ankesë të paraqitur nga tre aktivistë LGBTIQ+ rreth legjislacionit në Rusi, i cili ndalon promovimin e homoseksualitetit (“ligji i propagandës së homoseksualëve”/ “promovimi i marrëdhënieve seksuale jo-tradicionale mes të miturve”). Për kundërshtimin e këtyre ligjeve, kërkuesit kishin organizuar demonstrata ndërmjet viteve 2009 dhe 2012. Për këtë arsye shteti rus i shpalli ata fajtorë për kundërvajtje administrative dhe aplikoi gjoba. Aplikantët u ankuan për ndalimin e deklaratave publike në lidhje me identitetin, të drejtat dhe statusin social të pakicave seksuale, duke pretenduar se ky ndalim ishte diskriminues për personat LGBTIQ+ në vend.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje individuale të nenit 10 (liria e shprehjes) dhe shkelje të po këtij nëni në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se megjithëse ligjet në fjalë synonin kryesisht mbrojtjen e të miturve, kufijtë e këtyre ligjeve nuk ishin përcaktuar qartë dhe zbatimi i tyre ishte arbitrar. Për më tepër, vetë qëllimi i ligjeve dhe mënyra se si ato ishin formuluar dhe zbatuar në rastin e kërkuesve, kishte qenë diskriminues dhe nuk i shërbente asnjë interesi legjitim publik. Me miratimin e ligjeve të tilla, autoritetet ruse kishin përforcuar stigmën dhe paragjykimin dhe kishin inkurajuar homofobinë ndaj komunitetit LGBTIQ+, e cila është e papajtueshme me vlerat e një shoqërie demokratike.

### **Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar (7 dhjetor 2021) (vendim mbi pranueshmërinë)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin e një furre buke të drejtuar nga individë të krishterë për të përgatitur një tortë me mesazhin “Support Gay Marriage” dhe logon “QueerSpace”, të porositur nga aplikanti, i cili punonte në “QueerSpace”, një organizatë për lezbiket, gejtë, biseksualët dhe transgjinjorët në Irlandën e Veriut. Aplikanti u ankua lidhur me vendimin e Gjykatës së Lartë vendase, i cili rrëzonte pretendimin e aplikantit për shkelje të detyrës nga ana e drejtuesve të furrës së bukës.

Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike të brendshme. U konstatua në veçanti se kërkuesi nuk kishte adresuar të drejtat e tij to njohura në bazë të Konventës në asnjë moment gjatë procesit të brendshëm. Duke u mbështetur vetëm në

ligjin kombëtar, kërkuesi u kishte hequr gjykatave të brendshme mundësinë për të adresuar çdo çështje të ngritur nga Konventa.

### **Macate kundër Lituanisë (nr. 61435/19) (Gusht 2021) (heqja dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe)**

Ky aplikim ka të bëjë me një libër për fëmijë të shkruar nga një autore lezbike, i cili ritrajton gjashtë tregime të bazuara në përralla tradicionale, por duke përfshirë personazhe nga grupe sociale të marginalizuara dhe tema të tilla si migracioni dhe bullizmi. Dy nga gjashtë përrallat përmbajnë linja historish të marrëdhënieve romantike dhe martesave midis personave të të njëjtit seks. Pas një rekomandimi të lëshuar nga Inspektorati i Etikës Gazetareske, libri u etiketua nga botuesi si potencialisht i dëmshëm për fëmijët nën 14 vjeç. Kërkuesja u ankua në veçanti se libri ishte etiketuar si i dëmshëm për fëmijët për të vetmen arsye se ai përmbante një përshkrim pozitiv të marrëdhënieve të të njëjtit seks.

Më 18 qershor 2020, Gjykata njoftoi për kërkesën Qeverinë Lituaneze dhe u bëri pyetje palëve sipas nenit 10 (liria e shprehjes) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Dhoma së cilës i ishte caktuar çështja hoqi dorë nga juridiksioni i trajtimit të kësaj çështjeje në favor të Dhomës së Madhe.

### **Liria e tubimit dhe e organizimit (neni 11 i Konventës)**

#### **Bączkoëski dhe të tjerët kundër Polonisë (3 maj 2007)**

Aplikantët ishin Fondacioni për Barazi (Fundacja Równość) dhe pesë anëtarë të këtij fondacioni për të drejtat LGBTIQ+. Në vitin 2005, autoritetet lokale refuzuan të jepnin lejen që ky fondacion të organizonte një marshim në rrugët e Varshavës, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi diskriminimin ndaj pakicave, grave dhe personave me aftësi të kufizuara. Edhe pa një leje zyrtare fondacioni e zhvilloi marshimin. Aplikantët u ankuan se e drejta e tyre për tubim paqësor ishte shkelur nga mënyra në të cilën autoritetet vendase kishin zbatuar ligjin vendas në çështjen e tyre. Më tej aplikantët pretenduan se ishin trajtuar në një mënyrë diskriminuese për faktin se atyre iu ishte refuzuar leja për të organizuar demonstrata të caktuara, ndërkohë që organizatorë të tjerë e kishin marrë këtë leje nga autoritetet vendase.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 11 (liria e tubimit), shkelje të nenit 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) në lidhje me nenin 11 dhe shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 11 të Konventës. U konstatua në veçanti, se edhe pse marshimi ishte mbajtur, kërkuesit kishin ndërmarrë një risk të lartë pasi nuk ishin të autorizuar zyrtarisht për mbajtjen e tij. Gjykata vlerësoi se në atë kohë aplikantët kishin në dispozicion vetëm mjete juridike post hoc në lidhje me vendimet që refuzonin lejen për eventin. Së fundmi, në mënyrë të arsyeshme mund të supozohej se arsyeja e vërtetë e refuzimit kishte qenë qëndrimi i autoriteteve vendase ndaj homoseksualitetit.

### **Alekseyev kundër Ruisë (21 tetor 2010)**

Kërkuesi ishte një nga organizatorët e disa marshimeve për promovimin e tolerancës dhe respektit ndaj të drejtave të njeriut LGBTIQ+, në vitet 2006, 2007 dhe 2008 në Rusi. Ai u ankua për ndalimin e përsëritur të mbajtjes së marshimeve për të drejtat LGBTIQ+, për mungesën e një mjeti juridik efektiv për të kundërshtuar këto ndalime dhe për trajtimin diskriminues ndaj tij në bazë të orientimit seksual.

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 11 (liria e tubimit), shkelje të nenit 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) në lidhje me nenin 11 dhe shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 11 të Konventës. U konstatua veçanërisht se ndalesat e vendosura nga autoritetet vendase për mbajtjen e marshimeve nuk kishin qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata u shpreh se kërkuesi nuk kishte në dispozicion asnjë mjet juridik efektiv për të kundërshtuar këto ndalime dhe se ato kishin qenë diskriminuese për shkak të orientimit të tij seksual.

### **Genderdoc-M kundër Moldavisë (12 qershor 2012)**

Aplikanti është një organizatë joqeveritare me bazë në Moldavi, puna e së cilës përqendrohet në ofrimin e informacionit dhe shërbimeve ndaj komunitetin LGBTIQ+. Çështja kishte të bënte me ndalimin e një demonstrate që shoqata ankuese kishte planifikuar të zhvillonte në Kishinau në maj 2005, për të inkurajuar adoptimin e ligjeve për mbrojtjen e pakicave seksuale nga diskriminimi. Organizata u ankua në veçanti, se ndalimi kishte qenë i paligjshëm.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 11 (liria e tubimit dhe e organizimit), shkelje të nenit 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) në lidhje me nenin 11 dhe shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 11 të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se kërkuesit i ishte mohuar një mjet i brendshëm juridik efektiv në lidhje me ankesën mbi shkeljen e së drejtës për lirinë e tubimit. Për më tepër, Gjykata u shpreh se kur autoritetet kombëtare kufizojnë të drejtën e tubimit, ato duhet të ofrojnë arsye të qarta, gjë që nuk kishte ndodhur në rastin konkret.

### **Lashmankin dhe të tjerët kundër Ruisë (7 shkurt 2017)**

Në këtë rast, 23 aplikantë nga pjesë të ndryshme të Ruisë pretenduan se autoritetet lokale kishin vendosur kufizime të rënda për organizimet paqësore të planifikuara prej tyre, pa ndonjë arsyetim të caktuar. Sa u përket katër aplikantëve në veçanti, organizimet që ata kishin propozuar ishin: një marshim dhe takim i krenarisë LGBTIQ+ në qendër të Shën Petersburgut më 26 qershor 2010; një grumbullim në katër rrethe të ndryshme administrative të Shën Petersburgut; një marshim dhe takim i krenarisë LGBTIQ+ në Shën Petersburg më 25 qershor 2011.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 11 (liria e tubimit dhe e organizimit) të interpretuar në dritën e nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës. U konstatua se autoritetet vendase kishin vendosur kufizime aq të rënda në planet e aplikantëve për organizimin e

eventeve publike, sa kishin shkelur të drejtën e kërkuësve për lirinë e tubimit dhe organizimit. Kufizimet përfshinin kërkesa mbi vendndodhjen, kohën dhe mënyrën e sjelljes së pjesëmarrësve çka sabotonte vetë qëllimin e organizimit. Këto kufizime, së bashku me një gamë të gjerë masash të marra kundrejt aplikantëve kishin qenë joproporcionale dhe të pajustificuara. Gjykata gjithashtu u shpreh, se kishte pasur një shkelje të nenit 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) në lidhje me nenin 11 të Konventës, duke konstatuar se nuk kishte pasur asnjë procedurë ligjore në dispozicion që u mundësonte kërkuësve të kundërshtonin siç duhej vendimet e autoriteteve vendase.

### **Alekseyev dhe të tjerët kundër Ruisë (27 nëntor 2018)**

Ky rast, i cili mbledhi 51 aplikime nga shtatë aplikantë, kishte të bënte me refuzimin e vazhdueshëm nga autoritetet ruse për të miratuar kërkesat e organizatorëve për të mbajtur evente LGBTIQ+. Kërkuësit u ankuan se atyre u ishte ndaluar të mbanin ngjarje publike LGBTIQ+ , se nuk kishte pasur një mjet juridik efektiv për të adresuar këtë fakt dhe se në trajtimin e kërkesave të aplikantëve, autoritetet kombëtare kishin vepruar në mënyrë diskriminuese.

Gjykata konstatoi se kjo çështje ishte e ngjashme me çështjen Alekseyev kundër Ruisë, për të cilën ajo ishte shprehur në vitin 2010 (shih më sipër). Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 11 (e drejta e tubimit dhe e organizimit), shkelje të nenit 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) dhe shkelje të nenit 14 (e drejta për të mos u diskriminuar) të Konventës në lidhje me shtatë aplikimet në fjalë.<sup>77</sup> U konstatua në veçanti se vendimi për të refuzuar kërkesat e aplikantëve për të mbajtur ngjarje publike LGBTIQ+ nuk mund të justifikohet nga shqetësimi për prishjen e rendit dhe qetësisë publike dhe përbënte shkelje të së drejtës së organizatorëve për lirinë e tubimit dhe organizimit. Për më tepër, vendimi për ndalimin e eventeve LGBTIQ+ ishte motivuar qartë nga mosmiratimi i temës së demonstratave nga autoritetet vendase dhe si rrjedhim kishte rezultuar në diskriminim ndaj tyre, në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Së fundmi, Gjykata përsëriti detyrimin e shteteve kombëtare për të zbatuar vendimet e saj dhe vuri në dukje se Rusia duhet të tregonte një përpjekje të qëndrueshme dhe afatgjatë drejt miratimit të masave të përgjithshme në lidhje me çështjet e lirisë së tubimit e organizimit dhe shmangies së diskriminimit.

### **Zhdanov dhe të tjerët kundër Ruisë (16 korrik 2019)**

Ky rast kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve për të regjistruar organizata të krijuara për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e personave LGBTIQ+ në Rusi. Kërkuësit parashtruan në

---

<sup>77</sup> Gjykata konstatoi se 44 aplikimet e tjera ishin të papranueshme pasi ato nuk ishin depozituar brenda gjashtë muajve nga vendimi i autoriteteve për të mos miratuar një ngjarje publike LGBTI. Shih gjithashtu: Alekseyev dhe të tjerët kundër Ruisë, vendim i 30 qershorit 2020.

veçanti, se refuzimi për të regjistruar organizatat aplikante kishte shkelur të drejtën e tyre të organizimit dhe kishte qenë diskriminues.

Gjykata vendosi të shpallte të papranueshme ankesat e parashtruara nga një prej aplikantëve, konkretisht aktivisti i njohur LGBTIQ+ Nikolay Alekseyev, për shkak të deklaratave të tij fyese dhe kërcënuese ndaj Gjykatës dhe gjyqtarëve të saj në rrjetet sociale. Sa u përket kërkuesve të mbetur, Gjykata u shpreh se kishte patur shkelje individuale të nenit 11 (liria e tubimit dhe e organizimit) dhe në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në të gjitha aplikimet. Gjykata konstatoi në veçanti, se arsyeja vendimtare për refuzimin e regjistrimit të organizatave kërkuese ishte fokusi i veprimtarisë së tyre në promovimin e të drejtave LGBTIQ+. Më tej, Gjykata konsideroi se kjo bazë nuk mund të justifikohet në mënyrë të arsyeshme apo objektive dhe se për këto arsye rezultonte në diskriminim për shkak të orientimit seksual.

### **Aplikime në pritje**

Rakurs kundër Ruisë (nr. 44403/15), Maximum Center kundër Ruisë (nr. 49258/15), Qendra për të Drejtat e Njeriut në Perm (Perm HRC) kundër Ruisë (nr. 35816/16) dhe Coming Out kundër Ruisë (nr 4798/15)

Aplikimet i janë komunikuar qeverisë ruse më 22 mars 2017.

### **E drejta për t'u martuar (neni 12 i Konventës)**

#### **Schalk dhe Kopf kundër Austrisë (24 qershor 2010)**

Aplikantët, një çift i të njëjtit seks që jetonte në një partneritet të qëndrueshëm i kërkuan autoriteteve austriake leje për t'u martuar. Kërkesa e tyre u refuzua me arsyetimin se martesë mund të lidhej vetëm ndërmjet dy personave të seksit të kundërt. Kjo pikëpamje u mbështet nga gjykatat lokale.

Para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kërkuesit u ankuan më tej mbi refuzimin e autoriteteve kombëtare për t'i lejuar ata të lidhnin martesë. Ata u ankuan se ishin diskriminuar për shkak të orientimit të tyre seksual përpara hyrjes në fuqi të Aktit të Regjistrimit të Partneritetit.

Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 12 (e drejta për martesë), dhe asnjë shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës. Ajo fillimisht u shpreh se marrëdhënia e aplikantëve përfshihej brenda nocionit të "jetës familjare", ashtu siç do të ishte marrëdhënia e një çifti të seksit të ndryshëm në të njëjtën situatë. Megjithatë, Konventa nuk mund të detyronte një shtet t'i jepte një çifti të të njëjtit seks akses në martesë.

### **Chapin dhe Charpentier kundër Francës (9 qershor 2016)**

Ky rast kishte të bënte me martesën e dy burrave të kryer nga Kryetari i Bashkisë Bègles (Gironde) dhe më pas të shpallur të pavlefshme nga gjykatat vendase. Kërkuesit parashtruan se kufizimi i martesës vetëm brenda çifteve të seksit të kundërt përbën një shkelje diskriminuese të së drejtës për t'u martuar. Ata gjithashtu pretenduan se ishin diskriminuar në ushtrimin e së drejtës së tyre për respektimin e jetës familjare, në bazë të orientimit të tyre seksual.

Gjykata u shpreh se nuk kishte shkelje të nenit 12 (e drejta për martesë) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe asnjë shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me nenin 14 të Konventës. Ajo përsëriti në veçanti qëndrimin e mbajtur në vendimin Schalk dhe Kopf kundër Austrisë (shih më lart), se as neni 12 dhe as neni 8 në lidhje me nenin 14 nuk mund të interpretoheshin si imponim i shteteve kontraktuese për t'u dhënë çifteve të të njëjtit seks akses në martesë.

### **Orlandi dhe të tjerët kundër Italisë (14 dhjetor 2017)<sup>78</sup>**

**Shih më lart, nën “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”, “Bashkimet civile”.**

### **Mbrojtja e pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës)**

#### **J.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 37060/06) (28 shtator 2010)**

Kërkuesja, një nënë e divorcuar e dy fëmijëve që jetonin kryesisht me babanë e tyre, që nga viti 1998 jetonte me një grua tjetër në një lidhje afatgjatë. Si prind jorezident, asaj iu kërkua nga rregulloret për mbështetjen e fëmijëve që të kontribuonte financiarisht në koston e rritjes së tyre. Kërkuesja u ankua se asaj i kërkohej të paguante përafërsisht 47 GBP në javë, ndërsa nëse ajo do të kishte krijuar një marrëdhënie të re me një burrë, shuma e kërkuar do të ishte rreth 14 GBP. Ajo pretendoi se autoritetet vendase e kishin diskriminuar në bazë të orientimit të saj seksual kur kishin caktuar shumën që ajo duhet të paguante.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 1 (mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti, se rregullat për kujdesin e fëmijëve përpara prezantimit të Ligjit për Partneritetin Civil kishin qenë diskriminuese ndaj personave që ishin në marrëdhënie të të njëjtit seks

---

<sup>78</sup> Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se shteti Italian kishte dështuar të arrinte një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese kombëtare dhe individuale dhe për pasojë kishte shkelur të drejtat e çifteve për njohje ligjore. Gjykata vendosi në dukje në veçanti, se shtetet kishin diskrecion të gjerë nëse do të lejonin apo jo regjistrimin e martesave të të njëjtit seks dhe se në këtë rast shkelja nuk kishte ndodhur si pasojë e mos regjistrimit të martesave të lidhura jashtë vendit, por për shkak se ligji italian nuk kishte ofruar asnjë mbrojtje apo njohje ligjore për këto çifte.



## Rëndësia e Instrumenteve “Soft-Law” në avancimin e garantimit të të drejtave të njeriut për individët LGBTIQ+

Instrumentet ligjore “soft-law” përfaqësojnë një rol kyç në nxitjen e avancimit të të drejtave LGBTIQ+, duke ofruar mekanizma të nuancuara dhe të adaptueshme në plotësim të kornizave tradicionale legjislativë. Rëndësia e këtyre instrumenteve qëndron në aftësinë për të nxitur ndryshime, pa imponuar detyrime të menjëhershme ligjore, duke nxitur një evolucion gradual por të qëndrueshëm në legjislacion, praktikat institucionale, qëndrimet dhe politikat shoqërore.<sup>79</sup> Një nga avantazhet kryesore që sjell aplikimi i “soft-law” në kontekstin e të drejtave LGBTIQ+ është fleksibiliteti i zgjidhjeve të ofruara.

Instrumentet tradicionale e të ngurta ligjore, shpesh hasin në pengesa në raport me ruajtjen e balancës mes normave juridike dhe peizazhit të zhvillimeve shoqërore. Instrumentet “soft-law” në formën e deklaratave, udhëzimeve, rekomandimeve, parimeve dhe rezolutave ndërkombëtare, ofrojnë një platformë më fleksibël sesa ligji i ngurtë. Ky fleksibilitet lejon ofrimin e përgjigjeve të përshtatura me efektivitet ndaj sfidave të ndryshimeve shoqërore, duke akomoduar kontekste të ndryshme kulturore dhe duke lehtësuar dialogun midis palëve të interesuara.<sup>80</sup> Për më tepër, këto instrumente shërbejnë si një katalizator për formësimin e opinionit publik, duke artikuluar parime dhe standarde pa forcën shtrënguese të legjislacionit të ngurtë. Në nivel ndërkombëtar, instrumentet “soft-law” nxisin dhe mundësojnë një angazhim të përbashkët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe specifikisht të drejtave të njeriut të personave LGBTIQ+, duke nxitur një diskurs global që inkurajon gjithëpërfshirje, barazi thelbësore dhe respekt për vlerat e dinjitetit njerëzor.

Instrumentet “soft-law” vlerësohen si thelbësore edhe në kuadër të navigimit më efektiv e më të lehtë të ndryshimeve kulturore. Duke pasur parasysh këndvështrimet e ndryshme për çështjet LGBTIQ+ në shoqëri të ndryshme, natyra e ngurtë e legjislacionit tradicional mund të hasë në rezistencë shoqërore. Në këtë linjë, instrumentet “soft-law” ofrojnë një terren tranzitor, duke lejuar ndryshime ligjore efektive që përputhen me vlerat shoqërore në zhvillim për të nxitur një transformim më të qëndrueshëm ligjor e shoqëror.<sup>81</sup>

Në thelb, rëndësia e instrumenteve “soft-law” në avancimin e të drejtave LGBTIQ+ qëndron në aftësinë e për të ofruar një kuadër dinamik dhe të përgjegjshëm, që plotëson parashikimet e ngurta ligjore, vakumet ekzistuese dhe nxit optimin e standardeve ndërkombëtare të respektimit, mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut nga shtetet kombëtare.

---

<sup>79</sup> Prosper Weil, “Toward Relative Normativity in International Law”, 77 AM. J. INT’L L. 413, 414- 417 n.7 (1983).

<sup>80</sup> Kenneth W. Abbott & Duncan Snidal, “Hard and Soft Law in International Legal Governance”, 54 INT’L ORG. 421 (2000).

<sup>81</sup> Ella Weggen, “Sexual Orientation and Gender Identity in International Human Rights Law”, University of Amsterdam. 17 (2009).

## **Parimet e Yogyakarta**

Një nga instrumentet më të rëndësishme “soft-law” në këtë kuadër përfaqsojnë të ashtuquajturat Parimet e Yogyakarta, të lindura nga Parimet e të Drejtave të Njeriut të Yogyakarta mbi Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor. Këto parime përbëjnë një grup të detajuar dhe të gjerë udhëzimesh që synojnë të adresojnë sfidat specifike me të cilat përballen komunitetet LGBTIQ+ dhe të ofrojnë një kuadër gjithëpërfshirës për promovimin dhe mbrojtjen thelbësore të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Duke mbuluar një spektër të gjerë të të drejtave të njeriut, këto parime shkojnë përtej fokusit konvencional mbi mosdiskriminimin. Ato përfshijnë të drejtën e jetës, të drejtën për privatësi, të drejtën për punë dhe lirinë e shprehjes, ndër të tjera. Kjo qasje gjithëpërfshirëse pasqyron në një kuptim qasjen se të drejtat e komuniteteve LGBTIQ+ janë të ndërlidhura dhe duhet të trajtohen në mënyrë të integruar e gjithëpërfshirëse.

Siç rekomandohet ndërkombëtarisht, punonjësit e sistemit të drejtësisë duhet të shohin me prioritet referimin e Parimeve të Yogyakarta në punën e tyre. Këto parime përfaqësojnë një udhërrëfyes të detajuar mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut në kontekstin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke ofruar një burim të vlefshëm për të siguruar që argumentet dhe strategjitë ligjore në vendimarrjet juridike të përputhen me standardet e të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht.

Për shumë shtete, ndër të cilat Malta, e cila përfaqëson një shembull pozitiv të adresimit efektiv ligjor të të drejtave të personave LGBTIQ+, Parimet e Yogyakarta kanë shërbyer si burim frymëzimi për reformat ligjore, duke kontribuar kështu në krijimin e kornizave ligjore më gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në qasjen e të drejtave të njeriut. Këto parime nxisin konsistencë dhe unitet në interpretimet ligjore, pasi duke iu referuar një grupi të përbashkët udhëzimesh, praktikuesit e ligjit mund të kontribuojnë në një kuptim të përbashkët të të drejtave dhe lirive thelbësore për komunitetet LGBTIQ+. Kjo frymë interpretimi dhe zbatimi ligji promovon koherencën në diskutimet ligjore, duke lehtësuar bashkëpunimin në avancimin e kauzës për të drejtat LGBTIQ+.

## **Një përmbledhje e koncentruar e përmbajtjes së Parimeve të Yogyakartaës prezantohet në vijim:**

- Preambula: Thekson në mënyrë eksplicite kontekstin historik dhe bazat e diskriminimit ndaj individëve bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor; Përqëndrohet te roli që luan diskriminimi i shumëfishtë si dhe format e ndryshme të diskriminimit në theksimin e pabarazive ligjore e shoqërore për personat LGBTIQ+.

-Parimet themelore: Respekti për dinjitetin njerëzor: Nënvizon rolin e dinjitetit si themel për gëzimin dhe realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut; Barazia: Specifikon nevojën për mbrojtje të barabartë para ligjit dhe përfitim të barabartë nga ligji; Mosdiskriminimi: Përcakton detyrimet për të parandaluar, hetuar efektivisht dhe korrigjuar diskriminimin.

-Të drejtat civile dhe politike: E drejta e jetës: shtjellon detyrimet negative dhe pozitive në lidhje me ndalimin e vrasjeve jashtëgjyqësore dhe dhunën e legjitimuar nga shteti ndaj individëve LGBTIQ+; Privatësia: Zgjeron të drejtën e privatësisë në çështjet personale dhe familjare; Liria e shprehjes: Detajon standardet e mbrojtjes kundër censurës dhe kufizimeve; Liria nga tortura: Përcakton në mënyrë gjithëpërfshirëse ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor për personat LGBTIQ+.

- Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore: E drejta për punë: Diskutohet për eliminimin e diskriminimit në vendin e punës dhe mundësitë e barabarta të punësimit; E drejta për arsim: Thekson nevojën për politika dhe programe arsimore gjithëpërfshirëse; E drejta për shëndet: Trajton aksesin në kujdesin shëndetësor pa diskriminim; Pjesëmarrja në jetën kulturore: Advokon për njohjen dhe kremtimin e shprehjeve të ndryshme kulturore të ndërlidhura me identitetet LGBTIQ+; E drejta për azil: Zgjeron detyrimet e shteteve për të siguruar mbrojtje dhe për të garantuar të drejtën e azilit bazuar në frikën nga persekutimi për shkak të statusit LGBTIQ+; E drejta për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike: Bën thirrje për heqjen e barrierave në pjesëmarrje, duke siguruar përfaqësim të barabartë politik.

-Zbatueshmëria: Nxiten shtetet të miratojnë legjislacion, politika dhe praktika të bazuara në qasjen e të drejtave të njeriut, që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e individëve LGBT; Inkurajohet krijimi i mekanizmave për monitorimin dhe zbatimin e parimeve.

- Detyrimet specifike: Trajtohen detyrimet pozitive në kuadër të adresimit të formave të dhunës, kriminalizimit dhe mbrojtjes së identitetit gjinor, duke përfshirë njohjen dhe dokumentacionin ligjor që reflekton shenjuesin e duhur të gjinisë.

## **CM Rec (2010)5**

CM Rec (2010)5, i njohur gjithashtu si Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës drejtuar shteteve anëtare mbi masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, është një tjetër instrument i rëndësishëm “soft-law” në fushën e të drejtave të njeriut të personave LGBTIQ+. Miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2010, ky rekomandim ofron udhëzime praktike për shtetet anëtare se si të trajtojnë dhe parandalojnë në mënyrë efektive diskriminimin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Një nga aspektet e rëndësishme të CM Rec (2010)5 është theksi i tij në masat gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit. Rekomandimi inkurajon shtetet anëtare të miratojnë dhe zbatojnë efektivisht legjislacionin që ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në fusha të ndryshme, duke përfshirë punësimin, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe aksesin në mallra dhe shërbime. Për më tepër, CM Rec (2010)5 thekson rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi të drejtat e njeriut. Ai rekomandon shtetet anëtare të promovojnë në mënyrë aktive mirëkuptimin, tolerancën dhe pranimin e diversitetit në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ky theks kontribuon në qëllimin afatgjatë të krijimit të shoqërive gjithëpërfshirëse duke sfiduar stereotipet dhe duke nxitur një kulturë të respektimit të të drejtave të njeriut për personat LGBTIQ+.

Praktikuesit e ligjit mund t'i referohen përmbajtjes së CM Rec (2010)5 në punën e tyre për disa arsye. Së pari, ky instrument ofron një grup koherent dhe të detajuar udhëzimesh që shtetet anëtare mund t'i përdorin si referencë kur zhvillojnë dhe zbatojnë masa ligjore kundër diskriminimit. Profesionistët ligjorë mund t'i përdorin këto rekomandime për të siguruar që legjislacioni dhe praktika gjyqësore kombëtare të përputhet me standardet ndërkombëtare, duke kontribuar në krijimin e kornizave ligjore më të forta e gjithëpërfshirëse. Së dyti, CM Rec (2010)5 promovon rëndësinë e ofrimit dhe aksesit në mjete juridike efektive për viktimat e diskriminimit. Ky fokus në ofrimin e mjeteve të aksesueshme juridike aspektin e përgjegjshmërisë së shteteve në mbrojtjen e të drejtave të individëve LGBTIQ+.

Ndër vite, CM Rec (2010)5 qëndron si një instrument vendimtar “soft-law” që ofron udhëzime praktike për luftën ndaj diskriminimit në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Praktikuesit dhe interpretuesit e ligjit mund të mbështeten në përmbajtjen e këtij rekomandimi për të formësuar legjislacionin dhe praktikën gjyqësore kombëtare, për të promovuar edukimin ligjor dhe ndërgjegjësimin shoqëror, si dhe për të siguruar mjete juridike efektive për viktimat e diskriminimit, duke kontribuar në një peizazh ligjor më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë për personat LGBTIQ+.

## **Një përmbajtje e koncentruar e strukturës së rekomandimit CM Rec (2010)5 paraqitet në vijim:**

-Preambula: Pranon sfidat specifike me të cilat përballen individët LGBTIQ+; Njeh kontekstin historik dhe rëndësinë e trajtimit të diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

- Qëllimi dhe përkufizimet: Përkufizon në mënyrë eksplicite orientimin seksual dhe identitetin gjinor; Sqaron aplikueshmërinë e Rekomandimit si për sektorin publik dhe për atë privat.

-Parimet: Thekson parimet e mosdiskriminimit, barazisë dhe respektimit të dinjitetit njerëzor si themelore për gëzimin dhe garantimin e të gjitha të drejtave të tjera; Thekson detyrën e shteteve anëtare për të luftuar në mënyrë aktive diskriminimin.

-Kudri ligjor: Inkurajon shtetet anëtare të përfshijnë në mënyrë eksplicite orientimin seksual dhe identitetin gjinor në legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi; Vendors detyrime pozitive në drejtim të mbrojtjes ligjore kundër krimeve të urrejtjes që targetojnë individët LGBTIQ+.

-Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik: Rekomandon programe arsimore që trajtojnë stereotipat dhe paragjykimet ndaj individëve LGBTIQ+; Ofron udhëzime mbi përfshirjen e temave LGBTIQ+ në kurrikulë.

-Punësimi: Parashikon masa për të parandaluar dhe trajtuar diskriminimin në vendin e punës; Sugjeron programe trajnimi për punëdhënësit dhe punonjësit mbi përfshirjen LGBTIQ+.

-Kujdesi shëndetësor: U kërkon shteteve anëtare të sigurojnë akses efektiv dhe real në kujdesin shëndetësor jodiskriminues; Rekomandon trajnimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor për nevojat specifike të individëve LGBTIQ+.

-Dokumentet dhe identiteti: Rekomandon njohjen ligjore të identitetit gjinor, duke përfshirë mundësinë e ndryshimit të shenjuesit gjinor në dokumentet zyrtare; Bën thirrje për eliminimin e pengesave në ndryshimin dhe nxjerrjen e dokumenteve të reja që pasqyrojnë identitetin e zgjedhur gjinor.

-Liria e organizimit dhe shoqërimit: Thekson një seri detyrimesh pozitive në mbrojtjen e të drejtave të individëve LGBTIQ+ për tubim dhe shoqërim paqësor; Trajton shqetësimet në lidhje me ngjarjet dhe paradat publike.

-Gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes: Parashikon standarde për një legjislacion efektiv që adreson efektivisht gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes kundër individëve LGBTIQ+; Kërkon hetime dhe sanksione efektive për vepra penale të tilla.

-Pjesëmarrja politike: Mbështet masat që sigurojnë pjesëmarrjen politike të individëve LGBTIQ+; Trajton përfaqësimin dhe përfshirjen në proceset vendimmarrëse.

-Bashkëpunimi Ndërkombëtar: Inkurajon shtetet anëtare të bashkëpunojnë ndërkombëtarisht për avancimin e të drejtave LGBTIQ+; Thekson rëndësinë e ndarjes së praktikave më të mira dhe nxitjes së dialogut.

Përveç Parimeve të Yogyakartaës dhe Rekomandimit CM Rec (2010)5, praktikuesit dhe interpretuesit e ligjit të angazhuar në fushën e të drejtave LGBTIQ+ kanë në dispozicion të zhvillimit personal dhe punës së tyre një sërë instrumentesh të tjera “soft-law”, ku secili prej tyre ofron perspektiva dhe rekomandime unike. Duke i përfshirë në mënyrë strategjike këto instrumente të ndryshme të ligjit të butë në punën tuaj si praktikues dhe interpretues të ligjit, mund të ndikoni në zhvillime ligjore efektive dhe gjithëpërfshirëse. Në vijim jemi përpjekur të përpilojmë një listë<sup>82</sup> gjithëpërfshirëse burimesh për t`u referuar dhe formësuar standardet e aplikuara në punën tuaj:

---

<sup>82</sup> Kjo listë në një version më të zgjeruar, ku përfshihen raporte mbi situatën e çështjeve LGBTI në vend dhe më gjerë, rekomandime dhe burime shtesë që mund t`ju shërbejnë në punën tuaj, shoqëruar me linqet përkatëse ku mund t`i aksesoni këto burime, gjendet në përfundim të këtij Vademekumi.

1.Parimet e Yogyakartaës plus 10 (YP+10): Përfaqësojnë një version të zgjeruar të Parimeve origjinale të Yogyakartaës, duke ofruar udhëzime të përditësuara dhe shtesë mbi kuadrin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut në lidhje me orientimin seksual, identitetin dhe shprehjen gjinore, dhe karakteristikat e seksit.

2.Konventa e Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje): Megjithëse nuk fokusohet ekskluzivisht në të drejtat LGBTIQ+, Konventa e Stambollit trajton dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën ndaj individëve LGBTIQ+, për të promovuar masat gjithëpërfshirëse në luftën ndaj dhunës bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

3.Kodi i praktikës së ILO-s për HIV/AIDS: Edhe pse nuk fokusohet ekskluzivisht në të drejtat LGBTIQ+, ky instrument i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) trajton diskriminimin në vendin e punës dhe mund të zbatohet për të mbrojtur politikat gjithëpërfshirëse në përfitim të punonjësve LGBTIQ+.

4.Udhëzimet e UNESCO-s për përfshirjen e çështjeve LGBTIQ+ në arsim: Këto udhëzime ofrojnë një kornizë për krijimin e mjediseve arsimore gjithëpërfshirëse. Këto udhëzime janë përdorur me sukses nga shumë shtete për të formuar politika dhe praktika arsimore që respektojnë dhe mbështesin studentët LGBTIQ+.

5.Plani i Veprimit të Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë: Ndërsa trajton kryesisht gjuhën e urrejtjes, ky instrument i Kombeve të Bashkuara është përdorur për të luftuar diskriminimin retorik kundër individëve LGBTI, duke theksuar rëndësinë e parandalimit të nxitjes së dhunës.

6.Opinionit Këshillimor i Gjykatës Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut 24/17: Lëshuar në përgjigje të një rasti të Kosta Rikës, ky opinion këshillues pohoi se shtetet duhet të njohin dhe garantojnë gjerësisht të gjitha të drejtat që lidhen me identitetin gjinor të një personi. Praktikuesit ligjorë mund ta përdorin këtë opinion për të garantuar të drejtat e personave transgjinerë në juridiksione të tjera.

7.Deklarata e të Drejtave të Njeriut ASEAN<sup>83</sup>: Edhe pse nuk përmend në mënyrë eksplicite orientimin seksual ose identitetin gjinor, ajo pohon të drejtën për mosdiskriminim. Aktivistët e kanë përdorur këtë deklaratë për të ushtruar presion për politika më gjithëpërfshirëse brenda rajonit ASEAN, megjithatë atom und të gjejnë aplikim edhe në juridiksione të tjera.

---

<sup>83</sup> Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore.

8.Paketa e mjeteve të Rrjetit të Barazisë së Commonwealth (CEN): Paketa e mjeteve të CEN ofron udhëzime praktike për mbrojtjen e të drejtave LGBTIQ+ dhe është përdorur nga aktivistët për të nxitur ndryshime legjislative dhe pranim shoqëror në shtetet anëtare të Commonwealth.

9.Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit (ACHPR): Megjithëse nuk është një ligj plotësisht i butë, ACHPR është përdorur gjerësisht për të avancuar të drejtat LGBTIQ+, ku shumë praktikues të ligjit kanë përdorur dispozitat e saj për të argumentuar në kundërshtim të ligjeve dhe praktikave diskriminuese në vendet afrikane.

10. Parimet e Bangkokut mbi statusin dhe trajtimin e pakicave seksuale në Azi: Të zhvilluara gjatë Konferencës Aziatike për të Drejtat LGBTIQ+, këto parime theksojnë të drejtat e pakicave seksuale, ku praktikues të ligjit nga e gjithë bota i janë referuar vazhdimisht për të promovuar dialogun dhe mirëkuptimin ndërkombëtar në lidhje me çështjet LGBTIQ+.

11.Udhëzimet e OSBE/ODIHR për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të Personave LGBTIQ+: Të hartuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), këto udhëzime ofrojnë hapa praktike për shtetet për të mbrojtur të drejtat e individëve LGBTIQ+. Praktikuesit e ligjit i kanë përmendur këto udhëzime në advokimin e kornizave ligjore gjithëpërfshirëse në të gjithë Evropën.



## **Listë Rekomandimesh në lidhje me formimin profesional dhe punën e praktikuesve të ligjit dhe punonjësve të drejtësisë në raport me çështjet e individëve LGBTIQ+:**

1. Trajnimi dhe sensibilizimi: Të hartohen dhe parashikohen programe të rregullta trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët mbi çështjet LGBTIQ+ për të siguruar një kuptim të nuancuar të sfidave unike me të cilat përballet ky komunitet.

2. Të vijojë të përforcohet aplikimi i parimit të mosdiskriminimit në proceset ligjore, duke siguruar që individët LGBTIQ+ të kenë trajtim efektiv të drejtë dhe të barabartë përpara ligjit.

3. Mbrojtja ligjore: Të forcohet mbështetja dhe mbrojtja ligjore kundër diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

4. Shmangia e stereotipeve: Të forcohet ndërgjegjësimi ndaj stereotipeve dhe paragjykimeve me bazë orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e seksit, duke siguruar që nocionet e paracaktuara të mos ndikojnë në vendimmarrje.

5. Gjuha gjithëpërfshirëse: Të promovohet përdorimi i gjuhës gjithëpërfshirëse në proceset gjyqësore, duke respektuar gjininë dhe vetidentifikimin e individëve.

6. Shërbimet e mbështetjes për viktimat: Të përmirësohet sistemi i shërbimeve mbështetëse për viktimat LGBTIQ+, duke përfshirë këshillimin dhe ndihmën ligjore, për të siguruar mirëqenien e tyre gjatë proceseve ligjore.

7. Dëshmitarët ekspertë: Mundësoni që ekspertë për çështjet LGBTIQ+ të ofrojnë kontekst dhe njohuri, duke ndihmuar gjyqtarët dhe prokurorët në arritjen e vendimeve të informuara.

8. Përmirësimi i vazhdueshëm i qasjes në drejtësi: Të vijojnë përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi për individët LGBTIQ+, duke adresuar barrierat që ekzistojnë për shkak të stigmës ose diskriminimit shoqëror. Të sigurohet që individët LGBTIQ+

të kenë akses në ndihmë juridike dhe përfaqësim, veçanërisht ata që mund të përballen me pengesa financiare.

9. Angazhimi i komunitetit: Të nxitet bashkëpunimi mes sistemit të drejtësisë, organizatave të të drejtave të njeriut dhe komuniteteve LGBTIQ+ për të rritur mirëkuptimin dhe ndërtimin e besimit.

10. Përmirësimi i aksesit në mekanizmat e raportimit: Krijimi i mekanizmave të qarta dhe të aksesueshme të raportimit për krimet e urrejtjes dhe diskriminimin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

11. Rishikimi dhe përditësimi i politikave: Të rishikohen dhe përditësohen rregullisht politikat gjyqësore dhe prokuroriale për t'u përshtatur me standardet në zhvillim të të drejtave të njeriut dhe zhvillimet në të drejtat LGBTIQ+.

12. Konsiderata ndaj ndërsektorialitetit në format e diskriminimit dhe në pabarazi: Merrni gjithmonë parasysh ndërsektorialitetin, duke mbajtur në vëmendje se individët mund të përballen me diskriminim të shumëfishtë bazuar në faktorë të tillë si raca, përkatësia etnike, statusi ekonomik, paaftësia etj., përveç identiteteve LGBTIQ+.

13. Promovimi i vazhdueshëm i transparencës në vendimmarrje: Promovimi i transparencës në vendimmarrjet në lidhje me çështjet që përfshijnë statusin LGBTIQ+, duke përshkruar qartë rrugën e ndjekur drejt arsyetimit ligjor dhe faktorët e marrë në konsideratë në gjykim, për të ndërtuar besimin e publikut dhe siguruar transparencën e vendimmarrjes.

14. Njësitë e specializuara LGBTIQ+: Konsideroni krijimin e njësive të specializuara brenda gjyqësorit dhe shërbimeve të prokurorisë për të ndihmuar trajtimin e çështjeve të njohjes ligjore të personave LGBTIQ+, duke siguruar ekspertizë në përputhje me parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ndjeshmëri të shtuar në trajtimin e këtyre çështjeve.

15. Bashkëpunimi me OJQ-të: Të nxitet bashkëpunimi me organizatat joqeveritare (OJQ) të fokusuara në çështjet LGBTIQ+ për të shkëmbyer informacion, burime dhe ekspertizë për një përgjigje ligjore më efektive.

16. Monitorimi dhe Vlerësimi: Krijimi i një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të vendimarrjeve të lidhura me çështjet LGBTIQ+ për të identifikuar fushat e mundshme për përmirësim në procesin ligjor dhe nevojat e profesionistëve të drejtësisë në punën e tyre me këto çështje.

17. Sigurimi i mjediseve gjithëpërfshirëse të gjykatës: Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të sigurt brenda objekteve të gjykatave dhe prokurorive, duke përfshirë një mjedis dhe staf që respekton identitetin gjinor të individëve.

18. Ndihma juridike për ndryshimet e emrit dhe gjinisë: Të konsiderohet mundësia e ofrimit të ndihmës juridike dhe mbështetjes për individët që kërkojnë ndryshime të emrit dhe gjinisë, duke njohur rëndësinë e njohjes ligjore në afirmimin e identitetit gjinor.

19. Njohja e vazhdueshme dhe referenca në praktikën gjyqësore të gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut me në fokus GJEDNJ-në në rastet e lidhura me çështjet LGBTIQ+, duke i përafuar vendimmarrjet me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Të theksohet vazhdimisht rëndësia e përafrimit të vendimeve gjyqësore dhe veprimeve prokuroriale me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke u mbështetur në instrumentat, praktikat dhe parimet juridike që mbrojnë dhe garantojnë të drejtat e njeriut për personat LGBTIQ+.

20. Kontrolli incidental i ligjeve: Të promovohet përdorimi më i shpeshtë i rishikimit incidental të ligjeve për të vlerësuar ndikimin e tyre në të drejtat LGBTIQ+, duke siguruar që ligjet të përputhen me garancitë kushtetuese dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## Listë burimesh shtesë:

1. Universal Declaration of Human Rights:  
<https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>
2. Yogyakarta Principles: <https://yogyakartaprinciples.org/>
3. Malmo Declaration:  
<https://www.hivjustice.net/global-factsheet/malmo-declaration-on-sexual-orientation-and-human-rights/>
4. Buenos Aires Declaration:  
[https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_norm/---normes/documents/publication/wcms\\_103882.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---normes/documents/publication/wcms_103882.pdf)
5. Declaration of Montreal: <https://76crimes.com/2006/07/31/declaration-of-montreal/>
6. International Guidelines on Human Rights and Drug Policy:  
<https://idpc.net/publications/2018/10/international-guidelines-on-human-rights-and-drug-policy>
7. Oslo Recommendations:  
[https://www.researchgate.net/publication/274470211\\_The\\_Oslo\\_Recommendations\\_on\\_Sexual\\_Orientation\\_and\\_Gender\\_Identity](https://www.researchgate.net/publication/274470211_The_Oslo_Recommendations_on_Sexual_Orientation_and_Gender_Identity)
8. Declaration of Principles on Equality:  
<https://www.ibanet.org/human-rights-institute/declaration-of-principles-on-equality.aspx>
9. Toonen v. Australia Communication: <https://www.refworld.org/cases.HRC.3ae6b6e80.html>
10. Rabat Plan of Action:  
[https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/SpeechRabat\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/SpeechRabat_en.pdf)
11. European Convention on Human Rights:  
[https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf)
12. Brasilia Declaration on Drug Policies and Human Rights:  
<https://idpc.net/publications/2019/11/brasilian-declaration-on-drug-policies-and-human-rights>
13. Asia Pacific Strategy on HIV and AIDS (2016-2021):  
[https://www.unaids.org/sites/default/files/media\\_asset/APCASO\\_Asia\\_Pacific\\_Strategy\\_HIV-AIDS-2016-2021\\_en.pdf](https://www.unaids.org/sites/default/files/media_asset/APCASO_Asia_Pacific_Strategy_HIV-AIDS-2016-2021_en.pdf)
14. International Convention on the Protection of the Rights of All Migrant Workers and Members of Their Families (ICMW):  
<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cmw.aspx>
15. Optional Protocol to the Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (OPCAT):

<https://www.ohchr.org/en/hrbodies/opcat/pages/optionalprotocoltotheconventionagainsttorture.aspx>

16. International Convention on the Suppression and Punishment of the Crime of Apartheid (ICSPCA): <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/apartheid.aspx>

17. Convention on the Protection of the Rights of All Migrant Workers and Members of Their Families (CMW): <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cmw.aspx>

18. Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the involvement of children in armed conflict (OPAC): <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opaccrc.aspx>

19. Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the sale of children, child prostitution and child pornography (OPSC):  
<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opscrc.aspx>

20. Second Optional Protocol to the International Covenant on Civil and Political Rights, aiming at the abolition of the death penalty (OP2-ICCPR):  
<https://www.ohchr.org/EN/professionalinterest/pages/2ndop-iccpr.aspx>

21. Universal Periodic Review (UPR) - Albania:  
<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/AllIndex.aspx>

22. Universal Periodic Review (UPR) - Balkans:  
<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/UPRMain.aspx>

23. CEDAW Recommendations:  
[https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/TreatyBodyExternal/TBSearch.aspx?Lang=En&CountryID=2](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/TBSearch.aspx?Lang=En&CountryID=2)

24. ILGA-Europe Annual Review:  
[https://www.ilga-europe.org/resources/reports\\_surveys/annual\\_review](https://www.ilga-europe.org/resources/reports_surveys/annual_review)

25. Rainbow Europe Country Index: <https://rainbow-europe.org/>

26. Balkan Pride: <https://www.iglyo.com/2018/09/balkan-pride-report-released/>

27. European Union Agency for Fundamental Rights (FRA) Report on LGBTI Rights:  
<https://fra.europa.eu/en/theme/LGBTI>

28. European Region of the International Lesbian, Gay, Bisexual, Trans and Intersex Association (ILGA-Europe) Annual Report:  
<https://www.ilga-europe.org/resources/publications/annual-reports>

29. European Union Agency for Fundamental Rights (FRA) Annual Report on Fundamental Rights: <https://fra.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/yearly-reports>

30. Human Rights Watch Reports: <https://www.hrw.org/>

31. Amnesty International Reports: <https://www.amnesty.org/>

32. ECHR Judgments: <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=home>

33. Council of Europe Commissioner for Human Rights Reports: <https://www.coe.int/en/web/commissioner/annual-reports>
34. European Parliament Annual Reports on Human Rights and Democracy in the World: <https://www.europarl.europa.eu/committees/en/droi/home/highlights>
35. ILGA-Europe Rainbow Map and Index: <https://www.ilga-europe.org/rainboweurope/2023>
36. European Union Annual Report on Human Rights and Democracy in the World: [https://eeas.europa.eu/topics/human-rights-democracy/8907/annual-reports-human-rights-and-democracy-world\\_en](https://eeas.europa.eu/topics/human-rights-democracy/8907/annual-reports-human-rights-and-democracy-world_en)
37. Stonewall Europe and Central Asia Annual Review: <https://www.stonewall.org.uk/about-us/our-work/europe-and-central-asia>
38. Balkans LGBTI Index: <https://soc.ba/en/publications/balkans-lgbti-index/>
39. European Commission Annual Report on the Situation of Fundamental Rights in the EU: [https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/anti-lgbti-discrimination/eu-action-against-lgbti-discrimination\\_en](https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/anti-lgbti-discrimination/eu-action-against-lgbti-discrimination_en)
40. Amnesty International Annual Report: <https://www.amnesty.org/en/latest/research/>
41. ILGA-Europe Annual Conference Reports: <https://www.ilga-europe.org/conference>
42. Human Rights Watch World Report: <https://www.hrw.org/world-report>
43. European Union Agency for Fundamental Rights (FRA) Annual Report on Migration and Asylum: <https://fra.europa.eu/en/theme/asylum-migration-borders>
44. Aleanca LGBT Publications: <https://www.aleancalgbt.org/publikime>
45. LGBTI Equal Rights Association for Western Balkans and Turkey Publications: <https://lgbti-era.org/publications/>



ALEANCA LGBTI



In partnership with  
**Canada**



©Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI

Shkurt 2024

